

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7604 E diel 29 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Ka sot një luftë të vërtetë tregtare mes SHBA dhe Kinës, që është pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e marrëdhënies mes këtyre dy shteteve ...
Vijon në faqen 21

Nga VASIL KURETA

SHBA-Kinë, jo vetëm luftë tregtare



Opinion i Ditës

Adem Demaçi, Baca Adem u nda nga jeta. Ndarja e tij nga jeta pikëlloi gjithë shqiptarët kudo qofshin ata. Adem Demaçi ishte dhe mbetet Baca Adem ...
Vijon në faqen 22

Nga REXHEP QOSJA

Mandati i tij - mandat i gjithëkohshëm



Presidenti: Dekreti të lexohet me durim

Ligji i teatrit, Meta: Jo qëndrime emocionale. Veliaj: Do e rivotojmë në muajin shtator

Kryebashkiaku: Qytetarët duan që Shkodra e Kamza të bëhen si Tirana, jo anasjellas

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje i pranishëm në ceremoninë mortore dhe homazhet shtetërore në nder dhe respekt të atdhetarit, luftëtarit të lirisë e simbolit të rezistencës kombëtare, "Mandëles" së Evropës, Adem Demaçi. Presidenti Meta u takua dhe u shprehu personalisht ngushëllimet dhe hidhërimin e thellë ...
Në faqen 2

AGJENCIA E PRONAVE PUBLIKON LISTEN E PERFITUESVE NE TE GJITHE VENDIN

PRONAT, DOSJET E VITEVE '97-'98 QE KOMPENSOHEN

3260 pronarët që duhet të plotësojnë formularin për të marrë paratë. Përlllogaritjet edhe kompensimi fizik, ja rruga për pagesat e përshpejtuara



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

ESEJA E DITES

Në Butrint, si popull i teatrit...

Nga PERPARIM KABO

Në faqet 10-11

PERPLASJA PS-PD

Rama: Vetingu, u godit korrupsioni. Basha: Drejtësia është e kapur

Në faqen 3

USHQIMI

Sufllaqe në zonën e Bllokut, 11 vetë përfundojnë në spital të helmuar

Në faqen 7

"MANDELA" SHQIPTAR

Përcillet Adem Demaçi, njeriu që kaloi 3 dekada në burgjet serbe

Në faqen 4

VEZHIMI



Puna dhe jetesa në Gjermani, sa zgjat procedura për marrje vize

Në faqen 5



Libri i Robin Hanbury Tenison dhe një histori e pakëndshme e vitit 2007

"Land of Eagles", fodullëku i ministrit shqiptar

Në brendësi: In memoriam të Lazër Radit. Veting moral për kulturën, nga Ben Andoni

Nga NDREK GJINI

Në librin "Land of Eagles", të botuar para pak vitesh në Angli, me autor Robin Hanbury-Tenison, përveç fjalëve të mira që fliten për Shqipërinë dhe mikpritjen shqiptare, shpaloset dhe shëmtia, fod-



ullëku dhe mosmikpritja e ministrit shqiptar të Kulturës të vitit 2007, dhe djalit të tij. Ministri i Kulturës, në këtë libër nuk përmendet me emër, ndaj dhe unë po e lë pa emër. Autori i këtij libri, Robin Hanbury-Tenison ...

Suplement

DEKRETI PËR TEATRIN REAGIMET

Zëdhënësi i presidentit: Kreu i shtetit u mbështet në dokumentacionin e Kuvendit

Dekreti për Teatrin, Presidenca: Reagime emocionale, sipërfaqësore

"Nëse do udhëhiqen nga interesi kombëtar, do ruhet trashëgimia"

Darina Tanushi

Një ditë pas firmosjes së kthimit të dekretit për ndërtimin e godinës së Teatrit Kombëtar, Presidenti i Republikës shpreh keqardhjen për reagimet që pasuan vendimin e tij. Në një reagim të zëdhënësit të Presidentit të Republikës, Tedi Blushi u sugjerohet të gjithë atyre që kërkojnë një zgjidhje për këtë çështje të lexojnë me vëmendje argumentet e dhëna në vendimin për dekretin. "Presidenti i Republikës, duke ndjekur reagimet politike pas publikimit të dekretit për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 'Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar' shpreh keqardhjen për reagimet sipërfaqësore, emocionale e të pathelluara", tha zëdhënësi i presidentit. "Presidenti i Republikës i fton të gjithë të shqetësuarit për ndërtimin e një teatri ri të kenë durim e të lexojnë me objektivitet dekretin, të gjithë arsyetimin, argumentet dhe konstatimet ligjore, të cilat bazohen vetëm në Kushtetutën e Shqipërisë, konventat e marrëveshjet ndërkombëtare ku vendi ynë është palë, detyrimet që lindin prej tyre dhe legjislacionin tonë në fuqi", thuhet në reagimin e Blushit. Sipas tij, "dekreti i Presidentit të Republikës i mbështet argumentet vetëm mbi dokumentacionin zyrtar bashkëshoqërues të ardhur nga Kuvendi i Shqipërisë". Zëdhënësi i Presidencës, Tedi Blushi theksoi se, "Presidenti i Republikës është i bindur se, nëse të gjithë do të udhëhiqen vetëm nga interesi kombëtar dhe publik, jo vetëm garantohet ruajtja e kompleksit teatror e restaurimi i tij si pjesë e trashëgimisë kombëtare, por edhe garantohet ndërtimi i teatrit të ri në mënyrën më transpar-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

ente e më të përgjegjshme, duke respektuar plotësisht legjislacionin aktual, si dhe duke shmangur çdo konflikt artificial". Me këtë rast, Presidenti i Republikës fton të gjithë të interesuarit për zgjidhje të lexojnë me vëmendje në faqen zyrtare të

Institucionit të Presidentit të Republikës <http://president.al/njoftim-per-media/> dekretin, arsyet e kthimit për rishqyrtim në Kuvend të këtij ligji. Presidenti i Republikës, Ilir Meta i riktheu Kuvendit për rishqyrtim ligjin për projektin e godinës

ARGUMENTI LIGJOR

Sipas presidentit, ligji për godinën e re të Teatrit Kombëtar "cenon rëndë parimet kushtetuese të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të pushtetit vendor të 'decentralizimit' dhe 'autonomisë vendore', duke rënë ndesh, njëkohësisht edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve".



Seancë parlamentare

ROBERT NDRENIKA

Aktori i njohur Robert Ndrenika iu kthye dje kryetarit të PD-së, Lulzim Basha. Ai tha se ka shkelur mbi veten duke rënë dakord që teatri të ndërtohet me PPP dhe me kushtin që mos jepet asnjë centimetër për ndërtim kullash. "Në rast se shkelet kjo BESE (që nuk është e mundur) shpreh gatishmërinë për të marrë pjesë në aksionin e vendosjes të minave për të rrezuar kullat", tha Ndrenika.

Basha: Për Ramën nuk ka teatër pa kulla, minat do i presin çdo projekt korruptiv

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha reagoi dje sërish për çështjen e teatrit, duke sulmuar kryeministrin Rama. Përmes një statusi në "Facebook", ai tha se kryeministri ka si qëllim vetëm ndërtimin e kullave. Ai vijoi me paralajmërimin e tij se kullave do t'u vendosen mina. Kryetari i PD ka treguar përmes një video se si sipas tij do të vidhet prona e teatrit dhe prona publike për t'u ndërtuar kulla. "Rama nuk ka asnjë interes për teatër të ri pa kulla. Afera me Teatrin Kombëtar është për kullat e për të futur në xhep 200 mln euro dhe jo për teatrin, sepse për të nuk ka teatër pa kulla. Vetëm për luks qeveritar, Rama ka shpenzuar aq para sa për të ndërtuar 5 teatro kombëtarë", u shpreh dje Basha. "Unë i kuptoj artistët që kërkojnë një teatër më komod. Ka disa mundësi për një teatër të ri, si në Bulevardin e ri të Tiranës ose tek Piramida. Teatri aktual restaurohet në shërbim të artit e kulturës, por edhe si monument unik i trashëgimisë kulturore të Tiranës. Paralajmërimi për Edi Ramën, mafien e ndërtimit dhe mafien e drogës do të formalizohet si një kontratë e Partisë Demokratike me publikun: minat dhe ruspat i presin për çdo projekt korruptiv që do të ndërtohet te teatri", theksoi dje Basha ndërsa publikoi një video ku shfaqen sipas tij detajet se si do të vidhet prona për të ndërtuar kullat.

Nis ndërtimi i këndit të dytë më të madh të lodrave në Tiranë

Teatri, Veliaj: Vonesa prej 40 ditësh nuk e frenon punën tonë

Parku të Madh të Liqënit do t'i shtohet një kënd i ri rekrativ për të gjitha moshat. Bashkia e Tiranës me mbështetjen financiare të TIKAs dhe Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, nisi punën për një shesh të ri çlodhës, me kënd lojërash për fëmijë dhe mjedis çlodhës për të rriturit. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj theksoi se në një qytet, ku fëmijët trajtohen me respekt dhe dashuri që në moshë të vogël, nesër bëhen qytetarë më të mirë. "Një nga arsyet pse kemi sot këto gjërr-vërret e vogla është sepse kemi njerëz që janë rritur keq, nuk janë mësuar të luajnë në skuadër, nuk janë rritur duke menduar pozitivisht, nuk janë rritur që të



shikojnë më të mirën, por ku të gjejnë hapësira për t'i përcarë njerëzit, për t'i ndarë ata, për t'i thënë joprogresit, për t'u trembur nga gjërat e reja. Kjo është arsyeja pse kemi këtë debat sot", deklaroi Veliaj. Duke u ndalur tek çështja e teatrit, ai tha se në shtator projektligji do të miratohet sërish nga parlamenti. Veliaj renditi shumë prej investimeve në kryeqytet, të cilat në fillim

hasën në rezistencë, por që më pas dhanë rezultate fantastike. "Do të presim me durim këto 40 ditë, teksa parlamenti të mblidhet sërish për të kaluar teatrin e ri. Por, gjithmonë pyetja që i bëj vetes është: këta që kundërshtojnë çdo gjë, a nuk ishin po këtu që thoshin mos ma prek liqenin, mos ma prek parkun? A është sot parku më i frekuentuar? Mjafton të shikojmë si është sistemuar këndi i lodrave, pista e biçikletave, pista e këmbësorëve, pista e vrapit dhe Amfitheatri i ri. Mjafton të shohim edhe si u mbollën 126 mijë pemë. Këto pemë u mbollën nga ata që thonë mos prek, apo nga ata që thonë se diçka ndryshon vetëm po u prek me dorë", deklaroi ai.



EDI RAMA

KRYEMINISTRI
"Vetingu vijon të godasë me sukses në kokë oktapodin e korrupsionit degjenerues në drejtësi. Por, për fatkeqësinë e zgjedhësve të saj që e mbështetin vetingun, njësoj si të gjithë qytetarët, e për turpin e saj më të madh, opozita hidhet përpjetë pas çdo goditjeje", u shpreh dje kryeministri.



LULZIM BASHA

KREU I PD-SË
"Edi Rama është koka e oktapodit të drejtësisë, që mbron dhe nuk ndëshkon politikanët e korruptuar e të lidhur me krimin. Për të mbrojtur Tahirin, Xhafajn, Roshin, Frrukun, Dakon, Sejdinin, Ahmetajn dhe Gjinkurin me shokë, Edi Rama kapi Prokurorin e Përgjithshëm dhe zhdukoi Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë", tha dje kreu i PD-së.



Reforma në drejtësi, kryeministri e kreu i PD-së replikojnë në distancë

Rama: Vetingu godet, opozita hidhet përpjetë. Basha: Koka e oktapodit

Kreu i qeverisë e cilësoi opozitën "humbëse pa pikë dinjiteti"

Vetingu dhe reforma në drejtësi përplasi dje kryeministrin Edi Rama dhe kreun e Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Përmes një reagimi në rrjetin social "Facebook", Edi Rama tha: "Vetingu vijon të godasë me sukses në kokë oktapodin e korrupsionit degjenerues në drejtësi. Por, për fatkeqësinë e zgjedhësve të saj që e mbështetin vetingun, njësoj si të gjithë qytetarët, e për turpin e saj më të madh, opozita hidhet përpjetë pas çdo goditjeje". Kreu i qeverisë e mbylli reagimin e tij të shkurtër duke i cilësuar opozitarët "humbës pa pikë dinjiteti". Nuk vonoi dhe kreu i opozitës i ktheu përgjigjen e tij "online", duke e cilësuar kryeministrin "kren e oktapodit të drejtësisë". "Edi Rama është koka e oktapodit të drejtësisë, që mbron dhe nuk ndëshkon politikanët e korruptuar e të lidhur me krimin. Për të mbrojtur Tahirin, Xhafajn, Roshin, Frrukun, Dakon, Sejdinin, Ahmetajn dhe Gjinkurin me shokë, Edi Rama kapi Prokurorin e Përgjithshëm dhe zhdukoi Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë", u shpreh kryetari i PD-së. "Tani Edi Rama po mbron nga vetingu gjyqtarët e korruptuar si Toska, Dvorani dhe Faqolli, si shpërbllim për dosjet që mbyllën dhe si kapar për dosjet që duhen mbyllur. Sa herë PD denoncon me fakte konfirmimin në detyrë në kundërshtim me ligjin e vetingut të shërbëtorit të Edi Ramës në Gjykatën e Lartë, Ardian Dvorani, Edi Rama reagon me akuzat të dala boje kundër opozitës", u shpreh kryetari i PD-së, Basha. Sipas tij, "vetingu i kontrolluar politikisht prej Ramës ka konfirmuar në detyrë gjyqtarë e prokurorë të korruptuar, pavarësisht rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për shkarkimin e tyre. Ndaj, atij i ka rënë maska dhe tregohet botërisht me gisht si njeriu që



SALI BERISHA

"Duke ndjekur farsën e procesit të davoran-vetingut, të reformës unike në botë, pra Orwelliane apo Sorosiane, që ka shndërruar drejtësinë në degë të ekzekutivit të Noriegës, konstatoj se Edi Rama e ka shndërruar këtë proces në një instrument për të bërë gjahun e shtrigave ndaj gjykatësve dhe prokuroristëve me origjinë nga veriu apo nga familje antikomuniste dhe të djathta", tha dje ish-kryeministri.

mbron korrupsionin në drejtësi, për të mbrojtur interesat e veta dhe të krimin të organizuar me të cilin bashkëqeveris". Edhe pak ditë më parë, kryeministri u shpreh: "Fiks dy vjet më parë kaloi pas njëmijëqemtesh reforma në drejtësi. Sot pastrimi i lumit të madh ka nisur pa ndalim. Ndërsa ata njësoj si atëherë i bien njëri gozhdës e tjetri patkoit dhe po njësoj SHBA-BE u kërkojnë t'i thërrasin mendjes. Sa gynah për këdo i beson e deçjon ende". Ndërsa opozita e ka akuzuar maxhorancën se e ka lënë vendin pa Gjykatë Kushtetuese e të Lartë. Ndërsa, kryetari i opozitës, Lulzim Basha propozoi 7 kushte për dialog me maxhorancën sa i përket ligjit për magistraturën. Pas kërkesës për dialog të bërë nga LSI, në seancën e fundit të Kuvendit, Basha tha në një konferencë shtypi se nëse ka ndonjë shans për të shpëtuar reformën në drejtësi, ai është kthimi të konsensusi i 21-22 korrikut. Në 7

propozimet e tij për zgjidhjen e situatës, Basha kërkoi që të zhbëhen të gjitha rregullat ligjore që janë miratuar me detyrë të mbyllura të njëanshme nga ana e maxhorancës, në kundërshtim me frymën e konsensusit të arritur në ndryshimet kushtetuese, në kundërshtim me vetë parashikimet e Kushtetutës. Ai kërkoi zgjidhjen e situatës së paligjshmërisë në organin e prokurorisë, zgjidhjen e situatës së paligjshmërisë në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të jashtëm të KLGJ-së e KLP-së duke eliminuar nga gara të gjithë kandidatët që nuk plotësonin kriteret kushtetuese ligjore apo ishin përjashtuar nga OMN-ja dhe duke përsëritur procedurën e zgjidhjes. Kreu i PD-së kërkoi edhe zgjidhjen urgjente të ngërçit të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, duke evidentuar mekanizmat e duhura kushtetues dhe ligjore që kjo gjykatë të jetë plotësisht funksionale.

Magjistratura, Alibeaj: Të zbatohet Kushtetuta

Nënkryetari i Komisionit të Ligjeve, Enkelejd Alibeaj sqaroi pse opozita nuk u bë pjesë e procesit të miratimit të amendimeve që i hapin rrugë punësimit të magistratëve të diplomuar dhe pranimit të studentëve të rinj. "Unë personalisht kërkoj që të zbatohet Kushtetuta, ashtu siç zbatohet në Amerikë. Çdo ligj do të duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën, edhe ligji për magistraturën", u shpreh Alibeaj për "Vizion Plus". "E mbani mend ambasadorin amerikan se çfarë thoshte për Prokurorin e Përgjithshëm dhe për KLD? Nuk ndëshkojnë gjyqtarët, nuk ndëshkojnë prokurorët, me të drejtë. Si mund të kthehem ne sot në ca vlera, në fakt antivlera të para 4 viteve kur filluam reformën në drejtësi" vijoi më tej Alibeaj. Sipas tij, vetingu po konfirmon në detyrë vetëm ata gjyqtarë e prokurorë që kanë treguar se mbështetin kryeministrin Rama. "Ata kalojnë sot dhe konfirmohen në detyrë dhe ia dinë për nder Edi Ramës, nesër këta do t'i shërbëjnë Edi Ramës që atë të mos e gjejë asgjë nga aplikimi i ligjit penal. Qaq e thjeshtë dhe e kuptueshme është gjithë ky sistem. E në këtë pikë instrumenti që po përdoret nga Edi Rama është organi i vetingut", tha deputeti i PD-së.

Magjistratura, kompetencat t'i marrë Kuvendi

Bardhi: PS të heqë dorë nga kapja e drejtësisë dhe gjejmë konsensus

Nuk mund të bëhemi pjesë e një ligji, i cili bie ndesh me Kushtetutën dhe ligji i propozuar nga PS është antikushtetues". Kështu është shprehur këshilltari për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike, Gazmend Bardhi, i ftuar në emisionin "Kjo Javë" me Nisida Tufën në "News 24", lidhur me ngërçin e krijuar me Shkollën e Magjistraturës. Duke iu përgjigjur deklaratave të ambasadorëve të huaj në vendin tonë, të cilët e konsideruan si dështim të partive mosmiratimin në Kuvend të ligjit për magistraturën, Gazmend Bardhi vlerëson se dështim është mënyra se si po tentohet të zbatohet reforma në drejtësi. Bardhi tha: "Dështim i reformës në drejtësi, në këtë moment dhe i politikës është fakti që Shqipëria nuk ka Gjykatë Kushtetuese". Përfaqësuesi ligjor i PD sheh vetëm një zgjidhje në funksion zhbllokimit të ngërçit të krijuar me Shkollën e Magjistraturës. "Nëse PS heq dorë nga projekti i kapjes politike së sistemit të drejtësisë, konsensusi është shumë i lehtë i arritshëm. Palët duhet të ulen për të zbatuar ndryshimet kushtetuese të miratuara me konsensus. Kemi arritur një konsensus në lidhje me reformën në drejtësi dhe ai konsensus gjendet në Kushtetutë sot. Secila palë do të duhet të zbatojë Kushtetutën e vendit. PD nuk mund të bëhet palë e një deformimi të ndryshimeve kushtetuese, të bëjmë një pazar dhe ta ndajmë drejtësinë në copa", theksoi ai. Sipas ish-ministrit, "meqë nuk është ngritur KLGJ dhe KLP, kompetencën e tyre duhet ose ta ushtrojnë organet e vjetra të sistemit, si KLD apo organe që nuk ekzistojnë më, ose kompetencën ta marrë vetë Kuvendi".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPËRFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.

ÇMIMI 12.016.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 08.08.2018 . CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Koordinatori për procesin "screening" sqaron hapat përgatitore

Negotiatat me BE, Gent Cakaj: Po vlerësojmë kapacitetet për procesin

I përzgjedhur për koordinimin teknik të procesit "screening" dhe harmonizimin e punës përgatitore për çeljen e negociatave me Bashkimin Europian, zv.ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, sqaron se në shtator puna për qeverinë shqiptare do të përqendrohet në kapitujt 23 dhe 24. "Është drejtësia dhe të drejtat fundamentale dhe në anën tjetër është gjendja në gjyqësor, liria dhe siguria, ku përfshihet lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, re-

zultate të theksuara në sistemin e vetingut, konsolidimi i sigurisë së brendshme, prevendimi i numrit shtesë të azilkerkuesve shqiptarë, segmente këto që do përfshihen në procesin e "screening", në mënyrë që legjislacioni shqiptar të jetë i adaptueshëm në nivelin maksimal dhe që këto eventualisht të adaptohen", u shpreh Cakaj, për TV "Klan". I pyetur se ai i ka Shqipëria burimet e mjaftueshme njerëzore e me përvojë për të punuar me drejtorit të specializuara të Komisionit Europian,

sikundër u shpreh edhe gjatë vizitës së tij në Tiranë, komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hah, zv.ministri i Jashtëm tha: "Aktualisht edhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të koordinim me qeverinë është në proces të vlerësimit të kapaciteteve intelektuale dhe përputhshmërisht me rezultatet e studimeve në fjalë. Prej shtatorit e tutje do të fillojë edhe procesi i ristrukturimit dhe zgjerimit të kapaciteteve, në mënyrë që edhe procesi "screening", por edhe ai negociator jo vetëm të zhvillohet brenda fazave të

nevojshme kohore, por mbase edhe me suksesin maksimal të kërkuar". Përcaktues në vendimin e qershorit të 2019-ës, zv.ministri Cakaj thotë se janë hapat dhe performanca që do të duhet të ndërmarrë qeveria shqiptare, duke përfshijtur mundësinë e një vote politike të këshillit. "Vendimi aktual nuk është thjesht se ka qenë i bazuar mbi kritere objektive të padiskutueshme, por natyrisht që ka qenë e përfshirë edhe komponenti politik. Jemi në fazën që nëse Shqipëria i ndërmerr masat e nevojshme, është



moment i padiskutueshëm që këshilli të përgjigjet, që do të thotë që në masë të madhe procesi varet në tërësi nga performanca e ndërmarrë e shënuar e Shqipërisë për reformat e ndërmarrura në fushat e specifikuara në vendimin e këshillit".

Kosova i jep lamtumirën simbolit të rezistencës, "Mandelës" së Evropës

Ilir Meta: Adem Demaçi, model për shqiptarët se si sakrifikohet për atdheun

Vajza e Demaçit: Kisha një baba që e ndava me të gjithë shqiptarët

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ishte dje i pranishëm në ceremoninë mortore dhe homazhet shtetërore në nder dhe respekt të atdhetarit, luftëtarit të lirisë e simbolit të rezistencës kombëtare, "Mandelës" së Evropës, Adem Demaçi. Presidenti Meta u takua dhe u shpreh personalisht ngushëllimet dhe hidhërimin e thellë bashkëshortes, zonjës Xhemajlle Demaçi, si dhe vajzës, Abetare dhe djalit Shqipart, të afërme, miqve, bashkëluftëtarëve, bashkëvuajtësve e bashkëpunëtorëve të shumtë të të ndjerit Demaçi. Presidenti Meta vendoi një kurorë me lule duke bërë homazhe e duke nderuar kujtimin dhe veprën e luftëtarit të lirisë së Kosovës dhe simbolit të rezistencës shqiptare, i cili pas ceremonisë shtetërore të lamtumirës, do të prehet në Varrezat e Dëshmorëve në Velani. Në fjalën e rastit në ceremoninë shtetërore të mbajtur në sheshin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" në Prishtinë, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, në prani të autoriteteve më të larta të Republikës së Kosovës duke filluar nga Presidenti Thaçi e me radhë, drejtuesit e institucioneve të Shqipërisë e Maqedonisë, Malit të Zi, Luginės së Presheves dhe mijëra bashkatdhetarëve të ardhur nga mbarë trojet shqiptare e nga diaspora, u shpreh: "Jemi



mbledhur sot këtu t'i japim lamtumirën e fundit heroit të pashembullt të rezistencës për liri e dinjitet kombëtar e njerëzor: Në jetën e tij prej shqiptari të ndershëm e fisnik, ai kurrë dhe asnjëherë nuk u dorëzua dhe nuk u step. Por qëndroi gjithmonë në këmbë e stoik, ballë për ballë me të keqen dhe tiraninë, në luftë me ata që shtypnin me dhunë popullin dhe kombin tonë. Qëndroi, luftoi dhe fitoi. Duke u bërë për të gjithë shqiptarët, modeli dhe shembulli i përkushtimit për atdheun, i sakrificës dhe i dashurisë për të, i vetëmohimit dhe i dedikimit me gjithçka e pa cak për lirinë e popullit", u shpreh Meta. Në ceremoninë e lam-

tumirës që u mbajt në sheshin "Skënderbeu", presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi e vlerësoi veprimtarin si zërin e ndërgjegjes kombëtare. Për t'i thënë fjalët e fundit ishte edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili e quajti unike veprimtarinë e Demaçit. Në emër të familjes, vajza e Adem Demaçit përçolli mesazhin e fundit që i ati i dha. "Unë kisha një baba që e ndava me të gjithë shqiptarët, sepse edhe mua më ka konsideruar si një pjesë të popullit të vet", tha Abetare Demaçi. Ndërkohë, në ceremoninë që u mbajt në nder të Deaçit, në Kuvendin e Kosovës, e pranishme ishte

nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Vasilika Hysi. Në fjalën e saj, nënkryetarja Hysi tha: "Ndarja nga jeta e Adem Demaçit thërrret për të na bërë më të fortë dhe forcën na e mësoi ta gjejmë në energjitë e tij të pashtershme, që burojnë nga shqiptarizmi dhe patriotizmi. Në vetëmohimin e tij për lirinë e Kosovës dhe liritë e shqiptarëve. Në sakrificat e tij të pashembullta në emër të demokracisë dhe përparimit. Në dhimbjen e tij për të gjitha gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë e Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve. Në aftësitë dhe mësimet e tij të vyerë për të ndërtuar demokracinë dhe institucionet e saj, në shërbim të të gjithë qytetarëve".

SHKURT


"Historia e Diplomacisë Shqiptare", dokumenti i 1922-shtit për vendosjen e marrëdhënieve me SHBA

Historia e Diplomacisë Shqiptare" sjell këtë javë në arkivën "online" materialet përkatëse që flasin për përpjekjet e qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA, proces që u finalizua më 28 korrik 1922. Në korrik 1926 emërohet ministri i parë Fuqiplotë dhe i Jashtëzakonshëm shqiptar në Uashington, Faik Konica, i cili hapi Legatën shqiptare në SHBA dhe kreu këtë detyrë deri pak muaj pas pushtimit të Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe u nënshkruan disa marrëveshje midis dy vendeve, ku mund të veçojmë disa prej tyre si: traktati mbi njohjen e pasaportave amerikane shtetasve amerikanë me origjinë shqiptare, traktati mbi suprimimin e taksës së vizës për pasaportat shqiptare dhe amerikane të personave joemigrantë, traktati i arbitrazhit, traktati i miqësisë për paqen e përgjithshme, traktati i neutralitetit, traktati i ekstradimit të personave keqbërës etj..



Vokshi: PD, e vendosur të anulojë çdo koncesion korruptiv të bërë nga qeveria

Deputetja e PD-së, Albana Vokshi deklaroi dje se PD kur të vijë në pushtet, do të anulojë çdo koncesion dhe do t'u kthejë qytetarëve çdo qindarkë të grabitur nga kjo qeveri. Në një deklaratë të saj, duke folur për koncesionin e "check up"-it, Vokshi u shpreh: "Edi Rama erdhi në pushtet me premtimin e shëndetësisë falas, por shqiptarët po i paguajnë shumë më shtrenjtë me vuajtjet në spitalet pa ilaçe dhe shërbimet e përkeqësuar. Simboli i korrupsionit në shëndetësinë e Edi Ramës është koncesioni i kontrollit të përgjithshëm shëndetësor; i njohur si koncesioni i 'check up'-it, pronar i të cilit është Vilma Nushi, klientja dhe sponsorizuese e Edi Ramës. Koncesioni i 'check up'-it ka dështuar", tha ajo duke shtuar se "ky koncesion duhet të anulohet dhe 7 milionë eurot që i jepen çdo vit klientes së Edi Ramës të programohen për rritjen e shërbimit në spitale". "Partia Demokratike është e vendosur të anulojë koncesionin e dështuar të 'check up'-it dhe çdo koncesion tjetër korruptiv dhe me ligjin e ndryshuar antimafia, çdo pasuri dhe qindarkë e grabitur do t'u kthehet shqiptarëve", tha Vokshi.



Flet dr. Carola Burkert, eksperte për migracionin në IAB, Instituti për Tregun e Punës dhe Studimin e Profesionit

Puna dhe jetesa në Gjermani, sa zgjat procedura për marrje vize

"Deutsche Welle": 6 muaj pritje në Tiranë

Lindita Arapi

Punë dhe jetesë në Gjermani! Si një ëndërr e bukur, që papritur bëhet realitet vendet e Ballkanit Perëndimor: Kështu tingëlloi rregullorja e posaçme e qeverisë gjermane në nëntor të 2015-ës për punësimin legal të qytetarëve nga Bosnja, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia e Shqipëria. Synimi ishte të ullej vala e azilkërkuësve. E vërtetë, jo pak vetë e përmbushën këtë ëndërr. Vetëm në nëntë muajt e parë të vitit të kaluar ambasadat gjermane në vendet e Ballkanit Perëndimor dhanë 19.294 viza pune. Ambasada gjermane në Tiranë arriti për vitin 2017 të japë 2796 viza.

Shifra është e lartë, por duket e pamjaftueshme. Sepse në dyert e ambasadave presin akoma më shumë aplikues për një vizë pune. Për shembull, Agjencia Gjermane e Punës dhe nga janari deri në shtator 2017, 22.773 miratime provizore paraprake për aplikuesit nga Kosova, por viza u dhanë vetëm për 4758 vetë. Miratimi provizor paraprak është kusht për të marrë vizën e punës.

"Numri i kërkesave për vizave është shumëfishuar dhe vazhdon të rritet"

Ministria e Jashtme e Gjermanisë i konfirmoi "Deutsche Welle"-s rritjen e ndjeshme të kërkesave për vizë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim punën në Gjermani. Numri i kërkesave për viza është shumëfishuar dhe vazhdon të rritet".

Një shumëfishim me pasojë, sepse shumë vetë ankohen për kohët e gjata të procedurave për marrjen e vizës së punës në ambasadat gjermane në rajon. Sidomos të bie në sy koha e gjatë e pritjes mes kërkesës për orar deri në datën e aplikimit për vizë. Carola Burkert, eksperte për migrimin tek IAB, Instituti Gjerman për Tregun e Punës dhe Studimin e Profesionit në Nuremberg, rendit për "Deutsche Welle"-n vendet me më shumë kohë pritjeje: "Ajo që bie në sy më shumë është Prishtina, me më shumë se një vit kohë pritjeje, Sarajeva me më shumë se një vit, Beograd 7 muaj, Tirana 6 muaj, kjo ka qenë gjendja në shkurt 2018. Por nuk duhet të llogarisni vetëm këtë kohë, por edhe kohën



PUNËMARRËS NE GJERANI

Kleisi Hazizi, një djalë i ri nga Tirana që kërkonte një perspektivë të re gjatë një kontratë pune të përhershme si speditor tek firma "Wertbau" në Gjermani. Ai ia ka dalë të fusë dokumentet e kërkuara. "Por po kalojnë më shumë se 4 muaj dhe ambasada nuk më ka kthyer përgjigje. Puna në Gjermani vazhdon dhe jam akoma në Shqipëri", thotë ai i shqetësuar. Kleisi ka frikë se mos e humbet punëdhënësin. E kontaktuar nga "Deutsche Welle", firma "Wertbau" konfirmon se do ta merrte atë me dëshirë në punë, nëse ai e merr vizën.

CAROLA BURKERT

"Situata e punonjësve në sektorët e vizave është katastrofale, pra për sa i përket presionit të kohës, kritikave që bëhen, fluksit të madh që kanë. Për këtë fluks ata nuk ishin të përgatitur, si nga ana e personelit, por edhe e kapaciteteve".

e përpunimit të dokumenteve. Përfytyrojeni, ju keni një ofertë, punëdhënësi ka nevojë për ju tani e ju nuk shkoni dot sepse nuk keni vizë, oferta bie, sepse si punëdhënësi unë gjej dikur një zgjidhje tjetër".

Me shpenzime personale në kërkim të kontratës në Gjermani

Pikërisht kjo i ndodhi Bekim Imerit nga Gostivari. Shoferi i kamionëve kishte një ofertë pune nga Paderborni. Por për shkak se viza e punës nuk u dha në kohën e duhur, punëdhënësi u tërhoq. "Askush nuk të pret kaq gjatë në Gjermani", thotë ai. 46-vjeçari mori vetë rrugën në kërkim të punës. "Erdha vetë në Gjermani dhe shpenzova shumë para për një kohë të shkurtër".

Bekim Imeri pati fat. Për shkak se shoferët e kamionëve kërkohen në Gjermani, ai gjeti një punë të re tek "Eraslan Logistik GmbH". "Punëdhënësi i ri më tha të mos humbas asnjë ditë, sa të marr, vizën duhet të nisem menjëherë", thotë Bekimi. Pas më shumë se 7 orë pritjeje në ambasadën e Shkupit, ai i dorëzoi dokumentet. Tanimë është në pritje, gjithmonë me frikën se mos e humbet edhe këtë shans të dytë për punë.

Caku i mbingarkesës

Pse kjo kohëzgjatje? Ministria e Jashtme gjermane thekson se, "koha e pritjes për një orar për të aplikuar për vizë varet nga kërkesa dhe kapacitetet që janë në dispozicion në sektorin përkatës të vizës. Edhe koha e përpunimit varet nga secili

Ministria e Jashtme e Gjermanisë i konfirmoi "Deutsche Welle"-s rritjen e ndjeshme të kërkesave për vizë nga vendet e Ballkanit Perëndimor, me qëllim punën në Gjermani. Numri i kërkesave për viza është shumëfishuar dhe vazhdon të rritet".

rast individualisht. "Ministria e Jashtme gjermane i ka përforcuar maksimalisht përfaqësitë në vendet e Ballkanit Perëndimor, madje edhe ambientet janë shfrytëzuar maksimalisht", thuhet në shpjegimin e saj. Duket se ambasadat kanë arritur cakun e mbingarkesës. Carola Burkert nga Instituti i Tregut të Punës, IAB e njëj problematikën. "U

tha se do të zgjerohen rrugët legale me kushte të caktuara për njerëzit nga Ballkani Perëndimor, por nuk u zgjeruan dhe shtuan strukturat për këtë", kritikon ajo qeverinë gjermane. "Situata e punonjësve në sektorët e vizave është katastrofale, pra për sa i përket presionit të kohës, kritikave që bëhen, fluksit të madh që kanë. Për këtë fluks ato nuk ishin të përgatitura, si nga ana e personelit, por edhe e kapaciteteve".

Frika nga humbja e vendit të punës

Ndërkohë, tensioni i aplikuesve që presin për vizën e punës shtohet dita-ditës. Vendi i punës në Gjermani pret, por edhe sa? Kleisi Hazizi, një djalë i ri nga Tirana që kërkonte një perspektivë të re gjatë një kontratë pune të përhershme si speditor tek firma "Wertbau" në Gjermani. Ai ia ka dalë të fusë dokumentet e kërkuara. "Por po kalojnë më shumë se 4 muaj dhe ambasada nuk më ka kthyer përgjigje. Puna në Gjermani vazhdon dhe jam akoma në

Shqipëri", thotë ai i shqetësuar. Kleisi ka frikë se mos e humbet punëdhënësin. E kontaktuar nga "Deutsche Welle", firma "Wertbau" konfirmon se do ta merrte atë me dëshirë në punë, nëse ai e merr vizën. Por ndërkohë edhe një pengesë tjetër del përpara. Marrja e miratimit provizor paraprak tanimë nuk bëhet nga punëdhënësi, por në një procedurë të brendshme sektori i vizës e merr atë tek Agjencia e Punës. Nëse miratimi provizor paraprak, dikur me një afat gjashtëmuajor, skadon, për Kleisin do të thotë të fillojë procedurën nga e para. Carola Burkert e kritikon këtë ndryshim në procedurë. "Kjo kushton edhe njëherë kohë dhe resurse personeli".

Bekimi pret. Kleisi pret. Punëdhënësit në Gjermani presin. Të gjithë në pritje që një ditë, dikush në sektorin e vizës të nxjerrë dosjen nga stiva e gjatë e aplikimeve. Por se kur do të ndodhë kjo, këtë nuk e di askush.



Qëllohet me breshëri arme një banesë në Fierzë, familjarët ikin nga shtëpia: Ndihehi të kërcënuar

TROPOJË - Të shtëna me armë zjarri janë shënuar mëngjesin e së shtunës në Fierzë, ku persona ende të pidentifikuar kanë qëlluar me armë në drejtim të një banese. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në fshatin Poravë, ku në shënjestër të sulmit ka qenë banesa e Lek Ndout. Fatmirësisht nga të shtënat

nuk ka pasur persona të lënduar, ndërsa dyshohet se ngjarja ka lidhje dhe me furgonin që u qëllua me armë mbremjen e së premtes. Pak pas ngjarjes, familjarët kanë lënë banesën, ndërsa u shprehën se ndihen të rrezikuar për jetën, pasi janë të kërcënuar. Pas kryerjes së veprimeve hetimore para-

prake, dyshohet se ngjarja e djeshme ndodhi disa orë pasi Ndou qëlloi me armë drejt furgonit të Tonin Pepkolajt, i cili po udhëtonte nga Tirana në drejtim të Fushë-Arrëz, pas një shërrë për pasagjerët e linjës. Mësohet se Lek Ndou kishte konflikt me djalin e shoferit të furgonit, ku ky i fundit u sul-

mua me armë zjarri rreth orës 21:00 të së premtes, pranë zonës së njohur si "Gropa" në Fierzë. Fatmirësisht nga të shtënat ndaj furgonit me targë AA982MG nuk pati të lënduar (mjeti u godit nga tri plumba). Vetëm tri javë me parë ndaj banesës së Lek Ndout u qëllua me breshëri plumbash. Policia po vijon hetimet për zbardhjen e dy ngjarjeve si dhe identifikimin e autorëve.

E dashura rrëfen bisedën: S'e prisnim këtë ikje me vrap, Izeti është në udhëkryq

TIRANË

Edashura franceze e Izet Haxhisë, i cili ndodhet në burg ka treguar djë një bisedë që ka pasur me të në qeli. Në profilin e tij në "Facebook", ajo shkruan se në bisedë e sipër, Izeti i ka thënë se asnjë nuk po e merr në dorë çështjen e tij. "Izet Haxhia u vetëdorëzua për të kërkuar drejtësi dhe rihapje të çështjes 'Hajdari', duke marrë parasysh të gjitha problemet kolosale në drejtësinë shqiptare, duke marrë parasysh edhe rrezikun e një moshapje të çështjes. Sepse mjaft, ishte mjaft! Tepër është tepër!", shkruan ndër të tjera francezja në 'FB'. Ndërsa, shprehet se Izeti ndodhet në udhëkryq.

POSTIMI NË "FB"

Miq të mirë, miq të shtrënjtë!
Kur fola pak minuta më parë me Izetin (që ju përsëritet të gjithëve një nga një) më bëri pak për qeshur, sepse në një moment tha me një çudi shumë të natyrshme: asnjë s'po më merr në dorë, ç'është kjo? Dukej i habitur, i miri im prej drite... dhe qesha me sinjeritetin dhe spontanitetin, që ma tha këtë...

Izet Haxhia u vetëdorëzua për të kërkuar drejtësi dhe rihapje të çështjes 'Hajdari', duke marrë parasysh të gjitha problemet kolosale në drejtësinë shqiptare, duke marrë parasysh edhe rrezikun e një moshapje të çështjes... Sepse mjaft, ishte mjaft! Tepër është tepër!

Por tani... tani, askush nuk e priste këtë dorëheqje dhe ikje me vrap të çdo gjyqtari nga dosja e tij! U kthyen të gjithë në struca, askush nuk do ta marrë përsipër... Këmbët e lehta e faqja e bardhë...!

Izeti ndodhet në udhëkryq! Drejtësia nuk po prononcohet as me data, as me shorte, as me emra të përveçëm. Posta Shqiptare, bën si e paditur dhe refuzon të ketë kontakt me avokatin apo me punonjësit e burgut që shkojnë për të tërhequr paket për Izetin. Me pretekstin që s'ka ardhur gjë në Shqipëri. Ndërkohë harrojnë që mua posta franceze më nxjerr me dokument ditën e saktë kur janë futur në Shqipëri... një lëshim gënjeshtër!

Midis vetingut, dosjes së

Izet Haxhia, mesazh nga burgu 302: Asnjë s'po më merr në dorë...

"Të gjithë po fshihen mbrapa plazheve dhe harrojnë që do ikë edhe kjo verë"



Izet Haxhia

vrasjes së shekullit, vapës, Dhërmiut, pushimeve, frikës dhe panikut, siç duket të gjithë po fshihen mbrapa plazheve dhe harrojnë që do ikë edhe kjo verë, si çdo verë tjetër! Nuk i shpëtojnë dot pritjes dhjetëra vjeçare të Izet Haxhisë për drejtësi!

Edhe sikur asnjë gjykatës të mos pranohet (meqë janë kolegë me Fatmira Hajdarin) në një moment, do detyrohet dikush, që t'i futet punës, qoftë edhe vetë Fatmira Hajdari! Përlyerja nga të gjitha

anët i bën të panikuar për shkak të dëshmitarëve të thirrur nga çdo krah i politikës shqiptare!

Por nuk kanë ku shkojnë... Vetëm se po i zgjasin burgun Izetit, po zgjasin shkëputjen e ne të dyve, që është tepër e dhimbshme për të dy...

Izeti po duron me modestitë, me besim e me shumë gjëra që i rëndojnë padrejtësisht...

Unë, unë nuk jam shumë fance e modestisë, sepse be-

soj tek një thënie e Shopen-haurit: "... Kur më në fund mendon se je dikushi dhe vërtetë je rritur në vlerë, personalitet, dije, fillo tregohu krenar me meritat e tua, virtyti i modestisë është një shpikje që u shërben vetëm budallenjve, sipas modestisë secili duhet të flasë sikur të ishte në rrafshin e krediteve vetjake të të tjerëve. Kështu që, duke u rrafshuar të tërë, në botë nuk do të kemi veçse teveqelë".

Të dua shpirti im, jam me ty në çdo pritje, e shkurtër apo e gjatë qoftë!

Ps: asaj Postës Shqiptare, nuk do t'i ndahem, sepse s'jam as modeste, as e duruar dhe as mirëkuptuese në lojërat e tyre prej skilleverish të bindur...!

Tung të gjithëve prej Izetit!

Unë ju falënderoj personalisht gjithsecilin, për qëndresën dhe besnikërinë tuaj!

Pushime të mbara!

SHKURT

Sekuestrohet gomonia me 412 kg kanabis, në kërkim autorët

VLORË - Një sasi e madhe lëndësh narkotike, e llojit kanabis është gjetur dhe sekuestruar pasditën e djeshme në Vlorë. Sipas policisë, droga është gjetur brenda një gomoneje të fshehur në afërsi të derdhjes së lumit Vjosa. "Strukturat policore të DVP Vlorë në bashkëpunim me Policinë Kufitare thonë se gjatë operacionit kanë sekuestruar se 412.5 kg kanabis, 1 gomone dhe 60 litra benzinë. Dyshohet se sapa kanë pikasur policinë, personat përgjegjës kanë braktisur mjetin lundrues me të cilin po transportonin lëndën narkotike. Vijon puna për identifikimin e kapjen e autorëve të kësaj veprimtarie të paligjshme. Materialet hetimore për rastin iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprën penale "Trafikimi narkotikëve, mbetur në tentativë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së qytetit bregdetar.

Kultivuan 764 bimë kanabis, 3 në pranga dhe një në kërkim

MALLAKASTËR - Tre persona janë arrestuar në flagrancë nga policia në Mallakastër, pasi dyshohet se janë kultivues të 764 bimëve narkotike, të gjetura përgjatë përroit të fshatit Mushonjë. Në pranga janë vënë shtetasit Arsen Lamaj, 24 vjeç, Neim Ametaj, 46 vjeç dhe 23-vjeçari Anel Ametaj, të tre banues në fshatin në fjalë. Ndërkohë, është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e shtetasit H.D, 22 vjeç, banues në Berat. Sipas policisë, dyshohet se ky i fundit bashkëpunonte me tre personat e arrestuar. Materialet në ngarkim të këtyre personave i janë përcjellë për hetime të mëtejshme prokurorisë së Fierit. Pritet që gjykata e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj tyre.

Trafikonte armë nga Maqedonia në Elbasan, arrestohet në Përrenjas 32-vjeçari



PRRENJAS - Goditet aktiviteti kriminal në fushën e trafikimit të armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake në Përrenjas. Një 32-vjeçar nga Maqedonia, por me banim në Kosovë është arrestuar gjatë operacionit të koduar "URAKA 1", ndërsa iu sekuestruan dy pistoletë dhe fishekë në makinë, të cilat dyshohet se do i

trafikonte. Bëhet fjalë për Ylber Sumën, lindur në Shkup dhe banues në fshatin Dimcë, komuna Hani i Elezit në Kosovë. Ai u kap në fshatin Urakë të Përrenjasit. Burime nga policia bënë me dije se i riu i kishte futur në mënyrë të kundraligjshme armët nga Maqedonia, me qëllim për t'i shitur ato më pas në qytetin e Elbasanit,

kundrejt vlerës 500 euro copa. Mësohet se armët dhe fishekët të riut iu gjetën gjatë kontrollit të automjetit tip "Alfa Romeo" me targa SK3771AD, të cilin e drejtonte vetë. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, për veprën penale "Trafikimi i armëve të zjarrit dhe municioneve luftarake".

Ish-prokurorit të përgjithshëm iu sekuestruan pronat, dyshohej se mund t'i tjetërsonte

Zbardhet dosja e Adriatik Liallës, prokuroria: Ja skema që përdorej për pastrim parash

"Blinte toka në periferi të Tiranës me çmim të lirë dhe i shiste më pas me vlerë dhjetëfish më të lartë"

TIRANË

Pak ditë pasi Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda në Tiranë vendosi sekuestro preventive mbi disa pasuri të ish-kryeprokurorit Adriatik Lialla, që kap vlerën e rreth 1 miliard lekëve, "News 24" ka zbardhur vendimin e kësaj gjykate. Vendimi në fjalë vjen pasi Lialla po hetohet për akuzën e pastrimit të parave. Në hyrje të vendimit bie në sy fakti se çështja penale ndaj ish-kreut të akuzës është regjistruar kryesisht, mbi bazën e të dhënave të publikuara në media, ku ndër të tjera flitet për jetën e luksit që bënte Adriatik Lialla dhe familja e tij. Një tjetër argument që prokuroria ka marrë në konsideratë është edhe fakti se po përmes medias është informuar se ish-prokurorit të përgjithshëm i ishte ndaluar hyrja në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vijim, prokuroria rindërton skemën sesi Adriatik Lialla dyshohet se pastronte para. Konkretisht, ai blinte prona në periferi të Tiranës me një çmim të lirë dhe pasi i rivlerësonte, i shiste me çmim të lartë. Në vendimin e gjykatës thuhet ndër të tjera, se ish-kryeprokurori bleu 3 mijë metra katrorë tokë në shumën prej 1.5 milionë lekësh dhe pasi e rivlerësoi, e shiti në shumën e 249 mijë eurove. Nga ana tjetër, në po të njëjtën zonë, ish-kreu i organit të akuzës, pasi ka shitur këtë pronë, ka blerë një sipërfaqe tjetër toke prej 4500 metrash katrorë në shumën e 4.5 milionë lekësh, të cilën më pas e ka rivlerësuar gati dhjetëfishin e çmimit të blerjes. Referuar fakteve të mësipërme, prokuroria ka dyshime se Lialla ka konsumuar veprën penale të pastrimit të parave, për sa kohë që jo vetëm nuk i ka deklaruar pasuritë në kohë, por ka kryer transaksione me të njëjtin person, duke blerë prona nën çmimin e tregut e duke i shitur me vlerë disa herë më të lartë. Në vendim thuhet gjithashtu se pronat e ish-kryeprokurorit u vunë nën sekuestro, pasi ekzistonin dyshime se ai mund të ndërhynte për t'i tjetërsuar ato.

SEKUESTRIMI I PASURISË

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi bazën e akteve të ardhura për kompetencë lëndore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr.65 viti 2018, në ngarkim të shtetasit Adriatik Lialla, ish-Prokuror i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të hetimeve paraprake të kryera lidhur me këtë procedim penal, në bashkëpunim të ngushtë me Policinë Gjyqësore në Drej-



Ish-kryeprokurori Adriatik Lialla

AKUZAT

Çështja penale kundër ish-kryeprokurorit Adriatik Lialla nisi fillimisht nga Prokuroria e Durrësit për katër akuzë. Ndërsa tani po hetohet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Konkretisht ai po hetohet për veprat penale të "Refuzimit për deklarim, mosdeklarimit, fshehjes ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave private të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Mosdeklarimit të shumave të të hollave në kufi", "Pastrimit të produkteve të veprës penale" dhe "Shpërdorimit të detyrës".

torinë Hetimore Qendrore, pranë Departamentit të Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Si rezultat i veprimeve hetimore të kryera, janë krijuar dyshime të arsyeshme se disa pasuri të

paluajtshme në zotërim të shtetasit Adriatik Lialla përbëjnë produkt të veprës penale. Me vendimin nr.179, datë 20.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë është vendosur pranimi i kërkesës së

prokurorisë, vendosja e masës së sigurimit pasurore "sekuestro preventive" për pasuritë e paluajtshme të mëposhtme: Apartament banimi, me sipërfaqe 67.2 m², ndodhur në Durrës. Tokë arë, me sipërfaqe

PASURITË NËN SEKUESTRO

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 67.2 m², ndodhur në Durrës.
2. Tokë arë, me sipërfaqe 4.500 m², ndodhur në Tiranë.
3. Tokë arë, me sipërfaqe 12.300 m², ndodhur në Tiranë.
4. Tokë arë, me sipërfaqe 3000 m², ndodhur në Tiranë.
5. Tokë arë, me sipërfaqe 2250 m², ndodhur në Tiranë.

4.500 m², ndodhur në Tiranë. Tokë arë, me sipërfaqe 12.300 m², ndodhur në Tiranë.

Tokë arë, me sipërfaqe 3000 m², ndodhur në Tiranë. Tokë arë, me sipërfaqe 2250 m², ndodhur në Tiranë.

Policia Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Tiranë, në datën 23.07.2018 ka ekzekutuar vendimin gjyqësor për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme të mësipërme. Vlera e tregut e pasurive të paluajtshme të mësipërme, në total është në shumën 98.772.000 lekë. Vijnë hetimet e mëtejshme lidhur me këtë procedim penal në bashkëpunim me Policinë Gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Shtetit Tiranë.



Ekstradohet nga Greqia i dënuari me 12 vite burg për vrasje në Berat

TIRANË - Një 55-vjeçar nga Berati është ekstraduar dje nga Greqia në Rinas, ndërsa ishte shpallur në kërkim për vrasje. Burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se bëhet fjalë për Anesti Paskos alias Bedri Ibrahim, i cili ishte dënuar me 18 vite burg për një vrasje të ndodhur gjashtë vjet më parë. Ngjarja për të cilën është dënuar 55-vjeçari ka ndodhur më datë 26 mars të vitit 2012, në një lokal në fshatin Poshnje të Beratit. Burimet e mësipërme sqaruan se në lokal ka pasur një konflikt mes shtetasve Anesti Paskos, B.I., K.I dhe shtetasve G.P., E.P dhe S.P. Si pasojë e këtij konflikti, ka mbetur i vdekur nga goditjet me thikë shtetasi S.P., si dhe janë plagosur G.P. dhe E.P. Shtetasi Anesti Paskos ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi gjykata e ka dënuar me 18 vite burg për veprën penale të "Vrasjes në rrethana cilësuese, në bashkëpunim, e mbetur në tentativë".

Pipero: Pacientët qëndruan 3 orë nën vëzhgimin e mjekëve

Konsumuan suflage me mish në ish-Blokk, 11 persona përfundojnë në spital të helmuar

TIRANË - Konsumuan suflage në një 'fast-food' në zonën e ish-Blokkut, por më pas përfunduan në spitalin infektiv në QSUT. Bëhet fjalë për 11 pacientë, të cilët u paraqitën mbrëmjen e së premtes në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive me të vjellë, diarre dhe temperaturë. Shefi i SHSI, Pëllumb Pipero u shpreh dje për "Klan Plus" se pacientët që i drejtohen infektivit janë të shumtë. Ai tha se çdo ditë në këtë spital mbërrijnë mbi 100 raste, ndërkohe që helmimet nga ushqimi zënë pjesën më të madhe të pacientëve që paraqiten. "Në rastin e mbrëmshëm (të së premtes) ishin 10-12 qyteta-



rë që kanë ngrënë ushqim në një lokal, kanë konsumuar të gjithë suflage me mish dhe të gjithë kanë pasur çrregullime gastrointestinale, të cilat nënkuptojnë të përziera, të vjellë, diarre dhe temperaturë", pohoi Pipero. Sipas

mjekut infeksionist, pacientët kanë qëndruar 3-4 orë nën vëzhgimin e mjekëve dhe pasi kanë marrë shërbimin mjekësor, janë larguar. "Klan Plus" është drejtuar pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik të Tiranës për rastin në

fjalë, ku sipas specialistëve, është ngritur grupi i punës për të kryer hetimet dhe se janë bërë analizat e ushqijve, si dhe të punonjësve. "Pranë një lokali, ku kemi marrë denoncimin, ka shkuar një grup për të marrë mostrat ushqimore, të ujit dhe kampionët e feçeve për personelin, i cili punon në atë lokal. Mendoj se nga dita e hënë do të dalin edhe rezultatet e para", tregoi shefja e Shërbimit të Epidemiologjisë, Ermelinda Musai. Nëse do të konfirmohet helmimi nga ushqimi, për subjektin do të merren masat që parashikohen në ligj, që nis me gjob deri në mbyllje të aktivitetit.

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon dokumentet që duhet të dorëzojnë përfituesit

Ornela Manjani

Pronarët që aplikuar për kompensimin e pronës në vitet 1997 dhe 1998, për të cilët ka një vendim për njohjen dhe kompensimin e pronës duhet të plotësojnë formularin-tip për të marrë paratë. Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon formularin dhe dokumentet që duhet të plotësojnë rreth 3260 përfituesit në të gjithë vendin për të marrë kompensimin në para ose kompensim fizik. Për dosjet e vitit 1987 janë 1460 pronarë dhe dosjet e vitit 1998 janë 1800 pronarë. "Gazeta Shqiptare" publikon formularin, dokumentet si dhe listën me pronarët që duhet të plotësojnë dokumentet për të përfituar kompensimin.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK

Sipas formularëve-tip mësohet se kërkuesi, duket të cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës vërtetim nga gjykatat, nëse vendimi përfundimtar i apo vlerësimi të tij është ankimuar apo jo në

rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve, prokurorë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfutur ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandati pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 mil-

ionë lekë për çdo vendim të njohur: Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuarra financiarisht si tokë truall përfundimtar kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimtar e procesit të kompensimit të pronave

thotë se subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

PAGESAT E PËRSHPEJTUARA

Pronarët mund të përfitojnë edhe pagesa të përshpejtuara. Janë vendosur tri afate pagesash të përshpejtuara. Pagesë brenda një viti, brenda tri vitesh dhe brenda pesë vjetësh. Për secilin variant në një VKM të posaçme është përcaktuar edhe përqindja e pagesës. Për pagesën brenda një viti pronari merr 20% të vlerës së futurës, për pagesën brenda

tri viteve merr 30% dhe brenda pesë viteve merr 40% të vlerës së kompensimit dhe heq dorë nga pjesa tjetër e kësaj vlerë. Të gjitha subjektet që kanë një vendim përfundimtar kompensimi, pavarësisht rendit kronologjik të tij dhe llojit të zërit kadastral të pronës së vlerësuar, kanë të drejtë të aplikojnë pranë ATP-së me kërkesë të veçantë, ku shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht. Kërkesat e veçanta për kompensim financiar do të trajtohen sipas kësaj procedurë: nga çdo fond vjetor buxhetor i kompensimit financiar, jo më shumë se 1/3 e tij mund të përdoret për

kërkesat e veçanta të kompensimit financiar, të gjitha subjektet kërkuese, të cilat shprehin vullnetin për t'u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duhet të aplikojnë pranë ATP-së brenda vitit të ciljes së fondit vjetor buxhetor të kompensimit financiar. Pas aplikimit për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, ATP-ja përgatit vlerësimin financiar të pronës, pavarësisht rendit kronologjik të vendimit dhe në rastin e disa aplikimeve për kompensim me kërkesë të veçantë do të zbatohet rendi kronologjik i datës së vendimeve për këto aplikime.

DOSJET E VITEVE 1997-1998

DOSJET E VITEVE 1998

Bashkia Emri (Subjekti Kerkues)

VLERESIMI

- Maliq Skender Avdyllari 326,274
Korçë Yllson Arifi -31,186,900
Korçë 100,000
Tiranë ATEM SEFA (SUF)
Shijak Nexhmedin Kau 1,748,978
Durrës Gezin Kikri 7,049,040
Korçë Rosel Dodona 1,790,280
Skrapar Perat Sefa 531,783
Berat Fitim Mimani 260,340
Berat Shashivar Nuri 993,394
Berat Jaho Sherif Pire 5,823,743
Kuçovë Tefik Hekuran Mecka 3,507,922
Lezhë Dan Mema 851,100
Bulqizë BUSH HALIT MURRA 1,912,896
Mat MEHMET XHEPA 137,503
Mat HAKIK KOLA 369,000
Lezhë Hilmi Hafizi 861,000
Përrenjas Makbule Khanaku 1,004,449
Përrenjas GURALI BOZHA
Kolonjë Misioni Shenjtor Eleonor 185,070
Shkodër Lac Osman Hysa
Shkodër Arjana Bekteshi 1,319,205
Vorë ZOJE SHPRESA -142,204,240
Devoll Rexhep Sterkeshi 0
Elbasan SHEFIKAT BILYKBASHI 841,320
Librazhd Hysen Koza
Librazhd Refat Hila 197,184
Korçë
Korçë
Durrës Ali Laçi
Divjakë Petro Kruti 1,659,237
Divjakë Rabushe Kuka 4,281,470
Lushnjë Loni Pina 1,885,839
Lushnjë Reshat Pajolli 931,856
Lushnjë Xhedral Leka 1,250,066
Lushnjë Rakiq Dervishi
Lushnjë Nafie Dervishi 3,313,872
Lushnjë Isuf korreshi 519,173
Skrapar ZYFER KOCI 238,031
Skrapar ZYFER KOCI
Gjirokastrë Mehdi Rrapo Budini 870,045
Skrapar Ali Hasanaga 815,581
Polican Nehat Kalluci
Fier Petraç Quni 8,929,806
Fier Islam Kallica 3,007,032
Fier Zaim Lami 6,456,965
Fier Nikollaj Nilo 2,620,414
Fier Zyber Beqaj 1,048,081

- Fier Ferrik Kodheli 4,184,747
Fier Banush Vrenozit 1,478,512
Fier Sali Krasniqi 2,508,110
Fier Ismail Krasniqi 1,227,851
Fier Ferman Yeziri 3,664,429
Patos Servet Balla 2,573,789
Fier Liambi Bitri
Fier Llaqi Bitri 2,717,283
Fier Gjyljika Malaj 1,718,304
Fier Sokrat Vojo 9,240,747
Fier Isuf Xhujaj 2,308,664
Fier Koçi Mine 9,750,000
Patos Gani Pajaziti 1,127,637
Fier Dhimitraq Sota 622,778
Fier Petraç Sinani 37,500,000
Fier Petraç Sinani 6,594,143
Fier Vasil Sinani 6,647,182
Patos Ylli Sallaj 808,032
Fier Leksi Siedu
Fier Gori Vimeh 6,976,480
Fier Vasilqaj Dhima
Fier Zoi Kulari
Fier Sefto Hodaj 3,867,900
Fier Kozma Kola 1,028,549
Fier Nadire Hysaj 2,020,081
Roskovec Perit Mebelli 12,258,074
Fier Themi Solla 37,500,000
Fier Rrapi Sallaj 1,274,520
Fier Vangjel Samarxhiu
Lushnjë Ymer Likja
Korçë Thoma Kallço 1,768,000
Korçë -4,090,800
Korçë Tefta Filipçe -49,232,500
Korçë 601,517
Kavajë Kasem Haka, Nuredin Haka
Kavajë MARIJE ETJ TELI 1,913,015
Sarandë Maq Gjoni -9,129,920
Durrës Muhamet Dyzeni
Kavajë Rifat Verria
Selenicë Ismete Ceta 508,989
Fier Vasillo Papakosta 772,684
Selenicë Like Skëndaj 52,316
Fier Pali Kodri 2,181,678
Selenicë Luftar Hodaj 2,485,404
Selenicë Petref Hodaj 2,691,034
Fier Mevlut Hoxha 5,074,581
Vorë Avdul Kapllani 899,870
Selenicë Ziadet Muameti 1,250,275
Selenicë Petrit Qerimi 736,293
Fier Trifon Janka 3,601,972
Himarë Mjedi Skëndaj 663,940
Selenicë Feta Xhemalaj 398,554
Selenicë Plikrime Krutaj 142,681
Selenicë Bexhet Beqiraj 1,845,336
Fierë Argjentina Pazaj 4,704,870
Fierë Jorgji Kosta 516,642
Fierë Zenel Kulla 1,624,270

- Krujë Alush Zgurja 2,171,200
Dibër Ruzhdi Shehu -135,948
Kuçovë Agif Kanani 4,848,379
Kuçovë Ymer Zavalani 1,536,808
Lezhë Mark Matrizi (Truci) 489,717
Elbasan AZEM ELPLAKU 748,690
Elbasan SHEFQET G.JONI 299,476
Elbasan SABRI HOXHA 721,390
Elbasan SABRI G.JONI 449,214
Elbasan DEMIR G.JONI 355,091
Kukës Shaban Jakup Zenela 449,336
Kukës Ismail Rasim Benah
Shkodër Mokol Ramadanaj 518,400
Shkodër Mustaf Kadija 0
Durrës Mehmet Cara
Durrës Fatmir Drogju 3,064,800
Durrës Drita Shani
Librazhd Ismail Bajlazi 271,323
Librazhd Muhamet Mysliu 293,485
Përrenjas SHAHIN KYLLI 1,749,448
Peqin GANI RIZA HOXHA 2,687,918
Lushnjë Pandi Todri 2,989,849
Lushnjë Arjan Velimishi 10,384,343
Lushnjë Adem Nezhza 474,988
Shkodër Eljaz Barraj 3,984,698
Rrogzhinë Fatmir Mahmudaj, Hamide Mahmudaj, Shygyri Mahmudaj 1,374,643
Tiranë RAPUSH BIRAÇI 235,899
Vorë Mirka Bezhani 479,407
Selenicë Armen Zeneli 237,801
Vorë Ceno Taja 4,520,766
Vorë Naimet Shabani 2,693,135
Selenicë Kujtim Bazaj 1,303,886
Vorë Shezai Arapj 1,908,299
Vorë Thoma Qarri 3,969,282
Himarë Llambro Varfi 320,111
Vorë Kastriot Hamiti 1,965,310
Vorë Jahja Pula 557,145
Selenicë Dalan Mahili 841,816
Selenicë Koçi Bombaj 1,777,064
Vorë Ali Forati 2,071,170
Berat Koli Kristo Karaj 133,169
Berat Teodor Llambi Sinjari 278,918
Ura Vajgurore Izet Haxhi Velçani 1,039,560
Kuçovë Avdyli Qamili Feimi 1,190,923
Pushë Ardet Preke Gijete Geci 110,784
Ura Vajgurore Refat Ismail Qojle 694,637
Ura Vajgurore Nikollaj Naun Qafoku 1,868,195
Berat Kozma Laçka 792,746
Polican Ljçi Papa 697,900
Polican Stefan Spiro Papa 1,384,602
Polican Tomorr Ali Kalemaj 2,470,599
Berat Muhamet Kutelli

- Skrapar Syri Zyka 1,263,414
Skrapar Viktor Alushani 687,322
Trojopë Din Ibrahim Gjoni 14,668
Elbasan AGIM SHARRA 3,163,114
Shkodër Selim Mema 52,500
Përmet Sofi Tole 570,722
Përmet Ylli Tase 334,456
Përmet Krisanthi Mano 61,828
Përmet Petraç Goroshiani 9,205
Përmet Dhimiter Xhorxhi 57,072
Korçë Ligor Temo 1,311,741
Maliq Meroe Kosiava
Korçë Dhimitër Dudo 1,133,186
Pogradec Hasan Shtupa 390,327
Pogradec Agim Lipo
Pogradec Enver Sulollari 1,909,362
Pogradec Remzi Hyka
Pogradec Skënder Konomi
Korçë Krişavqj Kolemico 418,540
Korçë Mehmet Gorari 1,884,185
Korçë Theodorqaj Kolenica 243,362
Korçë Edmond Kamenca 29,834
Maliq Ymer Piliçiq 578,809
Belsh MELEQE PEPA 668,988
Fier Muharrem Gurguri 1,871,724
Gjirokastrë Banush Xhemo Gjirokastrë
Lezhë At Ottavio Vitale
Shkodër Arshi Kraja 14,243,140
Korçë Perit Bacelli 270,293
Korçë Bexhet Fidanj 182,848
Korçë 306,000
Korçë 3,283,658
Korçë -21,572,500
Korçë Gaqo Bilinci 60,884
Maliq Mihat Bilingji 654,377
Lushnjë Fitime Beqa 7,803,239
Kolonjë Muharrem Metko 1,944,894
Devoll Gue Bajraktari 299,511
Devoll PERPARIM TARE 829,521
Shkodër Fëmija Deda 1,123,123
Devoll Zylfije Skembo 1,002,551
Gramsh XHAFER QOSE 2,006,004
Gramsh XHEMEL LAZI 736,016
Gramsh NAZMI MURATI 663,857
Gramsh MUHARREM MURATI
Gramsh ALUSH HALLI
Gramsh SHEFIT HAXHILLARI 607,574
Gramsh KUTIM HOXHA 493,082
Gramsh 1,962,708
Gramsh HALIT LESHII 423,329
Gramsh BIDO HOXHOLLII 250,149
Gramsh 1,109,435
Gramsh MUHARREM QEHAJAJ 1,723,143
Gramsh YLLI BRACI 832,227

- Elbasan SALI SPAHUI 294,647
Shijak Shefqet Ndroqi
Durrës Niza Kalamishi 787,500
Shijak Muharrem Koka
Durrës Muharrem Kuqi
Lushnjë isa turku 1,304,864
Lushnjë Shefti Pepa 3,220,069
Lushnjë Mucu Buzi 5,640,730
Lushnjë Jorgjie Doga 6,394,061
Lushnjë Petrit Mucu 3,535,762
Divjakë hajrije kasa 3,039,071
Lushnjë Qerim Sefa
Lushnjë andrea Iloshi
Kavajë ANASTASIA ETJ GERGO 2,349,060
Durrës MUHAMED ETJ HERSI 822,500
Kavajë RIZA GJUZI 3,311,385
Kavajë SHABAN XEKA 246,842
Kavajë ISMAIL HOTI 3,290,000
Kavajë MIHANE, ISMAIL KRASNIIQI 1,633,156
Rrogzhinë BANUSH MINE TOSKU 2,886,456
Kavajë Leme Qosja
Kavajë Kasem Haka 1,891,001
Kavajë Agron Ceveli, Behije Ceveli, Fiqire Ceveli, Luftje Ceveli, Lufti Ceveli, Petrit Ceveli, Rifat Ceveli, Zemane Ceveli 653,064
Kavajë Pëllumb Vrapj 510,671
Rrogzhinë Bujar Saraçi, Drita Saraçi, Fiqire Saraçi, Hajri Saraçi, Ismail Saraçi, Lumturaj Saraçi, Zenepe Saraçi 332,352
Kavajë Qenan Shehu 5,052,321
Devoll Osman Sabri Shurdho -
4,458,455
Piniq Fatime Noga 208,774
Devoll Veli Rota 0
Shkodër Trashigimtare Causholli 1,000,897
Shkodër Trashigimtare Duli 2,978,850
Durrës Shoqje Varoshi 7,203,945
Durrës Athina Bala 1,843,494
Korçë Diana Miço 2,975,000
Korçë Pandeli Thanasi 639,278
Maliq Hatixhe Myftaraj 254,449
Korçë Thoma Jorgji 66,841
Korçë Demir Kanto 1,550,000
Korçë Ylli Shytilja 3,451,802
Korçë Naim Panariti 3,338,453
Devoll Lirika Kane 274,954
Berat MAKSIM SHEHU 1,563,438
Berat Feribent Shehu 1,563,432
Berat Zana Shahu (Doko) 718,487

- Ura Vajgurore Asip Islam Jaho 1,162,878
Kuçovë Zyfer Asim Berzeshta
Ura Vajgurore Hazis Ali Tafa 284,124
Pogradec Fatos Minarolli -3,598,032
Berat Muharrem Rrapo Braka 3,219,054
Sarandë Pano Rexho 4,849,650
Sarandë Ollga Stefani 3,524,079
Berat 312,820
Ura Vajgurore Petraç Dhaskali 271,842
Berat BURIM MUSTAFA SHEHU 1,464,124
Krujë Kasem Topalli
Gramsh JONUZ XHANGOLLI 230,907
Gramsh MEHMET LILA 245,339
Gramsh ZENEL ZENEJA 959,707
Gramsh 179,915
Gramsh SHANKO AJAZI 261,694
Gramsh SHABAN HOXHA 336,258
Gramsh ZENE META 730,243
Gramsh 815,871
Gramsh BAKI TARKO 177,991
Gramsh XHEZAR YMERI 697,531
Gramsh ARDJAN CELA 558,025
Vorë Vita Bombaj(Balliu) 1,192,800
Peqin Reshit Skilla 6,504,929
Peqin RESHIT SKILLA
Rrogzhinë 3,149,603
Rrogzhinë Bardhy Gjoni, Luftije Gjoni
Berat Perina Teki Carcani 1,464,124
Tiranë MUSA, GJYLJE CANI 91,686
Kamëz MEREME LUQA
Durrës Isa Alibejsi
Fier Sotir Kola 798,072
Fier Padil Ziu 11,000,000
Fier Ajlet Kodheli 3,174,744
Fier Sheit Kallolli 841,848
Fier Koçi Doko
Fier Thoma Malo 6,824,621
Fier Tasi e Lili Mërtiri 6,654,778
Fier Elmaz Gropa 2,151,763
Fier Llaz Bardhi 561,734
Fier Koçi Goca 5,803,941
Fier Shaqo Nevraj 5,513,000
Fier Harrilla Kane
Fier Fiqiri Kuci 269,000
Fier Liri Çomo
Fier Kalopi Golemi
Fier Vangjel Sauli
Fier Spiro Sauli
Fier Mihal Koroveshi 4,983,200
Fier Vasil Turxhulla 5,661,916
Fier Isa Hoxha 1,060,067
Përrenjas Osman Bosi
Peqin SKENDER QEFALLA 3,339,708

Table with 4 columns: Name, Address, Phone Number, and other details. The table lists numerous individuals and their contact information, organized in a grid-like structure.

Në Butrint si popull i teatrit...

Nga Përparim Kabo

PAK HISTORI...

U mbush më shumë se gjysmë shekulli që kam hyrë në teatër, është fat, gëzim, është edhe mençuri, të rritesh me teatër sepse skena të mban pezull me emocion, të pastron, por mbi të gjitha të bën të mendohesh, jo vetëm gjatë shfaqjes, por edhe kur largohesh nga salla. Prej 16 vitesh, ose më saktë nga viti 2000, në kapërcyell të mijëvjeçarit, dy njerëz Alfred Bualjoti dhe Edmon Xhumari menduan ta risillnin teatrin në shtëpinë e vet, në amfiteatrin e Butrintit. Një ide ndriçuese. Janë bërë më shumë se 18 vite. Me dy vite ndërprerje për shkakë monetare, ndaj këtë vit u zhvillua edicioni 16-të. 8 korrik 2018 nata ka rënë e plotë, liqeni Butrintit dremmit bashkë me shpirtrat e nëndheshëm. Nga hyrja kryesore në qytetin antik të Butrintit të bëjnë udhë dritëzat e kuqe anash rruginave të ngushta deri sa mberriin tek amfiteatri. Monumenti i gurtë është i mbushur plot e përplot me shqiptarë dhe të huaj... si asnjëherë më parë... Ky fakt na gëzon sepse tregon që njerëzit e duan teatrin dhe teatri vetëm kështu ka të ardhme... Fjala e hapjes e zotit Bualjoti që kumton aq bukur... "nëse ju vini kështu si sonte bindemi se pavarësisht nga vëshirësitë, ne duhet ta vazhdojmë këtë punë". Më tej ftesa e tij për mua që t'i drejtohem publikut të gjerë. Një emocion tejet i veçantë. Të flasësh në Butrint. Asgjë e parapërgatitur. Por shpirti është i ngazëllyer, mendja nuk mund të mos të jetë gati, fjalët e bardha janë në një farë mënyre të edukuara nga dhe përmes teatrit.

Të dashur miq, ne e duam teatrin e në një farë kuptimi ne jemi komb teator dhe jo komb stadiumesh. Para pak kohësh isha në Dodonë, një amfiteatër gjigant. Jo larg prej Butrintit është Bylisi, Apolonia dhe më tej akoma amfiteatri i Durrësit. Ja përse me rrënjë dhe me histori në jemi një popull teator. Jemi sonte këtu që të nderojmë dhe Aklepijon, perëndinë e qytetit, baptesierin me tetë kolonat, numrin simbol të pafundësisë, më tej është bazila me çatinë e hapur që pret të restaurohet. Le të shpresojmë! E në fund porta e "Luanit", që na kujton kanonët e vjetër. Kur vijmë në Butrint, ne si të thuash jemi edhe në respekt të Jul Çezarit, që kishte letërkëmbim me qytetin, por edhe për të kujtuar komunikimin që kishte Ciceroni dhe Oktaviani me parinë e qytetit. Kjo histori na bën nder, por edhe më të përgjegjshëm për historinë tonë. Pse teatri nuk humbi, nuk u zhduk, pse ai mbijetoj? Mendoj për shkak të tre D-ve... (D)ashurisë, (D)injitetit dhe (D)iolizmit.

Njeriu nuk jeton pa dashurinë si ndjenjë njerëzore, por edhe për shkakun se dashuria është çiment e historisë. Pa dashuri nuk mund të takosh ëndrrën. Dashuria e shpie njeriun te liria dhe e

At Zef Pllumi e kumtoi edhe këtu psalmin e tij... ndoshta për zotat, por me siguri edhe për ne mëkatarët



farkëton si luftëtarin e saj. Dinjiteti lidhet me dashurinë. Në filozofinë e sotme moderne, por edhe më herët, jeta ka provuar se pa dashuri dhe kreativitet, nuk ndërtohet dot personaliteti e më tej akoma, pa personalitet, nuk mund të jesh dinjitoz. Dinjiteti nuk mund të sterilizohet, pasi për rrjedhojë sajohet njeriu i padenjë tek i cili mungojë motivimi, kuraja, shpirti luftarak, etja për ndryshim. Pa këtotribute s'ka dinjitet. Pa vlera dhe pa dashuri njeriu mësoi të hijeq sikur i kishte dhe i mbronte, ndaj ju nënshtrua procesit të diabolizmit. Ja përse teatri lindi dhe u zhvillua. Bashkë me njeriun lindi dhe gënjeshtra. Lindi dhe u rrit një pushtet që është tashmë kaq i vjetër, hipokrizia njerëzore. Ndoshta që kur ajo gjysmëgrua e gjysmëperëndi, Pandora, e solli atë kuti çudirash dhe e hapi për të vënë përballë njerëzimit e në radhë të parë ndaj burrave që duhet të jepnin ato prova e sprova. Nga kutia dolën jeta dhe vdekja, vjedhja dhe gënjeshtra. Kështu, për të zotëruar dashurinë dhe për të veshur dinjitetin e paqenë dhe të pamerituar, njeriu krijoi dhe usheu me përrnjtë e së keqes diabolizmin. Këto janë arsyet që e mbajtën gjallë dhe fuqiplot teatrin, këtë art antropologjik. Këto tri D-të krijojnë "trekëndëshin e Bermudës" për njeriun dhe gjithçka varet nga këndet. Nëse trekëndëshi është barabrinjës, atëherë tri D-të janë nga 60 gradë, por nëse ky raport prishet dhe diabolizmi është 120 gradë dhe dashuria e dinjiteti bashkë 60 gradë, atëherë njeriu shogëria, ëndrra, gëzimi, e ardhmja, drita janë të mjegullta, janë në rrezik. Ja përse duhet teatri, ja përse lindi dhe përse ekziston. Ballkani është vatra e tragjizmit dhe komedive të mëdha, aq sa edhe vetë fjala dramë që do të thotë lëvizje lindi këtu, në këtë trevë.

Ne jemi krenarë që si popull i takojmë teatrit. Butrinti i ka pasur, i ka dhe do t'i ketë bijtë e vet. Ne jemi sonte bijtë të Butrintit. Një popull pa teatrin e vet nuk ka as histori të së shkuarës, as histori të së ardhmes. Është i pafat dhe i verbër.

SHFAQJET...

Shfaqja e natë së parë ishte nga Shakespeare. "Nata e 12-të", një realizim i Teatrit të Metropolit të Tiranës me regji të regjisorit amerikan Justin Anderson. Konceptimi regjisorial nisur edhe nga fakti që ngjarjet zhvillohen në Iliri ishin trajtuar me ngjyrim tipik shqiptar: ku batuta e kolosit të teatrit ishte shpallur me një stil të hollë me humorin tipik folklorik të disa krahinave tek ne... Shpirti i spektaklit ishte fjala aktoriale e Neritan Liçës, e Roza Kostanit e Memet Xhelilit dhe një kaste aktorësh të rinj, që luajnë me shumë profesionalizëm dhe më dashuri e pathos aktorial. Ulje-ngritjet emocionale, loja brenda lojës, dyzimi i personazheve, ngatërrimi fateve

dhe dashuritë e pëshëlluar deri në qartësimin final, humor deri në dimensione grotesk, veshjet, muzika live dhe vallet ndërtuar nga koreografi Donald Martini na dhanë një kënaqësi estetike dhe emocionale, duke e mbajtur pezull frymën e spektatorit, i cili u përfshi i tëri duke geshur dhe duke shoqëruar me duartrokitje aktorët. Loja e identitetit të rremë krijon jo vetëm humor, por edhe grotesk. Këtë e gjejmë të Servantesi, por edhe të Shakespeare. Jam ai që nuk shfaqem dhe paraqitem, jo ai që jam. Mbasse përtej dukjes mund të ketë një shpirt të njollësuar e gri, por mund të ketë dhe dëlirësi, që rrethanat e detyrojnë të luajë me maskën e mosshfaqjes hapur se cili apo cila është. Dashuritë na bëjnë të përcudnohem. Një natë e paharrueshme për "Natën e 12-të"... në Butrint.

PËR NERITAN LIÇAJN DHE MEMET XHELILIN...

Në "Natën e 12-të", ata kanë dy role karakter... budallanë e menjëherë, që u tregon të gjithëve se jeta dhe njeriu, fati dhe përfitimi, dashuria dhe xhelozia mund të shndërrohen në mënyrë diabolike thjesht në lojë fjalësh... Ky dyzim fjalë dhe përjetim sillte paradoksin dhe kundërrjedhjen e logjikës me veprimin e thënies dhe me kundërrjedhjen. Neritan Liçaj tregoi me karakterin që krijoi se ju njerëzit e sërës së lartë e lypni budallallëkun tim sa herë doni të qeshni, por kur ai tregohet si mençuri diabolike, dukeni të pazotët pa përballon, sepse jo gjithnjë ju pëlqen dhe ju gëzon e vërteta.

Mehmet Xhelili na shpalosi një aspekt të ndër të Groteskut... Njeri që fryhet si tullumbace yshur nga tejkalimi i ëndrrës, duke menduar se nga shërbëtor, mund të jetë kalorësi blu i Yllit që ndrin... Loja e keqkuptimeve dhe thyerjeve emocionale e sjelljeve si ngjitje-ujlë shkallësh emotive dhe përjetimesh shpalosën një figurë karakteriale tipike shqiptare. Loja e këtyre dy



aktorëve më dha shumë gëzim dhe kënaqësi estetike. Komedia që diabolon me komunikimin në një farë kuptimi tregoi se komunikimi është vetë ekzistenca. Kodet e tij janë të shkrhuara, janë të shfaqura, por janë edhe të pashkrhuara, janë pothuaj të fshehura, janë gati-gati eterike. Shpesh ndodh që komunikojmë duke mos dashur ta pohojmë atë që ndjejmë dhe kështu krijohen botët imagjinative, hamendësimet paralele. Sajohet sa hap e mbyll sytë një lloj fluturimi me ajrin e dëshirave, krahitelli në fantazi. Kështu kombinimi mbetet ikje, lidhje dhe destinacion mes atij që e krijon dhe figurës imagjinare. Grotesku në thelb është pasja e një ëndrrë më të madhe se ti i ke mundësitë dhe besimi se gjithçka është realitet që ti pret ta prekësh.

...ME TRUPËN E SALAMINËS-GREQI...

Tragjizmi grek me tre korifentë Eskili-Sofokliu-Euripidi në skenën e Butrintit përmes monologëve më pikantë të kryeveprave të tyre. Aktorët e trupës së Salaminës derdhën në skenë gjithçka, fjalën e ndër, kobin e tragjizmit, komunikimin me zotat, shpëtimin dhe pendimet dërrmonjese kur kuptohet se vdekja veç vdekje sjell. Na përcollën hidhërimin për humbjet dhe ndërtuan në një dekor asket vetëm falë fjalës dhe ndjeshmërisë humbëtraku bie trupi e shpirti vrasës përballë shkatërrimit të jetëve njerëzore, gjithçka që la gjurmë në skenën e antikitetit. Tragjizmi grek është sa historik, aq edhe klapues. Ai paralajmëroi se vdekja si vrasje do e shoqëronte njerëzimin në jetë të jetëve. Patkëqishtë njeriu ishte i ngarkuar me këtë mision barbarie sa kohë që yshtja për pushtet, për zotërim dhe pushtime... por edhe për dashuri të vjedhura apo kurora e shtretër të përdhosur, e shpjen njeriun në gjendje të tilla për t'u mos vetëpenguar që të shkojë deri në vrasje... Kanë kaluar po thuaj 3000 vite dhe ja, njeriu nuk u edukua ta braktisë vrasjen... Shpesh tragjizmi





greq është i skajshëm... tejet mi-zor...

Mendoj se kolosët e mendimit tragjik si vepër dramatike e kanë zgjeruar dimensionin frikshëm për të tërhequr vëmendjen dhe vetëdijen e njerëzimit... për ta trembur racionalisht, me qëllim që dora që vret të ndalet, sepse vrasjet vrasje sjellin. Është si një pije e egër, që duhet ta pimë me pika për t'u imunizuar në emër të mbrojtjes së jetës. Ndryshe le të kujtojmë vrasjet e asaj kohe (si ato të Medeas) për t'u bërë esellë dhe për të dalë jashtë kllapisë, e cila brenda njeriut thërret... 'vrite, vrite, vrite!' Faleminderit regjisorit, dramaturgut dhe kritikut të shquar, Dinos S. Koubatis, që kishte përgatitur performancën! **Tragjiko-medizmi i antikitetit është universiteti i historisë që pasoi. Dilema ka qenë dhe mbetet të flasësh apo të heshtësh. Historia ndodh edhe nëse ti njeri nuk flet, nuk e ngre zërin, nuk mbron të vërtetën, por ajo që ndodh s'ka si të ketë lidhje me kontributin tënd të munguar... Tek e fundit ti je thjesht heshtja dhe si e tillë je e pafata, je asgjëja që mund të thuash vetëm se kur ndodhte dhe historia më kërkoi kontributin... unë merrja frymë si një kacek pafuqje dhe padinjiteti...! Jam viktimë e heshtjes sime, ose plaga e asaj që fola gënjeshtërt. Pas shfaqjes u takova me aktorin që interpretoi Edipin mizor (mbret). Të takosh një mbret-aktor pasi ka qarë i verbër mizoritet e tij, një mbret në gjunjë që zvarritet i mjerë është emocion i thellë. Ishte një interpretim brilant i aktorit Ilias Gatzonidis si shprehje, si gjendje, si fjalë, por mbi të gjitha si dëshpërim. Në zërin e tij mes kujës, pafuqisë dhe pendimit lexoje gjithë universin e humbjes së gjithçkaje, kur kishe menduar se do ta fitoje gjithçkanë. Shpirti njerëzor nuk duhet trajtuar si magazinë e plaçkës.**

NJË MBRËMJE SPECIALE ME AKTORËT NGA SHKUPI...

Raporti i njeriut me ndërgjegjen, sjellja dhe ndërsjell-



ja. Historia dhe liria. Ndryshimi dhe dishepujt e tij janë gjykatësit apo të gjykuarit?! Ikja apo mbajtja e përgjegjësisë, çfarë janë, gjykim apo shpikthimi ndaj tij?! Vlerësimi apo nënçmimi i atij që të ndriçon udhën e mendjes, çfarë është mirënjohje apo zhgënjim?! Sakrificat dhe tallja, apo më keq akoma, shpërdorimi i asaj drite të thellë që quhet vetëdije, çfarë është triumf apo gjunjëzim?! E mbiqishmja dhe mbiempirikja, çfarë janë? Arsyje, mendim, teori, logjikë apo thjesht përgjegjësi?! A dimë të ndërtojme përgjegjësi, po ta mbajmë, a dimë?!

Po të gjitha këto përgjigje alternative vlejné veçse mitologia tek figura (heroi dhe kurban) e Prometheut, ka një simbol të vetëm, zjarrin! A do të mjaftonte që prej tij të dilnin të gjitha veprat dhe aventurat njerëzore?! Regjisorit Dejan Projkovski ka rrokur dhe materializuar kumtin universal se përtej zjarrit është diçka më sublime... më frymëzuese, më e anatemuar në gjithëkohësi... e kryqëzuar si mëkatore... është vetë drita...Arsyeja=Dritë... Zeusi u zëmërua dhe i tha Prometheut: "... mirë që ua dhe njerëzve zjarrin, por pse ua dhe edhe grave...". Akti parë i mëkatimit është popu-

njerëzore, realizuar mjeshhtërisht nga grupi i pesë vajzave. Një shfaqje model për nga konceptimi, nga regjia dhe lëvizja, për nga ndriçimi dhe zhurmat. Ishte e vetmja shfaqje që u duartrokit disa herë gjatë zhvillimit dhe u mbyll me bravoo të gjata në fund. Fat për mua që e ndoqa, aq më tepër në amfiteatrin e Butrintit. Prometheu në Butrint, një materie sa historike po aq edhe filozofike, pse jo edhe për çartje të tjera. Më provokon emri i grupit teator nga Shkupi, teatri "Fabrika", i cili guxon me qasje eksperimentale, por që kohën dhe hapësirën e ruan në original, ndërsa sjelljen e konvencionon duke gërmuar në qenien njerëzore larg manierizmit. Është si një lloj rigjykimi për të takuar mundësitë e panjohura. T'i kthehesh së shkuarës nuk është vetëm kujtesë, ka më shumë një rivlerësim të udhës.

SHËRBJENJËT E SHPËRDORUAR

Gjithmonë ka pasur njerëz që thirren me bilbil, janë njerëzit që shërbejnë, ata që rropaten e që strapacohen, janë ata që urdhërohen deri në përcymim po nga njerëz; nga ata që mendojnë se lumturia është luksi, është hedonizmi. Ky kontrast jepet me një gjuhë koreografie muzikale dhe pantomime në shfaqjen e trupës së Balletit të Teatrot të Operës dhe Balletit Tiranë me koreografinë e Barak Marshall, i cili ka studiuar për teori sociale dhe filozofi. Njeriun që shërben ai e quan ndërmjetësi. Po çfarë ndërmjetëson ai? Botën që duket nga ajo që nuk duket? Luksin shpërdorues dhe njeriun që nuk i mbetet kohë të jetojë jetën? Apo ai/ata janë të tillë deri sa shpërthejnë? Balerinët tanë të talentuar kërcyen dhe aktruan mrekullisht. Një mbrëmje që e pasuroi historinë e jetës së Butrintit antik. Kohët e tona. Ngjarjet rrokullisen. Shoqëria vesh e zhvesh kostum. Zakonet ndryshojnë. Moderniteti krijon dekorin. Po pse brenda njeriut mbetet ngasja për ta poshtëruar po njeriun? Përse ai nevojitari i duket ndryshe dhe jo si vetja, atij pasunorit. Dallimi është vetëm material, sepse i pasuri ka pasuri dhe i varfëri ka krahët? Vetëm kaq? Do ishte gabim i rëndë po të mendonim kështu. I varfëri ka shpirt dhe dhembshuri, ka dinjitet dhe nderra, do të dashurojë dhe të krijojë familje, do të lindë fëmijë dhe të sjellë të ardhmen. Po ja që ai nuk konsiderohet. Bilbili u thjesht i urdhrit, por i zhbërjes së njeriut në nevojë që mendohet si mekanizëm, si vegla që nuk flet, që nuk ka të drejta; e ka depersonalizuar atë. Duket u thjesht aristoteliane, sepse shkohet edhe më tej.

Trondit si pagane, vjen e errët dhe e frikshme nëse e shohim këtë kontrast si sëmundje të shoqërisë globale. Interpretimi koreografik ishte tejet profesional, harmoni, dinamizëm, lojë teatore, duete dhe dancing në grup, ku mesazhet përcilleshin me një energji frymëzuese. E them me gojë plotë, ne kemi kërcimtarë brilantë. Shkolla që krijuan Miltiadh Papa dhe Agron Alia, Panajot Kanaçi e Zoica Haxho, Albana Sulejmani e Ilir Kerni, Gert Vaso e Enada Hoxha është një akademi që lindi nga shkolla e Rudolf Nurievit dhe u përcoll në breza. Gjatë shfaqjes aktori maqedonas që interpretoi Prometheun më tha: "Ju paskeni kërcimtarë të klasit botëror. Po - i thash - edhe

balletmaestri i parë i trupës së Operës Shtetërore të Vjenës, Eno Peçi është shqiptar". Duhet më shumë vëmendje ndaj tyre mendova aty pari, sepse edhe artistët e pakonsideruar mund të shndërrohen fatkeqësisht në "Shërbenjësit e shpërdoruar"... thjesht ndërmjetës që harrohen! Ata janë Alisa Gjoni, Rovena Shqevi, Ledia Sulaj, Amela Prifti, Fjoralba Zere, Loretta Bala, Dion Gjini, Julind Derishi, Besi Skura, Andi Vrapit, Kristi Dushmani, Anxhelo Muçollari. E them këtë sepse para ndoca muajsh, disa balerinë tanë që kërcëjnë në teatrot më në zë të Europës dhe botës dhanë një shfaqje model në Tiranë... porse heshtja institucionale më tingëlloi e hidhur.

AT ZEF PLLUMI NË BUTRINT...

S'e di a kishte qenë më në Butrint më parë po Ati erdhi në amfiteatër nën një qiell të hapur mes heshtjes së publikut sy e vesh dhe frymës së aktorit Arben Derhemi në një monodramë rrëfijëse impresionuese.

...Fjala e tij na tregon burgun, më saktë burgjet dhe se çfarë ndodhte me njeriun... me atë që burgosej dhe me atë që të burgoste. Ai që kishte prangat në duar dhe këmbë rrihej, torturohej, gjakosej, tallej poshtërohej, por ai sërish mbante shpresën. Donte të rita-kontë lirinë. Eh për këtë qëllim fisnik, njeriu ruante thellë vetes dashurinë. I duhej të ushqente kujtimet. I nevojitesh si oksigjeni për atë pak gjëzim si dhe për botën shtazore që sillet më humane me të burgosurit se sa shtazët e push-tetit (historia e ujkut në shpellë, e zogjve të pulës në burg dhe e macës që donte të lëshonte shpirtin mes të dashurve të saj). Nga ana tjetër ishin njerëzit e regjimit. Sistemi i kishte bërë veç vegla gorre. Shoqëria e tyre që kopeja e shërbimit të verbër ndërsa, shpirtinat e tyre, ah ata kishin humbur, qenë sëmurur e kishin vdekur me kohë. Ata shërbenjësit as ishin të lirë dhe as donin e nuk dinin se duhej të ishin të lirë! Po çfarë iu duhej liria?! Ajo kishte humbur brenda tyre, aq sa nuk e kuptonin nëse kishte qenë dikur. Në një vend ku edhe kufoma nuk mund të dilte nga burgu pa shkuar ora dy e drekës që të mbushej ora e plotë e përfundimit të dënimit, si edhe ndodhin më një nga të burgosurit më e bashkëvuajtës me atin e shpien të burgosurin Zef Pllumi të thoshte shprehjen ma therëse: "Po mirë, as kufoma të lira nuk ka në këtë vend...". Tek regjimi ra, edhe Ati po dilte nga burgu. Ai e veshi veladonin e priftit dhe prej shpirtit belbëzoi: "Çfarë pash e lash këtu e di, po a do të gjej njerëz të lirë jashtë?!... Loja e Arben Derhemit erdhi e ngrohtë, me një përdëllim të brendshëm si një dritë me fitil mbajtur në poçe vajit që mos fikje, me ulje e ngritje të monologut dhe udhëtimin në nënshtrës emocionale. Diagrama njerëzore që aq e kthjellët dhe piktoroi të gjithë ata njerëz që në një kohë burgun mund të kryenin veç një gjë të thjeshtë, ta tregonin të vërtetën... Peshë e rëndë kjo... Ne që kemi qenë jashtë burgut, ende s'e kemi mësuar ta bëjmë...! At Zef Pllumi e kumtoi edhe në Butrint psaltin e tij... ndoshta për zotat, por me siguri edhe për ne mëkatarët. "Rrëno për me Tregue", kjo është udha, fati, besa dhe e vërteta që duhet mëkuar.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



E DIEL


29 Korrik

2018



ROBIN HANBURY -TENISON

“Land of Eagles”
dhe fodullëku i
ministrit shqiptar



Në sallën shkencore të Bibliotekës Ko mbëtare në vitin 1992-'93 më ra në sy një fytyrë e re. Ishte një burrë trupmadh me kokë si të skalitur në lis. Kishte tipare të një njeriu me karakter të fortë që të ngjallte respekt. Ai ulej të tavolina e qoshes së majtë në rreshtin e fundit, pra kur hyje në sallë mund ta shikoje po të ktheje kokën nga e majta. Lexonte dhe shkruante me një përgendrim që binte në sy. Ndonëse e kishte sallën të gjithë përpara, ai nuk e ngrinte kokën për të parë kush punonte, kush hynte e delte e as për t'ua tërhequr vëmendjen atyre që ndalonin e bisedonin në këmbë gjatë hyrjeve e daljeve. Nuk i afrohej askujt. Asnjëherë nuk e pashë të pinte

NË KRISHTLINDJE ME LAZËR RADIN

kafë me dikë. Kuptohej se kishte shumë mendime dhe vepra për të hedhur në letër...

Një ditë, kur po delja nga salla për të bërë pushim me shokun tim Iliaz Gogaj, i sugjerova ta ftonim burrin e qoshes për kafë, por Iliazi më bëri me shenjë se mund ta takonim një herë tjetër. Pastaj gjatë bisedës kur po pinim kafën, më sqaroi se ai burri i qoshes quhej Lazër Radi, një ish i burgosur që kishte kaluar shumë vite

nëpër burgje dhe internime. Dinte disa gjuhë, ishte diplomuar në Itali për Jurisprudencë. Gjatë viteve të burgut e kishin futur në grupin e punës për përkthimin e veprave të ndryshme për të ndihmuar kuadrot e Partisë e të Sigurimit. Dikush i kishte thënë Iliazit, se gjatë viteve të burgut këtë zotëri mund ta kishin rekrutuar si informator të Sigurimit, prandaj afrimi me të mund të na sillte ngatërresa.

Një thashethem të tillë për një intelektual si Lazër Radi, që u burgos në nëntor të vitit 1944 me akuzën **Armik i popullit**, nuk mund ta kuptoja atëherë se në ç'kuzhinë ishte fabrikuar. Por sot, pasi është zbuluar ecuria e zbatimit të Planit *Katovica* në shoqërinë shqiptare, e kuptoj fare mirë. E kuptoj sepse tashmë kam njohur biografinë dhe jetën e tij, si do ta tregoj më poshtë. E si të mos e kuptoj sot, pasi kam lexuar mjaft

shpifje të çuditshme të pushtetarëve tanë për intelektualë e krijues të dënuar prej partisë shtet, sikur ata kanë qenë bashkëpunëtorë të Sigurimit. Po përmend për ilustrim rastin e z. Bujar Nishani, me detyrën e Presidentit të R. SH., që hodhi poshtë propozimin e zotit Edi Rama, Kryeministrit, për emërimin e shkrimtarit të shquar Visar Zhiti Ambasador pranë selisë së Vatikanit. Zoti Nishani dha si sqarim se kishte marrë një mesazh në facebook nga një person i panjohur me inicialet P. V., ku shkruhej se z. Visar Zhiti, paskej qenë informator i Sigurimit të Shtetit gjatë viteve kur vuante dënimin si i burgosur i ndërgjegjes në burgun e Spaçit...! (Gazeta Dita, Tiranë 22 mars 2017).

➔ Vizion në faqen 14

{ Në këtë numër: THANAS GJIKA, NDREK GJINI, NDUK UKAJ, LUAN RAMA, DURIM TAÇI ETJ... }

P

PËRKUJTIM

NGA THANAS L. GJIKA

Vijon nga faqja 13

Pas ndërrimit të regjimit, Lazër Radi filloi të botonte shkrimet e para te gazeta *Rilindja Demokratike*, por shumë shpejt iu tha se nuk ishte mirë që kjo gazetë të botonte shkrime të një të dënuari si ai, sepse njollosej Partia Demokratike si parti që po mbështetë tek ish armiqtë e popullit. Me të njëjtin pretekst u organizua më vonë dhe një farë fushate për mënjanimin e atyre deputetëve të PD-së që i përkisnin shtresës së të përndjekurve. Nga 26 deputetë të tillë që pati kjo parti në vitet 1992-'96, pas disa vjetësh mbajti vetëm nja dy prej tyre, kurse të tjerët i zëvendësoi me disa shërbëtorë besnikë të Sali Berishës, ose ish komunistë e ish-sigurimsa.

Thënë shkurt, Lazër Radi me përgatitjen, talentin dhe të kaluarën e tij, i bënte hije çdo pushtetari demokrat, madje dhe vetë kryetari të Partisë Demokratike. Po të shkruante shpesh në atë gazetë, ai do të fitonte popullaritet dhe nesër mund të zgjidhej deputet dhe mund të arrinte në poste të larta të qeverisë pluraliste.

Lazri, ashtu si Iliazi dhe unë, gjetëm një përkrahje të ngrohtë për botimin e shkrimeve tona te gazetën *Rilindja* e Prishtinës, që asokohe publikohej në Tiranë për shkak të përndjekjes që i bëri Millosheviçi. Vështrimet tona ishin të njëjta ndaj historisë dhe kulturës sonë. Ishim demokratë të ndershëm, por thashethemet e përhapura jo pa qëllim nga shtabi i planit *Katovica*, na penguan të afrohemim e të bëheshim miq.


Pas largimit tim në SHBA, më 1996, disa vjet u shkëputa nga shtypi i Tiranës dhe nuk munda të lexoja gjë nga shkrimet e Lazër Radit. Vite më vonë, kur Lazri ishte larguar nga jeta, u njoha përmes internetit me një mikun e tij, me ish të përndjekurin Lek Pervizi, piktorin dhe rapsodin e burgjeve të kohës së diktaturës, i cili publikonte në Bruksel revistën internetike *Kuq e Zi*. Ky më sugjeroi të publikoja shkrime të mia edhe në revistën simotër *Radiandradi.com* që publikonte në Itali Jozef Radi, djali i Lazrit. Në këtë fletore lexova artikuj e pjesë nga veprat e Lazrit, si dhe studimin kronologjik në dy pjesë *Krejt Jeta si një film* paraqitur në këtë revistë prej Jozefit me rastin e 100-vjetorit të lindjes së të atit *29 janar 1916 - 29 janar 2016*, ku u njoha me bëmat kryesore të Lazër Radit, shoqëruar me shumë fotografi e kopertina ilustruese.

Sot, më vjen keq që e njoha jetën e veprën e këtij prizrenesi madhështor mbas vdekjes. Lufta e tij këmbëngulëse për t'u shkollu-

Lazër Radi u burgos qysh në nëntor të vitit 1944 me akuzën "Armik i popullit". Ai ka një jetë të pasur dhe një trashëgimi të madhe, që autori na e përcjell me një portret modest, por që premtan ta sjellë në një formë shumë më interesante në të ardhmen...

NË KRISHTLINDJE ME LAZËR RADIN

(Në vend të portretit për kosovarin e pamposhtshëm Lazër Prend Radi)



ar e për të fituar kulturë e dije, fitorja ndaj përndjekjeve që i bëri diktatura komuniste, pasioni atdhetar e demokrat për të shkruar artikuj e vepra, bashkë me krijimin dhe gëzimin e një familjeje të shëndoshë në kushte çnjerëzore, janë frymëzuese për çdo shqiptar të ndershëm.

Këtë shkrim e hartova mbasi e ndjej për detyrë t'i kërkoj të falur këtë intelektual e demokraci të vërtetë, këtij krijuesi të përndjekur për faktin se nuk iu afrova për ta njohur nga afër në vitet 1992-1995, kur mund të kisha përfitur nga bisedat e drejtpërdrejta me të...

PRIZREN, 24 DHJETOR 1924

Më 24 dhjetor 1924 afër mesnatës, nënë Gonxhja i zgjoi nga gjumi tre djemtë Antonin, Balton e Lazrin dhe vajzën Gjyljana. Pasi u veshën të gjithë me rrobat më të mira dolën jashtë shtëpisë. Me babain përpara u drejtuan drejt Kishës së Madhe në qendër të Prizrenit. Aty do të festohej lindja e Zotit Krisht. Bora kishte mbuluar anë e kënd mbi një metër. Rruga në mes të borës dukej si kanal i thellë, si transhe lufte, këpucët kërcësinin krap-krap, duke shkelur

Diplomimi i tij

Pas diplomimit Doctor Juris, Lazri u propozua punë në Universitetin "La Sapienza" si asistent i profesorit Vidar Casarini - Sforza, në katedrën e Filozofisë e së Drejtës, por ai vendosi të kthehej në atdhe për t'i shërbyer popullit të tij. Në verë të vitit 1942, Lazri u vendos pranë familjes në Durrës. Aty filloi punën si stazhier në studion e avokat Golgothas. Dëshira për të ndihmuar në emancipimin e shoqërisë shqiptare e shtyu të rifilloste bashkëpunimin me shtypin shqiptar të kohës me pseudonimet e hershme dhe me pseudonimet e reja Ushitima e Sharrit dhe Gjergj Komneni. Në dhjetor 1942, nis bashkëpunimin me dr. Gulelm Dedën për botimin e gazetës "Balli i Rinisë", organ i grupit Bashkimi i Rinisë Universitare Fashiste Shqiptare (BRUFISH).

bardhësinë e miellte. Baca Prend mbante përdore më të voglin, Lazrin gati 9-vjeçar, të cilin po e merrte në një ceremoni të tillë për të parën herë...

Kishte disa ditë që ushtarë të shumtë serbë me bajonetat ngjitur përpijetë ecnin andej këtej, sidomos drejt kufirit me Shqipërinë. Shkuan të rrëzonin Qeverinë e Fan Nolit atje, për të nënshtuar pastaj në Kosovë çetën e Azem e Shote Galicës. Këta me luftimet e tyre e kishin kthyer Drenicën në një zonë jashtë kontrollit. Drenica po quhej *Shqipni e Vogël*.

Besimtarët katolikë po ecnin drejt kishës nga shumë drejtime në grupe familjare. Kumbimi i kambanave ndihmonte ecjen e tyre. Brenda në kishë sundonte paqja. Dritat e shandanëve e të qirinjve i jepnin ambientit një shkëlqim që fëmija nuk e kishte parë asnjëherë në atë kishë gjatë ceremonive të meshës të djelave paradite. Këngët për Jezusin e për të shenjtën Mari tingëllonin ëmbël. Të gjithë besimtarët e ndjenin praninë e Zotit Krisht në ajrin e katedralës. Një ngushëllim i madh, një optimizim e siguri ndjehej në zemrën e të gjithëve, sidomos te fëmijët. Sytë e tyre shkëlqenin me



një dritë më të fortë se në orët e mësimt.

Lazri do t'i kujtonte emocionet e asaj nate gjatë gjithë jetës. Ato këngë, ata qirinj e shandanë të ndezur, ato këngë e psalme të ëmbla, ajo fryma hyjnore që zotëronte sallën e mbushën me ndjenja mirësie e dashurie. Kujtimi i emocioneve të asaj nate do ta ndihmonin në të ardhmen të bëhej më i sjellshëm, më i dashur me familjarët, shokët e me këdo që do të njihje. Ndikimi moral e shpirtëror i asaj ceremonie do të ishte ndoshta po aq i madh sa ndikimi i gjithë orëve mësimore që do të merrte gjatë shkollimit të tij dhe leximi i qindra librave që do të thihite gjatë jetës së ardhshme.

Nga shpirti i tij i dëlirë lindi atë natë lutja: *T' falem nders' o Zot, që m' lindë katolik e ma ndriçon rrugën me msimet e Jezu Krishtit!* - lutje, të cilën ai do ta rithoshte më vonë sa herë do të ndodhej në situata të gëzuara ose të vështira.

Në vitin 1929, si shumë familje të tjera shqiptare të Kosovës edhe

familja e Prend Radit u shpërngul e u vendos në Shqipëri, në qytetin e Durrësit. Në fund të tetorit Lazri u regjistrua në shkollë në klasën e tretë. Deri në atë kohë shkollimi i tij ishte kryer në Prizren, në serbisht. Kishte mësuar pak shkrim e lexim shqip në kishën shqiptare. Vitin tjetër shkollor shkoi e vijoi në Tiranë, kurse në vitet 1931-38 ai ndoqi mësimet në Gjimmazin e Shtetit në Shkodër, ku për disa vite jetoi në konviktin "Malet Tona". Aty pati fatin të ishte nxënës i disa mësuesve atdhetarë e intelektualë të përkushtuar si Ernest Koliqi, Eqrem Çabej, Skënder Luarasi, Simon Krota, Paul Guzhoni, Filip Llupi, Kolë Kamsi, etj. intelektualë të përkushtuar; të cilët ndikuan në formimin e tij. Përpigje të ishte ndër nxënësit më të dalluar. Filloi të shkruante në shtypin e kohës me inicialet L.R., ose me pseudonimet Lara, Lapredi, Ladi, etj.

Në vitin 1936, motra e tij Gjyljana, shërbente si mësuese bashkë me Migjenin në shkollën e Pukës. Për shkak të dimitit të ashpër, shkolla e asaj qyteze ishte verore. Gjyljana, e ftoi vëllain në verë të atij viti, të shkoi në Pukë e të njihje me poetin. Pasi shkoi dhe jetoi në ambientet e asaj shkolle gjatë muajve qershor-gusht, ai e njohu nga afër poetin e tij të adhuruar; përjetoi momente të rëndësishme nga procesi i tij krijues. Për këto ai do të shkruante në të ardhmen artikuj të shumtë po edhe librin me kujtime *Një verë me Migjenin*.

Në Shkodër, gjimnazisti Radi në vitet 1934-'37 zuri miqësi me Arshi Pipën, Kolë Ashtën, Pashko Gjeçin, Qemal Draçinin, Gaspër Palin, si dhe me Qemal Stafën, Vasil Llazarin, Xhemal Brojën, Elez Brahen etj. të cilët, nën ndikimin e Zef Malës, filluan të merrnin pjesë në lëvizjimin komunist të atij qyteti. Si njohës i serbishtes, ai u ngarkua me përkthimin në shqip të broshurave propagandistike që vinin nga Partia Komuniste Jugosllave, dega e Malit të Zi. Djaloshi i pëlqente fryma revolucionare, ideja e çlirimit, e vllazërisë dhe e barazisë midis popujve, ruajtja e konspiracionit të grupit, disa aksione për të ndihmuar qytetarët e Shkodrës nga përmbytjet e Kirit, etj. Mirëpo si prizrenas i ra në sy fakti se agjitorët malazezë flisnin me shumë pasion për nevojën e sabotimeve, për vrasjet politike që duhej të kryenin anëtarët e grupit komunist të Shkodrës dhe mbi të gjitha i tingëlluan shumë keq vargjet e këngës serbe *O car Llazar, kurore e artë e Serbisë...* që komunistët malazezë ia këndonin serbisht për t'ia lëvduar punën, kur ai u përkthimete broshurat, ose fjalimet e tyre.

I lindur e i rritur në Kosovë, ai i kishte përjetuar nga afër mizoritet e ushtrisë mbretërore të shtetit Serbo-Kroato-Sillove ndaj popullit shqiptar të atjeshëm. Kënga e këtyre komunistëve për mbretin Llazar dhe shkëlqimi i syve kur flisnin për nevojën e sabotimeve të vrasjeve që duhej të kryenin komunistët shqiptarë, shkëndijuan në mendjen e idenë që nuk thuhej hapur: Komunistët serbë e malaz-

ese mbas propagandës për çlirimin e popujve nga shtypja, mbas internacionalizmit proletar, fshihnin synimet e lashta për ekspansion. Ai pati kurajon dhe ua tha shokëve hapur në mbledhje, se e ndjente veten të huaj në atë grup dhe u largua, pa i bërë keq askujt dhe duke e ruajtur konspiracionin e celulave. Përvoja e tij e fëmijërisë e ndihmoi të shkëputej prej Grupit Komunist të Shkodrës.

NË ROMË TE KATEDRALJA E SHËN PJETRI

Në vitin 1938, mbasi mbaroi gjimnazin, Lazri mundi të fitonte, jo prej shtetit shqiptar e as prej Mbretit, por me përpjekjet e veta, një gjysëmbursë për të ndjekur studimet për Jurisprudencën në Universitetin famoz *La Sapienza* të Romës. Mbas gëzimit të shpërnguljes nga Kosova në Shqipëri, kjo ishte shpërngulja e dytë edhe më e gëzueshme se e para. Vizitat në qytetin madhështor të Romës, ku gati në çdo rrugë ai sodiste monumente të ndryshëm nga Antikiteti, Mesjeta, ose Rilindja, vizitat në kopshtin zoologjik të qytetit, frekuentimi i pallatit të Operas, ku takonte dhe të rinj të tjerë shqiptarë, e mbushnin Lazrin e ri me gëzim, por dhe me një trishtim për Shqipërinë e përgjysmuar e të ndarë në dysh, për Shqipërinë e varfër e të shkatërruar, ku pushuesit osmanë nuk kishin lënë në këmbë asnjë monument të lashtë a mesjetar dhe më e keqja kishin lënë një mendësi turkoshake.

Në Romë, krahas miqësisë të shumta, u afrua e u miqësua me disa vajza të bukura italiane si Lili Bandini, Claudia Carnavali, etj. I shtoi marrëdhëniet me me njërin prej tyre, me zonjushën Lidia Barberini, dhe më 1941, Lazri u bë për të parën herë baba, me djalin Alfredo.

Në gusht të vitit 1941, ndodhi një ngjarje tjetër e gëzueshme: Gjermania, pasi e mposhti shtetin Serbo-Kroato-Sloven e ndau në disa shtete të pavarur, kurse pjesën jugore të Serbisë e ndau midis Bullgarisë dhe Shqipërisë. Shqipërisë iu bashkua një territor prej gati 12.000 km katrorë me popullsi mbi 820.000 banorë. Shumë shqiptarë, ndonëse atdheu ishte i pushtuar prej ushtrisë fashiste italiane, filluan të ndjeheshin optimistë për të ardhmen. Ata arsyetonin se atdheu duke pasur tani edhe pjesën më të madhe të Kosovës, disa pjesë shqiptare të Malit të Zi dhe Strugën, Kërçovën, Tetovën, Gostivarin e Dibrën, mund të realizonte në të ardhmen e afërt çlirimin e tij prej pushtuesit italian. Lufta e Vlorës e 1920-ës, ishte shembull konkret që e frymëzonte këtë ëndërr për mundësinë e lirisë së ardhshme.

Në një situatë të tillë, studenti Lazër Radi, nuk mund të mos ngazëllehej! Ishte realizuar ëndrra e bashkimit kombëtar, të cilën populli shqiptar nuk mund ta realizonte dot vetë. Ishin ndërprerë masakrat e popullsisë shqiptare prej pushtuesve gjakatarë serbë. Ai fluturoi nga gëzimi kur mësoi se ish mësuesi i tij Ernest Koliqi, në funksionin e Ministrit të Arsimit, vendosi të hapte shkolla shqipe në trevat e bashkuara ku pushtuesit serbë nuk kishin lejuar popullin shqiptar të hapte shkolla në gjuhën amtare. Ishte gati të shkonte dhe vetë mësues në Prizrenin e dashur, por shumë shpejt mësoi se qeveria shqiptare kishte dërguar shumë mësues anë e mbanë trojeve të bashkuara, pran-



Lazër Radi, Musine Kokalari etj.

daj vijoi i qetë studimet...

Shqiptarët e rinj që ndodheshin në Romë për të kryer shërbimin ushtarak, ose për studime, e kishin bërë zakon që ditën e Pashkëve të Mëdha, që festoheshin në pranverë, kur celebrime ringjallja e Jezu Krishtit dhe në mbremjen e 24 dhjetorit, kur celebrime lindja e Jezu Krishtit (Krishtlindjet), shkonin në Katedralen madhështore të Shën Pjetrit. Këta shqiptarë nuk kishin përjetuar festa më të bukura se këto në ambientet aq të këndshëm dhe madhështore. Ndonëse shumica e tyre ishin nga familje muslimane e ortodokse, ata shkonin të katedralja më shumë për kuriozitet dhe respekt të qeverisë italiane, e cila po sillte edhe më mirë me shqiptarët pas disfatës që pësoi në luftën Italo-Greke, në tetorinorin e 1940.

Brenda sallës së madhe të katedrales së mbushur plot e të plot, ndihej vetëm kënga e korit. Llampadarët dhe qirinjtë ishin të panumërt. Në fund secili kryente lutjen e tij në heshtje.

Lazri mërmëriste me vete: *"T' falem nderit o Zot për bashkimin e popullit shqiptar. T' lutem o Zot ndihmom ta kryj shkollën sa ma mir e t' shkoj n' Shqipni me ndihmu shqiptart!"*

NË TIRANËN E PASLUTËS, 24 DHJETOR 1944 DHE 24 DHJETOR 1953

Pas diplomimit *Doctor Juris*, Lazrit iu propozua punë në Universitetin *La Sapienza* si asistent i Profesorit Vidar Casarini - Sforza, në Katedrën e Filozofisë e së Drejtës, por ai vendosi të kthehej në atdhe për t'i shërbyer popullit të tij. Në verë të vitit 1942, Lazri u vendos pranë familjes në Durrës. Aty filloi punën si stazhier në studion e Avokat Golgothas. Dëshira për të ndihmuar në emancipimin e shoqërisë shqiptare e shtyu të rifillonte bashkëpunimin me shtypin shqiptar të kohës me pseudonimet e hershëm dhe me pseudonimet e rinj *Ushtima* e *Sharrit* dhe *Gjergj Komneni*. Në dhjetor 1944, nis bashkëpunimin me Dr. Gulelim Dedën për botimin e gazetës *Balli i Rinisë*, organ i grupit *Bashkimi i Rinisë Universitare Fashiste Shqiptare* (BRUF-Sh). Në verën e vitit 1943, pasi kishin kryer divorcin me zonjën italiane, Lazri sollë në Shqipëri djalin 3-vjeçar, Alfredo. Kurse më 21 tetor 1943, u martua me zonjushën Vitorë Vushmaqi, me origjinë nga Vermoshi, e cila jetonte në Tiranë. Ajo ndiqte studimet në shkollën e mesme *Nana Mbretreshë*. Në fillim

të majit 1944, mori titullin avokat, ndërkohë që punonte si drejtor i zyrës së Strehimit në Tiranë. Në këtë kohë bashkëpunoi dhe për rregullimin e disa kodeve e ligjeve kushtetut. Në verë të vitit 1944, familjes së tij iu shtua dhe vajza, Veronika.

Pasi forcat partizane çliruan Tiranën, ende pa u larguar ushtria gjermane, udhëheqja e forcave partizane filloi në kryeqytet një proces arrestimesh të atyre që mendohej se ishin kundërshtarë të Partisë Komuniste Shqiptare edhe pse ata nuk kishin asnjë aktivitet kundër kësaj partie. Midis tyre, më 23 nëntor 1944, Lazër Radi u ftua prej disa partizanëve të armatosur *për një punë në komandë...!*, ashtu si u ftuan dhe Bahri Omari, Xhevat Korça, Kol Tromara, Mahmud Përmeti e 60 intelektualë e nacionalistë të tjerë. Këta, pasi u mbledhën në komandë, nuk u

rremujë nga mosnjohja e rritit katolik. Me një fjalë komanda dëshironte që mesha të mos mbahej, ose të dështonte duke u kthyer në një farsë komike. Mirëpo të burgosurit, pavarësisht nga bindjet e ndryshme fetare, u treguan solidarë. Solidariteti i tyre buroi prej urrejtjes që ndjenin ndaj regjimit të ri komunist që i mboldhi me djallëzi goja *për një punë në komandë* dhe po i mbante për t'i dënuar pa pasur asnjë faj.

Pavarësisht nga qirinjtë e pakët dhe mungesa e korit, serioziteti me të cilin e organizoi ceremoninë Dom Shtjefni, heshtja e të pranishmëve, kënga *Lavdi Zotit ndër qiej!* Paqe në tokë për njerzit me vullnet të mirë, që nisi të këndohej prej disa zërave të paktë e pastaj u forcua me pjesëmarrjen e shumicës, i dhanë ambientit një frymë shenjtërimi. Zemrat e të pranishmëve u mbushën me



lëshuan më. Nga data 1 mars deri 13 prill 1945, për dënimin e tyre u organizua Gjyqi Special, me kryetar Koçi Xoxen dhe prokuror Bedri Spahiun, si dhe disa gjyqtarë ish partizanë, shumica të pashkolluar. Pa fakte konkrete për ndonjë punë armiqësore ose kriminale, disa u dënuan me vdekje, disa me burgim të përjetshëm, disa si Lazri me burgim të rëndë: 30 vjet, kurse të tjerë me 25 vjet burg e disa me më pak...

Për të krijuar idenë se Partia Komuniste respektonte të drejtat e njeriut, më 24 dhjetor 1944, në burgun e ri të Tiranës u dërgua Dom Shtjefën Kurti për të kryer shërbimin e meshës së Krishtlindjeve. Të burgosurit i mbledhën në sallën e ngrënies të gjithë bashkë: katolikë, ortodoksë e myslimanë.

Komanda e burgut dëshironte që burgosurit myslimanët të mos pranaronin, kurse të krishterët othodoksë të kërkonin priftin e tyre, ose të krijohej zhurmë e

sohen. Zoti na ndimofte!

Vite më vonë, më 24 dhjetor 1953, kur Lazri punonte në kampin e të burgosurve për ndërtimin e aeroportit të Rinasit, pati rast të merrte pjesë në meshën që organizoi në fshetësi të burgosuri Padër Pjetër Mëshkalla, në kaponionin e ushqimit. Edhe pse u organizua në fshetësi e me shumë drojtje, populli u mbush gjatë asaj meshe po ashtu me ngushëllim, shenjtërim e shpresë. Lazri e përsëriti lutjen e tij: *T' falem nderit o Zot qi dhe n' burg po je me na t' përvujtnit e na ngushllon. T' lutem o Zot, mbroji njerzit tanë nga tundimet e dreqit! T' lutem o Zot, zbuti zemrat e komunisteve!*

Besimi tek Zoti dhe bashkë me të edhe shpresa për shëmbënjë e atij regjimi nuk vdiqën. Vërtet shumë të burgosur dhanë shpirt gjatë torturave nëpër qelitë e hetuesisë, nëpër burgjet e Burelit, Spaçit, etj; nëpër kampet e punës në Tepele, Maliq, Vloçisht, Turan, etj dhe nëpër fshatra internimi. Mirëpo të përndjekurit e ndërgjegjes nuk u mbaruan kurrë, sepse ishin të ndërgjegjshëm se një ditë diktatura komuniste do të kapitulloste ashtu si diktaturat fashiste e ajo naziste. Madje të përndjekurit e ndërgjegjes, jo që nuk u mbaruan, por u shtuan dhe dolën fitimtarë mbi diktaturën komuniste.

Ashtu si pasardhësit e Gjon Marka Gjonit, Abas Kupit, Mustafa Merlika Kruja, Preng Pervizit, etj edhe familja e Lazër Radit nuk u shua gjatë përndjekjes komuniste. Kur Lazri u lirua prej burgut më 1954, gruan ia kishin burgosur dhe vajza, Veronika, i kishte vdekur, ndërsa djalin Alfredo e kishte marrë për ta rritur vëllai i madh. E internuan në fshatin Kuç, më vonë edhe nëpër kampet të tjera si Gradishtë, Çermë e Savër të Lushnjës. Në 12 mars 1956, ia liruan gruan dhe jetuan së bashku në internim, ku rifilluan jetën familjare plot mungesa, por me një bekim prej Zotit. Vitorja para se të shkonte për t'u bashkuar me Lazrin, bëri një vizitë tek Vendi i Shenjtë i Shën Ndoit në Laç. Manastiri i lashtë ishte shembur e kthyer në gërmadha, por besimi i popullit në mbretkullitë që mund të bënte shenjtëri nuk ishte shuar. Vitorja e ngjiti të përjetën duke ecur gjunjazi e duke u lutur Zotit dhe shenjtë Ndoit (Shën Andonit) që mbas bashkimit me Lazrin t'i falnin një djalë që të mos shuhej familja Radi.

Zoti dhe Shen Ndoi ia dëgjuan lutjen që kjo grua e përvuajtur ua drejtoi me gjithë shpirt. Ia plotësuan kërkesën, ashtu si dëjnë ata me shumë sesa u kërkon besimtari i devotshëm...

Kapitullimi i diktaturës komuniste i gjeti Lazër e Vitorë Radin me familje të përtërirë me dy djem e një vajzë të martuar dhe me fëmijë, pra me familje të bekuar e të shtuar. Familja Radi u kthyer në Tiranë me dy djem të Jozefin dhe Luçianin dhe vajzën Adriana, si dhe me shtatë nipër e mbesa. Të gjithë të pashëm, vulnetmirë dhe të moralshëm. Nënë Vitorja shumë shpejt shkoi te gërmadhat e Shën Ndoit ku dhuroi disa sende dhe bëri lutjen e falenderimit për bekimin që i dha Zoti e Shn Ndoi...

Bekimi i Lazër Radit ishte me dy krahe: nga njëra anë familja si koshere e plotë dhe nga ana tjetër krijimtaria e bollshme letrare e studimore. Ky adhurues dhe pasues i Migjenit shkruan në një gëgnisht të ëmbël, si vetë Migjeni, me fjali

→ Vizion nga faqja 15

të shkruara, me gjuhë të pasur plot figura letrare, gjithmonë i qartë e pa ekuivoqe. Veprat e tij të shkruara gjatë viteve të internimit i plotësoi e i botoi në Tiranë në vitet 1993-1998, kur dhe shkroi shumë artikuj e vepra të reja.

Nga ana zyrtare, si për shumicën e krijuesve që bëjnë pjesë në radhët e të përndjekurve të ndërgjegjës, nuk është treguar asnjë interes dhe vlerësim i rëndësishëm. Por disa intelektualë, miq të tij dhe familjarët e tij, në tetor 1996 mbajtën një simpozium shkencor në Muzeu Historik Kombëtar, ku u vunë në dukje vlerat e tij intelektuale, shkencore e morale të njeriut që nuk u mposht prej diktaturës komuniste. Për të si shkrimtar kanë dhënë vlerësime dhe njerëz të shquar e të talentuar si poeti Visar Zhiti, etj. Studiuesi Robert Elsie në veprën dinjitoze *Histori e Letërsisë Shqiptare* DUK-AGJINI 1997, f. 414-415 është i pari që ka dhënë vlerësime për jetën dhe veprën e tij.

Qeveritë shqiptare të tranzicionit nuk i krijuan kushte jetese as Lazër Radit e as pasardhësve të tij, prandaj ata i gjen sot të shpërndarë nëpër botë, sepse Ramiz Alia me klanin e tij punuan që Shqipërinë dhe pasuritë e saj t'i trashëgojnë të bijtë dhe pasardhësit e kupolës komuniste, sipas planit *Katovica* të formuluar para se të shpallej kapitullimi i diktaturës komuniste.

Sot djali i madh Alfredi (nga martesat e parë) dhe dy djemtë e tjerë, Jozefi e Luçiani, jetojnë në Itali me gjithë familjet e tyre, kurse vajza Adriana jeton në SHBA me bashkëshortin dhe vajzat.

Jozefi i ngjan babait për nga talenti e përkushtimi atdhetar; politik e shoqëror. Ai ka pesë vjet që publikon në Itali revistën internetike *Radiandradi*. Aty ai boton përveç shkrimeve të bashkëpunëtorëve dhe krijime të babait e të vetat. Jeta dhe krijimtaria e Jozefit meritojnë një shkrim analitik, të cilin mund ta bëjmë më vonë.

Sivjet ai arriti t'i grumbullojë gjithë shkrimet e babait në një korpus me 17 vëllime, prej të cilëve këto janë ato të botuara që vëllime *Mjegullnaja e një kohe të largët - I Prizreni dhe Ministri i hekurit - Mirash Ivanaj*. Këto dy vëllime të Lazër Radit u paraqitën në panairin e librit në Prizren, ku intelektualët e atij qyteti e pritën me dashuri e vlerësime të ngrohta rikthimin e bashkëqytetarit të tyre.

Nga ana e saj vajza Adriana i ngjan nënës për nga përkushtimi familjar e fetar. Ashtu si Alfredi, Luçiani dhe Jozefi edhe Adriana kanë ndihmuar dhe ndihmojnë financiarisht për përgatitjen dhe botimin e korpusit të veprave të babait të tyre të talentuar.

Jeta dhe vepra e Lazër Radit do të studiohet e vlerësohet si meriton pasi të realizohen Vetting-u dhe Reforma në Drejtësi, kur shoqëria jonë të ketë shpërruar nga pushteti pushtetarët pseudodemokratë e pseudosocialistë. Në jetën e veprën e tij shqiptarët do të gjejnë burrin e qëndrues, të përkushtuarin e madh ndaj çështjes kombëtare dhe shoqërore, atdhetarin, që ia kushtoi gjithë energjitë dhe njohuritë e veta, luftës për emancipimin e popullit shqiptar pa u stepur nga pengesat dhe vuajtjet çnjerëzore të panumërta...

P

POEZIA

Një elegji e bukur kushtuar kujtimit të të internuarve, mbajtur me një regjistër shumë të saktë të autorit, ku kujtimet ndërthehen me njëra-tjetrën duke na sjellë një kujtim realisht të trishtë...

Etyd

Një dritare drejt qiellit për banorët, e Porto Palermos, të burgosurit që nga ky tunel dëgjonin dallgët dhe nuk i shikonin dot ato... Veç kjo dritë i çonte drejt lirisë, ëndërrës, shpresës... Një portë si ajo që vite më parë kam shikuar në ishullin e Gore-së, përballë Dakarit, ku ndryshe nga banorët e Porto Palermos, ata zbrisnin të prangosur drejt detit, ku anijet i merrnin dhe i çonin në kontinentin e ri përtej Atlantikut. Porta për shpirtat e popullit të Dantes që e donin aq shumë lirinë.

Miku im Lek Pervizi u rikthye këtu në mesin e viteve '90. Vinte nga Brukseli për të rigjetur gjurmët e një kohe të pashlyer në këtë vend ku bashkë me gruan krijoi familjen e tij... Emra njerëzish, data, përkujtime, heshtje, fjalë të ngjizura në mure që nuk mundëm ti dëgjonim, dëshirë mërgimi për tu bërë zogj dhe fluturuar, verbuar nga dielli dhe ikur pa e kthyer kokën pas si në legjendat antike, dëshmi të një dore që s'do të jetonte më, një dëshirë e zhgarravitur dhe e pakuftuar... ç'donte të thoshte ai i dënuar anonim për botën sot... dhe shpërtra të padukshëm jetonin ende në galeritë e ftohta të kështjellës veneciane të pashait të Janinës... Mora një gur... Dhe gurët dinë të flasin! Nuk i dëgjoni?... Kështu shkruante dikur Janis Ricos pas telave me gjemba në ishullin e të burgosurve politikë Makronisos... heshtje, erë, deti që hesht dhe që të flet njëkohësisht... Dhe unë kam dëshirë tani ti puth ato mure dhe të ndiej aromën e atyre shpërtrave që ndoshta nuk jetojnë më...



Porto Palermo, ku era flet me gjuhën e mallit dhe të gurit

NGA LUAN RAMA

I.
Eshltë pragu,
jo ai i qurtë,
eshltë pragu i natës para se porta të mbyllet,
pragu i gojës së thare dhe të lodhur nga britma
para se atë copë qielli ta zhdukin nga sytë lanë,
ushtrari kalon dhe numuron të internuarit
një, dy, tre,
"Po Andrea ku eshtë!", - pyet ai dhe kllith i shqetësuar
një nga pleqit i bën shenjë poshtë këmbëve,
i mjeri Andrea ka gjithë ditën që dergjet atje
me shpirtin në cepat e buzëve,
pa u fikur ende,
pa mundur të ngrihet,
pa flamur,
me një krodhe në duar,
rreshkur, vrarë, tretur, sa një grusht,
pastaj ushtari vazhdon numërimin e tij duke u
ngalëruar
njëzet, njëzet e shtatë, njëzet e tetë
kërkon dikë tjetër,
por një burrë me mustaqe i bën shenjë
nga skuta e errët e banjos kolektive
dikë rënkton atje, dikë frymon ende,
minutat vazhdojnë pa ditur se ç'orë eshtë,
ç'ditë, ç'muaj,
ushtrari mbyll hundët, shfryn si një kalë plak dhe
pret
gjersa njeriu të dalë duke ngritur pantallonat
e ecur zvarrë bashke me hijen e tij
nënledhjetë e nëntë, njëqind, njëqind e një,
ushtrari i pashkollë kruan prapancin e shan
nëpër dhembë
II.
I merrtur nga ai numërim i kotë,
pasi njerëzit s'mund të fluturojnë,
të bëhen zogj e të jkin në terrin e natës
ç'mund të bëjë kjo shqiponjë gërvishur në mur?
Numërat mjaftojnë, ç'rëndesi kush,
njerëzit s'mund ti kapërcëjnë portat e ferrit,
veç në qofshin ëngjëj,
dhe ai nxiton të mbarojë shpejt,
e pastaj të ngjitet lart
të marrë frymë thellë,
të shohë delin dhe pulëbardhat
e të harrojë skeleren që ka lënë poshtë,
duke menduar me Imërr se një ditë mund të
ndodhet dhe ai aty.
Dhe atëherë shkon menjëherë në kthinën e tij
rrahur nga era

dhe përplasat në shtratin e hekurit duke thënë me
vele:
deri kur kështu?
Shitza e flamurit hënë e ka ndarë më dësh
dhe "kallashnikov" i varur aty
ia pengon flakërimen e diellit që zhytet tutje në
det,
"Ne s'jemi më në luftë", pëshpërit ai...
III.
Ora 13.00, eshtë koha e supës për të shuar
urinë,
se pari atë të femijëve, pastaj të pleqve, e grave,
dhe në fund urinë tone,
urinë që na kaplon nga mëngjesi në mbrëmje
që na zgjon në mesnatë
me një therrje në fund të barkut.
Eshltë kllithma e urisë,
brilma e të gjilheve,
ketu femijët endërojnë kuzanë supe
që derdhen parështrur mbi pjatat tona alumini,
aq sa rrjedh ngado,
nga porta lart që hapet,
ketu plasatijet e guavave,
dhe nga vetë ajo copez qiell
që nderet si dëshmitare e jetës që vazhdon,
dhe supa u duket se bile në forme shlu
supë, supë, supë,
kjo eshtë kënga e supës me një grusht fasulesh
në të,
vetëm endërra i mbush barqet e tyre,
dhe buka e Dedës qatuar me ujë deti,
dhe në orët e vona ata nisin të flasin përçart,
të ngatërojnë ditët me netet,
pasi kanë mbetur të pangopur të përjetshëm.
IV.
- Ç'eshtë ajo atje? - pyet Bibi.
- Qielli! - i thotë e ëma me trishtin që i nderet mbi
qepalla.
- Po qielli nuk eshtë aq i vogël! - këmbëngul
Bibi.
- Eh, Bibi, edhe qiellin e kanë zvogeluar tash-
me!
- E kanë prerë me gërshere?
- Po, e kanë prerë, e kanë bërë sa një shami.
Bibi hesht dhe sheh nga gardiani. S'di ç'te thotë,
dhe në ëndërr shikon një copë qiell
sikur ta ketë kthyer atë në një balonë të kaltër
me shirita të bardha resh,
dhe me të rend ashtu zbatuar i gëzuar
duke shkëlur si Simbadi me këmbët në qiell,
duke shkëlur pastaj mbi det,

e pastaj kapet të lozë nga bishti i balonës-qiell.
- Ej, Bibi, u çmendte? Ç'bën keshu? - i thotë xha
Naqo,
por Bibi në mëndjen e tij vrapon në lëndinën
para shtëpisë
dhe balona lashmë eshtë bërë e madhe,
e madhe sa një qiell i pambarrimlë,
por ah, tek loz me erën, balona i kënaq nga duart,
qielli zvogëlohet dhe bëhet aq sa ç'eshtë më parë
një shami sa për të lidhur kokën e nenes që
pikëllon trisht,
shami për të fshehur lotët,
Bibi qan...
- Ah, Bibi!
Por Bibi habitet se gjithçka eshtë zhdukur tash-
më
dhe ai ka mbetur në errësirë, bashkë me nënën
e tij:
- Shiko tani të flesh Bibi, se porta u mbyll...
- Nesër do ta shohesh sërrih balonen tendë, -
shiton hidhur xha Naqo.
V.
Rako palosi letërrin dhe e futi sërrih në xhepin e
tij.
Një lot i nxehtë i dogji duart,
djali i Rakos ishte vrarë në kufi.
- Të rrosh vetë Rako!
- Të rroji kujtimi i djallit!
- Mos ki dert! Rako se ne do të jemi djemtë e tu!
- Merre Rako, ndize një!
Me duart që i dridhen Rako nis të dredhë duha-
nin
me një copë të vjetër gazete,
kur e ndezi pa se në majë po digjet njëri sy i
diktatorit,
fotografia digjet bashkë me gishtin e Rakos
dhe ai e thithi akoma më fort
që të zhdukej dhe syri tjetër i fotografisë.
I mbushi mushkëritë xha Rako:
"S'më vret dot ti mua!" - i foli cigares
dhe hiri i ra nga gishtierinjtë,
si një borë e zezë morti
duke parë i kënaqur gjersa gazeta u dogj e tëra.
Pastaj u ngrit dhe doiti para shkalleve duke
mbushur gjoksin,
ngriti sytë lart dhe vështroi atë diell
që tani po e ngrohte më shumë se kurrë...
VI.
Roza thumë:
po të kishë lapsa me ngjyra çdo të vizatoje?
- Diejt! Diejt! Diejt! Diejt!

- Pse?
- Sepse më shfaqen natën në gjumë.
Endëroj gjithnjë sikur jam në shtëpinë e diellit.
- Pse, nuk të pëlqen këtu me nënën tendë?
- Hem... po unë nuk e dua errësirën
dhe gjithë këto hije të frikshme që shfaqen nga-
do,
dielli më ngroh,
do të vizatoja diej për secilin nga ju...
- Po ne jemi shumë!
- S'ka gjë, do vizatoj nga mëngjesi në mbrëmje,
që ju mos të kenë më flohtë.
Gjyshja që në vendi më tregonte një përrallë:
"Vajzen që i ishte premtuar diellit",
dhe unë dua të jem ajo vajza,
pres të më rriten flokët,
t'i bëj gërsheta të gjata, të arta,
të kapem në to dhe të ngjitem drejt diellit
atëherë do ti them diellit të vijë deri tek ju
e tu ngrohë sa më shumë
e tu marrë dhe juve në shtëpinë e tij.
VII.
Një flutur e madhe krahe-verdhë
hyri s'ndihet si, pa lejen e askujt,
pa leje kaimli,
kapur në grackë nga vapa,
pa ditur se kishte renë në botën tjetër.
Vinte rrotull gur me gur
gjersa ndalo në supin e Kamberit që dergjet në
jerm.
- Perëndia të sollti tek ne! - tha i gëzuar ai
dhe i harroi plagët e tij,
- Kushedi ç'habere ke sjellë!
- Oh, ç'krahe të bukura, të artat! - pëshpëriti Roza
e vogël, -
po ne, pse s'kemi krahe si fluturat?...
VIII.
- Kam mall e dashur!
- Dhe unë shpirti im!
- Prit sa të fiket feneri i fundit...
pastaj ai zgjati duart dhe e afroi në gjoksin e tij
nën atë balonjë të piset,
në erë myku dhe këllire.
- Oh sa mall, - pëshpëriti ajo.
- Përse digjesh kështu?
- Mermë i dashur në lëndinat e tua,
puthmi gjinjtë që po rreshken,
s'do doja të lindja në këtë guvë të ndyrë,
në këtë errësirë pa yje,
do doja një shtrat plot yje, qëndisur si në Kash-
ten e Kumrit,

...NGA NUMRI I SHKUAR

"Milosao" e këtij numri ishte frikshëmrisht patetike, madje edhe pak e tepruar. Redaktori botoi pikërisht ato gjëra që nuk i ka kënaqësi pasi zakonisht bëhen burim patetik të shprehjes së autorëve tanë për shtjellime të habitshme. Gjithsesi, autori Aristotel Mici duhet përgëzuar për punën e tij, paçka titullit patetik për Akilin dhe Dodonën dhe nënkuptimin që ne çdo gjë e lidhim me trashëgiminë tonë. "Herodoti na përshkruan mjaftë hollësisë rreth Orakullit të Dodonës dhe banorëve për rreth saj. Historiani më i vjetër i botës aty na njih edhe me pellazgët, duke i konsideruar ata jo vetëm si më të hershëm se helenët, po edhe që kanë ndih-

muar në formimin e tyre kulturor dhe shpirtëror, krahas ndikimit egjiptian. Me fjalët e tij Herodoti do të përforcojë idenë se jo të gjitha zakonet Helenët i kanë marrë prej egjiptianëve". Paradoksi është se në historiografinë tonë ka shumë personazhe që e quajnë të mbyllur vijmësinë e trashëgimisë sonë dhe lidhen e gjejnë 100% me pellazgët!!!

Redaktori vazhdon luftën e tij të heshtur me një shkrim tjetër për teatrin duke e lidhur me pjesën historike monumentale të asaj pjesë të qytetit. "Megjithatë, ja ku jemi sot dhe zona e trashëgimisë kulturore në kryeqytet, ku gjendet dhe teatri po modifikohet sërisht. Nuk po flasim më për Kalanë dhe ndërtime të shumta pa leje të kryer në të, që për ironi na kryen vetëm pak dhjetëra metra nga

Bashkia, po flasim për faktin se ndryshimi i herë pas hershëm i rregullave ka prishur sensin e Tiranës së Vjetër. ... Mu, në këtë vend, dikur mendohej se ishte një stacion i Via Egnatia. Me shumë gjasa ai do të modifikohet, duke i humbur Tiranës dhe një nga shenjat më të hershme të ekzistencës së saj", shkroi redaktori që shtoi edhe një apel që njerëzit të kujtohen se për kë votojnë, për ata që japin verdiktet shpesh në kurrizet tona...

Në këtë numër patëm një shtjellim të Fjalorit Shqip-Polonisht të prof. dr. inxh. Arqile Teta me 30 mijë zëra dhe me rreth 50 mijë shembuj ilustrues, shprehje frazeologjike dhe fjalë të urta. Ky fjalor së bashku me Fjalorin Polonisht-Shqip të po këtij autori të botuar më 2007 janë të parët

fjalorë të këtyre përmasave jo vetëm në Shqipëri dhe Kosovë por dhe në Poloni... Redaktori e vlerëson inxhinierin, që ia kushtuar jetën promovimit të Polonisë në vendin tonë.

Rexhep Ferri u kthye pas shumë kohësh me një ese të tij, që përcjell në një formë metaforike llojin e patriotizmit tonë kombëtar... Kurse poeti Vahid Hyzoti na erdhi me një cikël, ku shquhej romantizmi i kohës sonë i përcjellë në një mënyrë pak të thjeshtë...

Një vend i veçantë në këtë numër iu la Barbara Korun, poete dhe kritike letrare e ndëruar në Slloveni dhe në Evropën Qendrore, njëkohësisht një nga figurat kryesore të gjeneratës së poetëve të rinj radikalë në Slloveni. Ajo u përkthye në shqip nga anglishtja, ndërsa poezitë e saj janë

edhe në gjuhët angleze, kroate, boshnjake, çeke, italiane etj. Kontributi i saj është i jashtëzakonshëm në vendin e saj dhe kohët e fundit ajo ka punuar si këshilltare e gjuhës pranë Teatrit Kombëtar slloven, ku jep ndihmesë në përdorimin e gjuhës sllovene për veprat skenike si dhe përkthen artikujt për botimet e teatrit.

Redaktori ktheu shkrimin kushtuar fjalorit polak sepse disa karaktere leksike dhe shenja nuk kishin dalë si duhet. Layout e kishite mënjaur këtë fakt dhe pasojat ishin katastrofike. Për fat u kapën në kohën e duhur dhe u bënë korrigjimet. Numri i fundit e theksojmë se ishte pak si shumë patetik.



me një dielli të madh, me një qiell blu e të perskuqur, gjaku im të kerkon, barku im do perkuqdeset për pjellen tonë, që ajo li mbijetojë rresbeshit, në rufe dhe në dhimbje, pushlome burri im në ketë eklips të pafund, vetëm kështu li më bën të lumtur, li harroj të njëqind plagët dhe thikaj që më janë ngulur në shpirt, të harroj vrasjen e atit tim, varret, dua të ndjehem grua, dua që një ditë të bëhem nënë... sonte mos më lësho nga krahët, i ëmbli im!

VIII. Ah, kjo këstjella e bukur ngitur nga pashai për Vasilliqinë, bedenë në erë dhe gjunjë që lagen në det, ku ta dinë e mjera grua me sytë e zinj dhe gjinjtë e kolmë që ala gurë këshjelle një dile do të ktheshin në rrasa varri, ku vdekja bën ritim e saj pa lulje, çdo ore, çdo ditë, çdo muaj, ku era shënon epitafë për ata që donin lirinë dhe dashurinë, gurë, bedena dhe hije poshtë në guvat e Polifemit,

dhe dielli që ndalet në hyrje si i prangosur për të mos hyrë në kthinat e peshpërimes, ku Koroni pret të marrë në dorëzim të vdekurin e radhës, mekatarin pa emër, për ta cuar poshtë Jonit të trishtet, përtej ëndrrës, por jo harmitit, era këtu flet me gjuhën e mallit dhe të gurit...

IX. Koha këtu hesht si një kambanat e shurdhuar, Ç'rëndësi ka bota?... Po, të gjitha kambanat janë shurdhuar nga nata e gjatë e plumbit, Bibi i vogël ka gjetur një kërmill dhe ndjek me kureshje udhën e tij, "Sikur të isha dhe unë një kërmill, - mendon Bibi, do mund t'ngjija shkallet e gurit dhe më së fundi ti shikoja jashtë pulebardhat, dhe dalliget me shkumë". Çuditërisht, me sy të çakërritur, të gjithë shikonin një fjonjë të bardhë që ngrihej në ajër thithur lart nga ajri, jeta a kushedi ç'Hyjni, një vajzë e re e sheh e ngazellyer fjonjon e saj dhe pëshpërit, "Të paktën ajo le të shkojë, ... të paktën..."

A
ARGUMENT

NGA BEN ANDONI

Fjala më e dëgjueshme, e prekshme dhe e shkruar në mua jet e fundit është Vetting. Nëse pak vite më parë ajo njihet vetëm nga pak njerëzit e drejtësisë, që e përditësonin veten me termat, çështjet dhe nocionet moderne, tashmë atë e di gjithkush në Shqipëri. Në rrjetën e saj tashmë kanë rënë njerëzit kryesorë të Drejtësisë shqiptare dhe përveç dy krerëve të lartë të Gjykatave të vendit, anëtarët më të vegjël të këtyre trupave po bien një e nga një. Por, në sitë është vetëm pasuria, kurse në konceptimin e reformës është lënë pas mënyra sesi është vënë kjo pasuri, që do të thotë çështjet e dyshimita për të cilat verdikti ka ndihmuar një palë kundër tjetrës. Dhe, Shqipëria është e mbatshur me padrejtësi, të cilat vihen re që nga prona dhe vijojnë në çështjet administrative, civile dhe penale.

Në të gjithë këtë tollovi, njerëzit e kulturës, përveç pak rasteve të veçanta janë këndellur duke qëndruar në dukje larg politikës por duke i shërbyer paq asaj. Ky është fakti, që sapo vjen një forcë politike mbijnë grupi i artistëve që janë pranë një pale dhe fashitet grupi që deri atëherë ka pasur përfitime. Këtë e shikon edhe nga botuesit dhe me radhë, njerëzit e filmit dhe teatrit dhe cilido tjetër, që e gjen duke u përfqafuar me aksh forcë politike apo me një tjetër. Me gjasë, pas këtij mandati të Ramës (nëse nuk do të jetë në mandatin e tretë të frikshëm si kryeministër), me shumë mundësi do na mbijë grupi i njerëzve, që do vendosin për tarafet, çmimet dhe projektet e reja. Kuptohet me frazën: Mjaft këta, tash duhet të vendosim rregull për njerëzit tanë.

Paradoksi më i madh ndodh me njerëzit, që kanë mbi kurriz përvojën e të bërit art në komunizëm dhe tashmë e mohojnë krijësisht të gjithë veprimtarinë e tyre, që jo pak herë kaq qenë cilësore, brenda atyre kanoneve ideologjike.

Nëse veting do zbriste në art, atëherë do të shikonim një masë llumi, që nuk bie më poshtë sesa në fushat e tjera të shoqërisë shqiptare... dhe kjo do na zhyste në një trishtim edhe më të madh e të paparashkuar për kinse heronjtë tanë...

Veting moral për kulturën...

Flitet për një gamë të madhe artistësh krijues, që pothuaj tashmë i kanë mohuar veprat e tyre, por edhe mënyrën sesi janë krijuar, e ku të gjithë përdorin arsyetimin tashmë banal: *Ishte koha apo na detyronin*. Askush nuk i gjykon dot, paçka se moralisht gjykimin e parë ua kanë dhënë vetë kolegët e tyre me heshtjen apo mos duartrokkitjen...dhe publiku me reagimin e vet spontan. Por, për një pjesë të artistëve të pas vitit '90, sistemi i ashtuquajtur i ri, në kuadër të metamorfozës së tyre dhe mohimit të punës së shkruar, konjunkturat sollën një minierë të vërtetë për të përfutur projekte pafund dhe për të prodhuar vlera gjysmake. Objekti: një Shqipëri që në artin tonë por edhe në atë që eksportohet paraqitet apatike, kriminele dhe gjithnjë me groteskun, që të duket sikur është një vend i humbur i Ish-Republikave Sovjetike.

Pa përfolur një grup realist përthithës ndaj asaj që *kërkon* koha, pjesa më e madhe e artistëve e shtyn duke shfryrë dhe duke u ndërsyer me njëri-tjetrin dhe në përçarje të frikshme, që ti e sheh nga ofendimet dhe nga malli i akuzave që ndahen mesvetei. Për fat të keq, nëse e shikon me kujdes, konstaton se shumë syresh janë pasuruar tejet logjikave normale dhe kuptohet kundrejt parimeve në kurriz të përpjekjeve që ka bërë komuniteti i thjeshtë i artistëve për të mbijetuar.

Dhe, ndodh, që ndërsa një pjesë e vogël e artistëve mbijetonin dhe luteshin për role, ka shumë syresh që janë kudo, nëpër aktivitetet pafund, pa lënë goftë edhe asgjë për të tjerët dhe në benefite të shumta. Kjo i bëri aktorët që të përcaheshin keq dhe t'i kujtonin njëri-tjetrit gjëra që për të tjerët ishin

realisht të dhimbshme, për personazhet e tyre të dashur të ekranit.

Por kjo ndodh me botuesit që qahen të gjithë kohën dhe që mirëgenia e pajustificuar nuk i justifikon në ankesat dhe s'ua pret dot grykësinë mbi çdo gjë.

A do mundet ndonjëherë Vetting të zbrisë në kulturë dhe art? Me shumë gjasa jo, sepse Vetting-un në art e bën publiku dhe mbi të gjitha kohëzgjatja e veprës, për të mos thënë një masë publiku që paçka se vuan mungesën e edukimit, di të ndajë të vërtetën dhe të bukurën. Di të vlerësojë artistin që sakrifikon për artin e vërtetë dhe dhuron kulturë, duke e emancipuar veten dhe shoqërinë ku jeton.

Një Vetting moral duhet bërë por kjo i mbetet kohës dhe sidomos përsosjes së legjislacionit shqiptar në kulturë, që ende lë shumë për të dëshiruar bashkë me hallkat e të Drejtës së Autorit, cilësisë, etj., por mbi të gjitha moralit dhe dashamirësisë për artin e vërtetë në kurriz të atij mediokër. Shqipëria e të ardhmes nuk do të mund të zhvillohet nëse nuk do mund të ketë një art që të justifikojë vlerësimet e publikut dhe të tejkalojë, por edhe të bëhet nga artistë që kanë një staturë morale dhe mbi të gjithë profesionale. Kjo, në kohën e kaosit publik, nuk është e vërtetë sepse shoqëria jonë është e ngërthyer në padrejtësitë që zbulon nga dita në ditë Vetting-un, dhe që do të dëshironim të zbriste njëherë të njerëzit e artit...Por nëse Vetting do zbriste në art, atëherë do të shikonim një masë llumi, që nuk bie më poshtë sesa në fushat e tjera të shoqërisë shqiptare...dhe kjo do na zhyste në një trishtim edhe më të madh e të paparashkuar.

R

REVIEW

Në këtë roman magjepës, lexuesi i Kadaresë e ndien peshën reale të një realiteti tejet dramatik, të vendosur në një perandori të mynxyrshme, në të cilën shqiptarët pësuan keq. Autori e vë lexuesin përpara makthit të verbimit, në një rrëfim mbresëlënëse, të mbushur me pikëllim, dhimbje, tension, tronditje, dashuri. Kjo prozë është e shkruar me stil rrëmbyes, ndërkaq lexuesi, duke parë si zhvillohet kjo dramë letrare, e ndien fuqinë dhe peshën e frikës së errësirës, skëterrës, që vjen nga verbimi, por më shumë e ndien frikën që përhapin regjimet totalitare...

Pushteti i frikës, tirania dhe dashuria në romanin "Qorrfermani" të Kadaresë

NGA NDUE UKAJ

Të lexosh një veprë letrare, është akt i kënaqësisë që të jep arti, bota e re që ti e zbulon, ndërkaq, të marrësh përsipër të shkruash për të, është përgjegjësi ndërlikuar dhe kjo lidhet, me raportin që krijon teksti me autorin, veprën dhe lexuesin. Pa dyshim, të shkruash për një autor të madh-për një univers letrar, siç është Ismail Kadare, është përgjegjësi e dyfishtë. E para e punës, shkëlqimi artistik i veprës së tij, ka tejkaluar qëmoti kufijtë e mundshëm dhe komunikon universalisht, me statusin e artit të përjetshëm. Në këtë mënyrë, vepra e tij është përtej mundësive që afrojnë mendimi për letërsinë, qoftë edhe ai më i përparuar.

Duke u nisur nga kjo sfidë dhe përgjegjësi, studiues të ndryshëm të letërsisë janë rrekuar të trajtojnë përgjegjësitë që kanë, në këtë rast, lexuesit, përballë një veprë letrare, sidomos ata që shkruajnë për të. Njohësit e letërsisë, flasin për validitetin e interpretimit dhe mundësitë e leximeve më të mira, (E. D. Hirsch, JR), si dhe për kërkesat etike që shtrihen përpara lexuesit (Derek Attridge).

Për shembull, studiuesi i letërsisë, Derek Attridge, pyet për përgjegjësitë që ka lexuesi karshi veprës letrare, për faktin e thjeshtë, se, asnjë veprë nuk mund të kuptohet pa marrëdhënien e ndërlikueshme që ajo e krijon me lexuesin, sidomos me ata që i përkasin fushës së letërsisë; të tillët që, me tekstet e tyre për shkrimtarë a vepra të caktuar, marrin qëndrime publike; pra i riartikulojnë "mesazhet" e autorit dhe të veprës.

Mirëpo, mendimi për lehtësinë, gjer me sot, nuk ka arritur të tregojë se, cili është leximi më i miri i letërsisë apo i një veprë letrare. Në hollinë e shumë shkollave, metodave, qasjeve, lexuesi, ka ndodhur të bie "prehë" e yshtjeve të kritikëve, për të parë dhe gjykuar një veprë nga një këndvështrim specifik, i ngushtë, që, realisht, mund të jetë përtej qëllimeve të autorit, dhe, ndonjëherë përtej asaj çfarë është jepë për letrare si e tillë.

Sa herë flitet për këto raporte, mua më pëlqen ta citoj, Oscar Wilde-in, i cili shkruante: "Për në që merremi me art, nuk mund të pranohet asnjë teori për të bukurën, në këmbim me vetë të bukurën." Duke u nisur nga ky parim, atëherë, një lexim semantik dhe artistik i një veprë letrare, për mua ngjason me një shtegtim, thënë ndryshe, me një udhëtim, në një botë të panjohur, në një botë, ku ndeshim katedrale madhështore, ura dhe humnera, fusha, male dhe lumenj, njerëz të bukur dhe të shëm-tur, njerëz të bukur dhe të shëm-tur, që bien në dashuri dhe ndahen, sisteme politike të çmendura, që tkurrin njeriun në hofën e frikës, ndeshim dashuri dhe urrejtje të çmendura, ndërtesa të puntaura me shije dhe njerëz që jetojnë në to, me halle e tendosje shpirti, por që dinë



edhe të cakërojnë gotat e lumturisë të mbushura me verë, dhe të kënaqen me bukuritë e pafundme që afrojnë jeta, pra, e gjejmë një jetë në totalitetin e saj të mundshëm. Pikërisht pse një veprë është një totalitet, është e pamundur t'ia paraqitsh lexuesit gjithë këtë përmasë.

Arti i madh i Kadaresë, para lexuesit shfaqet si hapësirë e pafund semantike, gjuhësore dhe kohore, ku përplasen dhe dyzohen, e keqja dhe mira, dhe kuautori, përmes gjuhës alegorike dhe simbolike, thërrret të hiqet qafe e shëmtuara dhe të jetohej e bukura. Këtë thirrje letrare, e hasim në mënyrë të shkëlqyer, të romani, "Qorrfermani", i cili, "ndonëse u shkrua në vitin 1984, për shkak të subjektivitetit tepër delikatë dhe të analogjisë së ngjarjes që ndodh në Perandorinë Osmane, me një fushatë spastrimesh tipike staliniste, aq shumë të njohura në të gjitha vendet ish-komuniste, vepra nuk ishte e mundur të botohej në Shqipëri, dhe botohet në vetëm pas autorit kishte kërkuar strehim politik në Francë." Kjo e dhënë jashtë letrare, por, para se gjithash tematika dhe shtjellimi i ngjarjes, e përforcojnë mendimin se, letërsia e Kadaresë, në esencë është një jehonë e fuqishme antitotalitare, një kamp liric kundër totalitarizmit dhe të gjitha formave të egra të manifestimit të tij.

Në këtë roman magjepës, lexuesi i Kadaresë, e ndien peshën reale të një realiteti tejet dramatik, të vendosur në një perandori të mynxyrshme, në të cilën shqiptarët pësuan keq. Autori i vë lexuesin përpara makthit të verbimit, pra, të çsyzimit, në një rrëfim mbresëlënëse, të mbushur me pikëllim, dhimbje, tension, tronditje, dashuri. Kjo prozë është e shkruar me stil rrëmbyes, ndërkaq, lexuesi, duke parë si zhvillohet kjo dramë letrare, e ndien fuqinë dhe peshën e frikës së errësirës, skëterrës, që vjen nga verbimi, por, më shumë e ndien frikën që përhapin regjimet totalitare. Në një atmosferë të pashpresë, autori e tërheq lexuesin nga e bukura, ngaqë, duke folur për terrin, pra, për çsyzimin e

njerëzve të dyshuar si sykëqij, në të vërtetë, ai flet për sytë, për dritën, për atë kandillin që rri ndezur përherë dhe i thërrret njerëzit kah liria, andejkrah e shpienë të vërtetë lexuesin kjo prozë e sofistikuar.

Kadare, në këtë roman, edhe njëherë na vë përballë pvetjeve esenciale: çfarë është vërtetë bota në të cilën jetojmë, dhe, cilat janë raportet e pushtetit me njerëzit e një vendi apo me njerëzimin në përgjithësi?

Këto dilema, janë shtruar nëpër kohë të ndryshme, nga shkrimtarë, filozofë dhe njerëz të shquar të historisë, dhe janë tema të përhershme të letërsisë, e të cilat, të vepra letrare e Kadaresë, zënë vend të veçantë, dhe shfaqen në variante të ndryshme kuptimore: si kujtesë njerëzore, prej të cilës ai vjel përherë gjëra të bukura, që shëmbëlajnë me realitetin e vendit të tij, dhe gëreshetohen me kontekstin kohor në të cilin u shkrua vepra e tij. Në të vërtetë, arratisja e autorit në historitë, mite, me një fjalë, në të kaluarën e largët, të cilat, atë i mundëson ta formësojë dhe ta tipologjizojë botën autentike letrare, të mbështjellë me një pushtet të përtej-mundësive: pushtet i cili ishte përtej mundësive mizore të tiranit dhe ai nuk kishte forcë t'ia mposhte dhe ta mbizotëronte, meqë bëhej fjalë për jeta të përjetshme.

Kjo arratisje imagjinare, kësajsoj, duket si strategji letrare që autori e ka përdorur, për t'i treguar lexuesit, për tmerrin që u vijnë atyre nga tiranët, pikërisht siç ngjet në këtë roman, ku, madje tmerr bëhet edhe mbi Vezirin e madh, dhe, më këtë element letrar, Kadare tregon se, pushtet s'ajonë marrëzira, por të arsyetuar çmenduritë e tyre, duke thënë: "Ja, pra, edhe të mëdhenjtë e pësonin një lloj si të vegjlit." Njësoj e pësojnë poetët dhe njerëz të pafajshëm, siç është rasti me poetin e shquar, Tasin Kartogllin, të cilin i kërkohet llogari "për disa vargje që kishte botuar, si dhe për ca fjalë që kishte lëshuar andej-

këndej me miqtë e tij." Ndonëse, të gjitha akuzave, poeti u përgjigjet me jo, duke thënë se ato "ishin shpifje e trillime të sivëllezërve të tij smirëzinj", ai për një fije qime i shpëton verbimit. Poeti, në fund përfiton nga "zemërgjerësia" e shetit, i cili mjaftohet me gortim, fakt ky që nuk e kënaq turmën e zemëruar, që kërkon nga zyrtarët verbimin e tij.

Në romanin "Qorrfermani", Kadare shkruan edhe njëherë për natën e errët shqiptare, për Perandorinë Osmane, ndërkaq, për subjekt ka një familje shqiptare, siç ngjet me romanin e madh, "Pallati i ëndrrave", më të cilin ky roman ka një lidhje semantike dhe kuptimore.

Pra, në këtë prozë, Kadare rrahen për një dekret të sovranit të perandorisë, për një dekret të madh, por që kishte emër të shkurtër, "Qorrferman." Ky dekret absurd, i çuditshëm, por i tmerrshëm, arsye-tundit kështu: "Megenëse kohëve e fundit ishin shpeshuar rastet e goditjes së syrit të lig dhe megenëse sykeqoja (fjala ishte nxjerrë prej një fjalori të vjetër të shekullit gjashtëmbëdhjetë), kishte rrezik të kthehej në stih të vërtetë, shteti, për të mbajtur po aq vetveten, sa edhe shtetasit prej këtij rreziku, detyrohej të ndërhynte me një sërë masash.

Nuk dëshoheshin me vdekje, si dikur sykëqijtë, por vetëm u hiqej mundësia e kriminit. Dhe kjo bëhej duke u hequr armën dëmtuese, që ishin sytë e ligj.

Pra, dekretet e nxjerra e syve të këtij të të gjithë atyre që do të vërtetoheshin se ishin të tillë."

Por, pvetja e maktshme që shtrihet është si do të kryhet çsyzimi!

Dekreti, siç mund të kuptohet, ishte i maktshëm për të gjithë shtetasit e Perandorisë Osmane, të cilët ndodheshin përpara çsyzimit, pra, heqjes së syve. Dhe, si çdo dekret i madh, edhe ky kishte format e manifestimit dhe të ekzekutimit. Pra, ishin përcaktuar edhe mënyra e nxjerrjes së syve: "bizantino-veneciane (me hekur

me dy gjilpëra), tibetianen (me shtypje gurësh mbi zgrof për të shkaktuar daljen e kokërdhokëve), mënyra vendase (me thartirë gërryese), romano-kartagjenasen (me tepri drite) dhe atë europiane (me mungesë drite)". ndërkaq, për të gjithë ata që lajmëroheshin vetë, kishte lehtësira.

Përballë një atmosferë të tillë, njerëzit janë të trullorur, të humbur, të trishtuar dhe të pushtuar nga frika. Në të vërtetë, efekti i parë i këtij dekreti mizor ishte mbjellja e frikës, pra frika nga shteti. Kadare këtu luan mjeshtërisht me logjikën si funksionojnë tiranët dhe pushtetet e tilla, pushtete që ngulitin frikë të qytetarët, përmes formave të ndryshme të përhapjes së terrorit, siç ngjet në këtë roman. Autori kështu e përkrahur frikën: "Një gjë e njohur, disa e harruar që prej vjetësh, nisi të notonte në erë: frika. Ishte një frikë e veçantë, fare e ndryshme nga ato që përftojnë sëmundjet, kusarët, fantazmat apo vdekja: frika prej shtetit. E akullt, pa përmasa, me një zbrazi të madhe tejperjet, por që mbushte megjithatë gjithëcka, ditë për ditë e orë pas ore, ato nisi të përshinte në qerthullin e saj qindra mijëra njerëz."

Dekreti për të cilin rrahen Kadare, natyrisht dhe habitshëm, shkaktuan pasiguri, konfuzion, ndjenja ankthi dhe tmerr, dhe krejt këtetendosje, shkrimtari e përkrahur, duke rrahyer në dy nivele: efektet e tij të jashtme, ato që janë publike, dhe ato që ndodhin në një familje shqiptare, që janë personale, dhe lidhen me familjen e Aleks Ures.

Në mënyrë që të arrinte efektin-plorë ky dekret, duhej një fushatë e menduar mirë. E përgatitur mirë, dhe ku përfshiheshin të gjitha instrumentet e shtetit. Fushata kundër sykeqojës zhvillohet shpejt, furishëm, dhe efekti i vërtetë ishte, se "flitej hapur për larje llogarish dhe luftë për pushtet midis klanëve politike." Kjo atmosferë ka tendosur, me të gjitha karakteristikat e veta, lexuesit i duket sikur ka ndodhur në Shqipërinë totalitare dhe me personazhe lehtë të identifikueshëm. Të duket sikur verbimi për të cilin rrahet është ai i kohës së shkrimit, dhe, ç'mund të bënte me shumë një shkrimtar, që nuk i shpëton syrit të dikta-torit, sesa të arratisje në histori dhe të tregonte ferrin osman dhe kështu, analogjinë për ferrin komunist.

Ky roman, ashtu sikurse "Pallati i ëndrrave", dhe shumë romane tjera, duke përfutur nga e kaluara e shqiptarëve nën pushtimin osman apo ajo e popujve tjerë, flet për portat ferrit, përpara të cilëve ndodheshin të gjithë dhe brenda të cilit mund të përfundonte secili që vijej në kurthin e syrit të sovranit, qëvëzhgoonte çdo gjë dhe çdo kënd, me syrin e tij të mbretë të shpatën e tij të gatshme dhe mizorepër të goditë në çdo kohë. Ndërkohë që kjo furtunë e sovranit bënte punën e vet, "një valë spastrimesh, që të gjithë e ndienin

A

ARGUMENT

NGA DURIM TACI

Ndjeni se ekzistoni vetëm nëse dikush ju shikon e që t'i tërhiqni atij vëmendjen, filloni e tregoni, thotë biologu Fredrik Sjöberg në librin *'Përse ngulmojë'*. Pavarësisht zhvillimit në kohë të formave të ndryshme të ligjërimeve, bazuar të gjitha në mekanizmin simbolik të gjuhës, çështja shtrohet se si këto forma, vizatimi, shkrimi, filmi, interneti, ballafaqohen me oralitetin, të shprehurit gojor, që është zanafilla e thelbit tonë si genie shoqërore. Dhe, kjo dilemë, vënia përballë e gojores me të shkruarin, është shfaqur herët me Sokratin, i cili ishte kategorik kundër të shkruarit, u jepte mësim nxënësve të tij duke dialoguar, pa tekste.

Libri u imponua, gjithsesi, e tanimë problemi është zhvendosur më tutje, edhe pse në thelb është po ai: Libri apo Interneti? Le të mos japim përgjigje, mekanizmi që funksionon është gjithmonë ai, dialogu, por tanimë midis shumë formash.

Duke marrë në dorë librin e Agron Shalës *'Andrra në beze'*, ky shqetësim vjen e përthyer tek ti, lexues, në një pyetje tjetër: 'Po kush do të jetë padroni tani, shkruarit apo lexuesi? Është, në fakt, një pyetje që Denis Diderot e bën që në 1773 në librin *'Zhak fatalisti dhe padroni i tij'*. Është ai çasti kur e ndjen se fuqia kalon nga ty, lexues. Tani, të takon ty t'i gjejsh librit të radhës një vend në raft, ta lësh bukur zbuluar, të pak- tën, që kur të rikthehesh nga ruti-

Libri u imponua gjithsesi, e tanimë problemi është zhvendosur më tutje, edhe pse në thelb është po ai: Libri apo Interneti? Le të mos japim përgjigje, mekanizmi që funksionon është gjithmonë ai, dialogu, por tanimë midis shumë formash...

'Andrra në beze', leximi si vijim i oralitetit të humbur



na e zakonshme të mund ta vësh re e ta rimarrësh në dorë.

Apo ta hapësh njëherë e të shuas kureshtjen, çfarë asht ky libër? Ti Agron Shalën e ke lexuar, thua me vete, ke një ide për të nga shkruarit e vazhdueshme, përpos faktit që e njeh fizikisht, por në këtë çast subtil kur po ushtron fuqinë tënde si lexues, ky fakt i dytë nuk paska kaq rëndësi. Shtysa mbizotëruese është se ke krijuar një ide për stilin e tij, që ndihmon qasjen tënde drejt leximit, një shtysë e fortë që të bën ta hapësh librin menjëherë. Ke rast të vërtetosh që në titujt, paragrafët e parë, se është ai që ti njeh: ligjërime me biparet të forta metonimike, fjala bëhet etiketë, prapa së cilës ka shumë informacion shtesë, përfaqësit dhe kalimet kohore bëhen në funksion të së tashmes, analiza vjen vetvetiu, të duket se fjalën e fundit po e thua ti si lexues.

Të përshkon një hare, ke gjetur veten, atë që ti ke dashur të gesh dhe e mban librin hapur. Po për një lexues tjetër, që nuk ka lexuar asnjë rresht nga Shala, që nuk e njeh, si shkon puna me librin? Dinamikat mund të jenë të pafundme, por një gjë është e sigurt, leximi nis nga ajo që ti ke brenda, topin e parë e luanti si lexues, kushdo qofsh.

Po ti njeh rastin tënd, shtysë e vetme nuk është ajo çka ke lexuar

nga e për Agron Shalën, vetë titulli i librit *'Andrra në beze'* të çon menjëherë tek një periudhë e jetës tënde kur ti vetë, tani lexues, ishe i lidhur me filmin në formën tënde. Kush nuk është i lidhur me filmin në një farë forme? Po është herët me ushty më tutje, merru me fjalën e parë të titullit *'Andrra...'*, e aty për ty, cakto kohën kur do ta lexosh këtë libër: në mëngjes, sapo zgjohesh e sapo ndahesh me andrrat. Janë njëzetë mëngjes, zgjohesh dhe e ke librin majtas tek komodina, lexon plot pesëmbëdhjetë minuta mbi andrrat e radhës e pastaj fillon ditën.

Vijimi i titullit... në beze' të çon tek andrra personale ndërprerë në mes. Ishte viti 1991 kur ti bëje

pjesë në një grup kineastësh të rinj drejtuar nga regjisori dhe esteti i njohur i kinemasë shqiptare, Kristaq Dhama. Jo me kot të kujtohet Kristaq Dhama, që ka studiuar në Budapest, apo Piro Milkani, profesori yt i regjisë, bashkëkohës i Milosh Formanit në Pragë. *'Andrra në beze'*, filmi, kishte qenë për ty një andërr që nuk u bë realitet për shumë arsye, por ja që libri që ke në dorë ta kujton, me filmin *'Amadeus'*, pikërisht të regjisorit çek Milosh Forman, bëhet ajo lidhja midis përvojës tënde personale dhe asaj që të sjell libri, ti lexon veten duke u pasuruar me fakte të reja. Libri *'Andrra në beze'* është një filmografi e zgjedhur, aq sa të shkosh mendja t'i shikosh me radhë

të gjithë filmat që përmenden aty, udhëhequr nga analiza që u bën Agron Shala, ata që ke parë e ata që nuk i ke parë ende.

Në ditën e gjashtë të leximit ti hasin një emër: Kubrick. Kujton apartamentin tënd në Tiranë, kontrolloje teletekstin në pritje të fillimit të bombardimeve mbi Serbi, kur lexon lajmin e vdekjes së tij. Kalon një natë të trazuar. Është mbrëmja e shtatë marsit 1991, Kubrick nuk arrin të jetojë deri në '2001'. Kështu titullohet kryevepra e tij: '2001: Odisea hapësinore', ku gjen edhe një herë argumentin që e përshkon edhe gjithë librin e Agron Shalës *'Andrra në beze'*, raporti midis njeriut dhe teknologjisë.

Po, i kthehesh edhe një herë asaj që nënvizove për stilin e Shalës, e ka brenda këtë dialog midis njeriut dhe teknologjisë, ose me mirë midis njerëzve të teknologjizuar që dialogojnë. Ke ndjesinë, tekta lexon librin *'Andrra në beze'* se po vozit në internet, e aty gjen një rrefim tjetër të vetë jetës tënde në botën që krijon *'Andrra në beze'*.

Pastaj, kur ke mbaruar librin belbëzon titujt, që nuk të shqiten nga mendja: *'Dhe vrasësi vritet nga vrasësi, Të jesh askund e të flasësh me askënd për asgjë, Lufta e shoqërisë në murin mental, Lufta pas luftës...*

se ishte e fundit, kishte përfshirë gjithë shtetin. Njerëzit s'mendonin veçse si të shpëtonim nga kjo valë, e cila, ngaqë ishte e fundit, ngjante edhe më e hidhur."

Si në të gjitha vepra të mëdha letrare, edhe në këtë roman, lexuesi ndeshet me dritën dhe errësirën, me pushtetin e frikës dhe të dashurisë së njerëzve për jetën, rrjedhimisht, për dritën. Por fatet e njeriut dhe të një kombi, shteti, perandorie, në regjime të egra, përcaktohen nga çmenduritë e sovranit. E ky mund të jetë një tiran i kohëve të lashta apo i kohës së autorit, që rri në qerthullin e vet dhe nuk brenget për njerëzit, për ata që bien në pusitë e jetës. Dhe, pikërisht të drejtëve, të mirëve, ua prishë ëndrrat, siç ngjet me dy personazhet kryesorë të këtij roman, Marie Urën, dhe të fejuarin e saj, Xheladini, të cilët, tekta po përfaqësojnë të fluturorin në qiejt e lumturisë, përpara u shfaqet qielli i zi, i cili, ua errëson ëndrrat, të ardhmen, shpresat, dhe përfundimisht i hedh në humnerë.

Këtë dramë të thellë njerëzore, sidomos momentin kur Maria e kupton nga ai dashuri saj se është pikërisht ai në radhën e atyre që duhet të vërbetohet, shkruarit e përshkruan duke përshkruar gjendjen shpirtërore të tyre, por edhe kontekstin politik.

"Po përse? Përse? gati s'kllithi ajo.

Vështronte sytë e tij me atë rritje të imët boje hiri, si të kërkonte në të vjeshën që mund të kishte shërbyer si fillim i së keqes.

"Ty pyet përse, -tha ai, duke shkaktuar në fytyrë një nënqeshje të

hidhur: Nuk po e fus veten ndër sytë e ndritur, ata që shohin më qartë dhe më larg, në tëardhmen, dhe që janë të padëshiruar për çdo pushtet të tiranit.

O Zot, mendoj ajo. Babai i saj një mbrëmje ik ishte thënë pothuajse të njëjtat fjalë.

"Pra, nuk e fus veten në radhën e mendjeve të ndritura, -vazhdoi ai. Megjithatë, ka një arsye që sytë tanë duhet të zhbëhen, zhdukja e gjurmëve.

"Si? Nuk të kuptova-thotë ajo. Është e thjeshtë, -u përgjigji ai. Ne jemi dëshmitarë të shumë gjërave që duhet të harrohen.

"Kush ju? pyeti ajo. -Ne që gjer dje kemi shërbyer ne komisionet e verbimit. Sytë tanë anë parë shumë gjëra që s'duhet t'i shinin, më kupton?"

Pra, "Qorrfermani", pasi mbërrin efektin, dhe komisionarët kryejnë punë e përcaktuar nga lart, një ditë, vetëata duhet të zhduken, që të zhduken gjurmët.

Ironia me të cilën autori e qesëndis këtë ferman, përshkruhet në faqet e fundit të librit. Pasi që dekreti pushoi se ekzistuar, njerëzit më nuk kishin makt e lemeri prej tij, atëherë, për të gjithë të prekurit prej tij u shtura një, "Dreka e pajtimit."

Ajo u "shtrua në sallën mbretërore të kuajve, ndërtesë që mund të nxinte trezëra për mijëra të futar."

"Ç'ironitëre, ofsham lexuesi!"

Të verbëritë vërshuan nga të gjitha anët drejt ngrehinës. Pa dyshim, në këtë drekë ka fjalime, ku zyrtarët me patos flasin për të mirën e shtetit, por kulmi është momenti kur lexohet letra e sovranit, i cili fton të gjithë të harro-

nin ç'kishte ndodhur e t'i mbështesin besnik shtetit.

Kur të mbërrin në këto faqe, lexuesi e ndien peshën e madhe të absurditetit të veprimeve të tilla, situata këto që i përjeton në çdo kohë.

Kadare, përmes kësaj proze, tregon se, të gjithë tiranët e të gjitha kohërave, përdizen nga dëshira që të bëjnë zullum, të pastrojnë terrenin nga "sykëqijtë", prandaj, të tillëve, të çmendur, nuk duhet duartrokitur.

Kadare, në këtë libër, lexuesit i flet për Perandorinë Osmane, sovranin i të cilit, me një pushtet të pakufizuar dhe të pakontrolluar, don të do të pastronte botën nga sykëqijtë. Në të vërtetë, lexuesi i kulturuar, këtu e ndien realitetin universal, dhe nën petkun e sovranit, sheh dhjetëra tiranë të kohëve të kombeve të ndryshme. Secili lexues, kur të përfundojë romanin, e kupton ç'lemeri shkakton totalitarizmit, të cilin autori e përshkruan përmes ikjes në kohë dhe hapësirë, dhe me një nëntekst të sofistikuar, për t'i dhënë status universal.

Natyrisht, si në gjitha rrefimet letrare, këtu ka intriga, mashtrimet, trille, habi, dhe lojë të pafund. Kadare me virtuzitetin dhe me stil elegant e përshkruan dramën e personazheve të tij, në një atmosferë mjegullnave e zymtësie, ku secili mund të mendonte për tjetrin: po sikur ai të dyshonte me të. Dhe kjo mjaftonte që ai të tërbohë. Pra, në këtë atmosferë, askush, përveç të verbërve, nuk ishte i sigurt se mund të ndodhej jashtë veprimtërisë së dekretit, dhe siç e kuptuan shumë shpejt të gjithë, këtu mbështetej

pikërisht fuqia hijerëndë e Qorrfermanit"-shkruan Kadare.

Shkrimtari, me nota tejet delikate dhe njëkohësisht lirike, e përshkruan dramën në familjen e Aleks Urës, aty ku vajza e tij, Marie Ura, përfaqëton të martohet me Xheladinin, zyrtarin turk. Maria është një personazh fantastik. Plot jetë dhe gjallëri, ajo përshkruhet si vajzë e dëlirë, e çiltër, plot hirc dhe pa kurrfarë hezitim tonon nëpër ujërat e ëmbla të seksit, ndonëse ende e pamartuar. Skenat që përshkruan autori për brenda mureve të shtëpisë së saj, janë peizazhëmahnitëse letrare. Maria, mbyllet në dhomën e vet, zhveshët dhe me orë të tëra provon të brendshmet e saj para pasqyrës, dhe kur ka fatin të ketë të dashurin aty, provon ëmbëlsinë e seksit, si një ndjenjë fisnike njerëzore. Ajo e pasionuar, nuk çan kokën për politikë, pos që, pret të martohet të rri me orë të tëra me burrin e saj e zhveshur, siç ka dëshirë. Por kjo ëndërr i këputet, sepse burrit të saj të ardhshëm, pak kohë para se të martoheshin, i jepet vendimi që të çyzohet, pra atij do t'i hiqen sytë, do të verbohet. Drama është e madhe, e pamatshme, e papërshkrueshme, është dramë e shpirti të tronditur, që, duke ëndërrua qiejt e lumturisë, përjehërbënie në sketërrë. Skenat që jep Kadare në roman, lexuesit i mbesin gjatë në kujtesë. Sidomos, momenti tejet tragjik, kur Maria, në kulmin e kënaqësisë e kupton se është jella e saj po shembet.

Xheladini, është personazh tragjik, që ka fatin e qindra e mijëra viktimave të sistemit. Ai i duhet

sistemit për t'i zhdukur gjurmët, prandaj duhet të dënohet. Lexuesi ndien dhimbje për të, si dhe mëlafetin e tij, që vëzohet për tokë.

Romani "Qorrfermani" është shkruar memjeshërit, ku përshkruhet me nota dramatike pushtetin e frikës që buron nga tirania, por aty ndeshim, gjithashtu, pushtetin e dashurisë së madhe, dhe tëshëta vdekjeprurëse që i godasin atë. Vetëm një mendje gjeneale, si ajo e Kadaresë, më një talent të pasqoh, ka mundësi që me kaq mahnitje, tension, pasion, dhe dhimbje, të krijojë një roman kaq dridhmes dhenjëkohësisht, të shkruar kaq bukur.

Autori, edhe në këtë roman, siç ngjet në shumicën e veprës së tij, ka provuar suksesshëm fuqinë e epërme të letërsisë, si gjuhë e mendim, për të reguar ekzistencën tonë dhe sfiljtjet përballë pushtetit dhe formave të tij të egra, kur ai stërkeqet dhe tenton të kontrollojë gjen më të çmuar të njeriut: lirinë.

Letërsia e Kadaresë përpara lexuesitshfaqet si hapësirë e pafundme ëndjesh e ardhjes. Autori e arratisë lexuesin në histori dhe e rikthen në aktualitet, përmes fuqisë ërrëfimit, letërsisë, dhe veprave të shkruara me sqimë dhe gjenialitet. Vepra e tij shfaqet si zbulim mahnitës, ndërkaq, shkruarit, me erudicion letrar, përherë arrin t'ia paraqesë lexuesit një botë të veçantë, më bukuritdhe shëmti dhe ku kujtëje të mundshmes dhe të pamundshmes, shfaqen e zhduken, si portat e ferrit dhe të parajsës. Pa dyshim, nëpër këso labirinte artistike, mund të shpjet vetëm imagjinata e një shkruarit pa caqe gjuhësore dhe me imagjinatë pa kufij.

A

ARTIKULL

Eksploruesi britanik Robin Hanbury-Tenison në faqet e këtij libri i ka përshkruar me thjeshtësi, sinqeritet dhe vërtetësi të admirueshme përshtypjet e kësaj aventure shqiptare. “Vendi i Shqiponjave, me kuaj përmes vendit të harruar të Europës” është një libër i cili është promovuar para disa kohësh në Royal Geographic Society në Londër, e cila është një nga qendrat më prestigjioze të eksplorimeve, që financon eksplorime në vende të ndryshme të botës... Por, më e dhimbshme në këtë libër duket se është ajo çfarë shkruhet për ministrin pa kulturë të Kulturës shqiptare

Tenison, libri i tij “Land of Eagles”, dhe një ministër shqiptar

NGA NDIK GJINI*

Në librin “Land of Eagles”, të botuar para pak vitesh në Angli, me autor Robin Hanbury-Tenison, përveç fjalëve të mira që fliten për Shqipërinë dhe mikpritjen shqiptare, shpaloset dhe shëmtia, fodullëku, dhe mosmikpritja e ministrit shqiptar të Kulturës të vitit 2007, dhe djalit të tij.

Ministri i Kulturës, në këtë libër, nuk përmendet me emër, ndaj dhe unë po e lë pa emër.

Autori i këtij libri, Robin Hanbury-Tenison, është një personalitet i vlerësuar nga revista “Time” si eksploratori më i madh në botë i 20 viteve të fundit.

Në fillimvjeshtë të vitit 2007 ai vizitoi Shqipërinë. Së bashku me gruan e tij, hipur mbi kuaj, nëpër shtigje malesh, dhe jo rrugëve me asfalt, ata e përshkruan hapësirën shqiptare nga Veriu në Jug.

(Ky libër nuk besoj të jetë përkthyer ende në shqip. Ndofta dhe po. Por qëllimi i këtij shkrimi nuk është një thirrje për përkthimin e këtij libri, dhe as koment rreth këtij libri, i cili, sipas mendimit tim, është një libër i shkruar mirë, dhe përgjithësisht flet shumë mirë për Shqipërinë dhe shqiptarët, përveç të katër-pesë faqeve të tij ku flitet për një gjest të pakulturë të ministrit shqiptar të Kulturës).

Çfarë ka ndodhur realisht atë natë në bujtinën mes maleve?

Nga faja 32 deri në faqen 37 të këtij libri, autori përshkruan rrugëtimin e tij dhe ekipit të tij, sesi hipur mbi kuaj ata kaluan nga Thethi në Valbonë. Ai përshkruan bukuritë magjepsëse të natyrës, aventurën e asaj rruge, shiun që i lag, lodhjen, urinë, rreziqet që parajsin ato shtigje të ngushta etj. Ai tregon sesi pak pa rënë nata, në afërsi të Valbonës, ata kishin humbur rrugën. Dhe më tej përshkruan skenën kur aty kalon një makinë policie e më pas disa fuoristrada. Ato ndalojnë, përshëndeten, madje dhe prezantohen midis tyre. Një nga pasagjerët që zbrit nga fuoristrada prezantohet para tyre si ministri i Kulturës i qeverisë shqiptare. Bisedojnë për pak minuta. Dikush u tregon me dorë shtegun që të shpie te bujtina e vetme në atë zonë... dhe me pas ministri me eskortën e tij hipin në makinat e tyre dhe largohen. Tenison me gruan e tij dhe shoqëruesin bëjnë edhe nja dy orë rrugë hipur mbi kuaj, derisa mbërrijnë te kjo bujtinë, shkruhet në librin “Land of Eagles”. Kur mbërrijnë, janë krejt të lagur, të uritur, të lodhur e të stërmunduar nga rruga e gjatë, shkruan ai. Pikërisht tek ajo bujtinë kishte shkuar për të dërkuar edhe ministri i Kulturës me djalin e tij, së bashku me disa të tjerë, tregon autori. Pronari i bujtinës ua hap derën dhe i mirëpret. Por e gjithë vëmendja




është e përqendruar te ministri. Askush nuk do t'ia dijë se Tenison, gruaja e tij, dhe shoqëruesi janë të lagur, të uritur e të lodhur. Në dhomën e pritjes së kësaj bujtine as ministri dhe as i biri nuk denjojnë të ngrihen e t'u lëshojnë pak vend në divanet ku janë ulur. Robin tregon sesi atij, gruas së tij dhe shoqëruesit u shërbehet për të ngrënë nga ato pak ushqime tani më të ftohta që kanë mbetur prej tavolinës ku kishte ngrënë ministri me grupin e tij. Ai tregon sesi ministri luan me pultin e televizorit duke ndryshuar kanalet me shpejtësi, pa ia ditur fare për

Autori i librit dhe ministri

Autori i këtij libri e kishte krijuar përfytyrimin e tij për Shqipërinë para se të vinte në këtë vend. Këtë gjë e dëshmojnë citimet që u bënë në libër të mëse 20 autorëve të tjerë që kanë kaluar nëpër Shqipëri dhe që kanë shkruar rreth Shqipërisë. Shënimet e udhëtarëve si Edith Durham, Lord Bajron, Martin Leak e kanë intriguar së tepërmi autorin dhe këtë e shpreh në mënyrë mjaft të sinqertë në faqet e librit.

Nuk e di se ku është, dhe se çfarë po bën aktualisht ‘ministri shqiptar i Kulturës, i vitit 2007’ (ai që Tenison përshkruan në libër), por gjithsesi këshilla ime është që këtë libër ta lexojë së paku këshilltari për kulturën i kryeministrit të Shqipërisë dhe t'i sugjerojë kryeministrit t'i shkruajë Robin Hanbury-Tenison një letër falënderimi për botimin e këtij libri, si dhe t'i kërkojë atij ndjesë për sjelljen e padenjë të ministrit të Kulturës, të vitit 2007.



mysafirët e huaj që ndodhen aty. Ai tregon sesi ai dhe i biri janë mosmikpritës deri në paturpësi dhe fodullë të pa fre. Autori i këtij libri përshkruan gjithçka në detaje, sesi ministri fillon t'i japë mend atij rreth nevojës së reklamimit të bregdetit shqiptar dhe jo zonave malore etj.

Tenison konkurron në Festivalin e Kanës me filmin e tij për Shqipërinë

Eksploruesi britanik Robin Hanbury-Tenison në faqet e këtij libri i ka përshkruar me thjeshtësi, sinqeritet dhe vërtetësi të admirueshme përshtypjet e kësaj aventure shqiptare. “Vendi i Shqiponjave, me kuaj përmes vendit të harruar të Europës” është një libër i cili është promovuar para disa kohësh në Royal Geographic Society në Londër, e cila është një nga qendrat më prestigjioze të eksplorimeve, që financon eksplorime në vende të ndryshme të botës.

Në faqet e këtij libri shpaloset bukur Shqipëria me kulturën e historinë e saj të pasur, shpalosen doket dhe zakonet shqiptare.

“Shqiptarët janë një popull mikpritës. Shqipëria është një vend që për vite me radhë është veshur me misteriozitet përballë publikut të huaj. Unë dua t'u tregoj njëzëre realisht se cila është Shqipëria dhe pse duhet ta duan ata...”, thoshte Robin Hanbury-Tenison në shtator të 2007-ës, kohë kur nga Thethi nisi aventurën e tij.

Në çdo faqe të këtij libri ndihet dashamëria dhe mikpritja e popullsisë rurale, të cilët hapën për Tenisonin dhe ekipin e tij dyert e shtëpive, u ofruan atyre bukë të ngrënte, djathë të bardhë të kripësuar, dhallë dhe raki. Kështu që sjell-

Ja disa fragmente nga ky libër rreth kësaj ngjarjeje

.....There was quite a crowd on the three small sofas, one of which was entirely taken up by the Minister's extremely tall son, who did not get up to offer us a space on it. The atmosphere was palpably unfriendly and when I explained to the Minister that our purpose was to encourage tourism in the lesser-known parts of Albania, he said we would do better to go along the coastal villages. He then ignored us and concentrated on flicking between channels on the fuzzy television set.

Faqe 33.

.....During this time the Minister was becoming increasingly and visibly annoyed and he suddenly ordered everyone to bed. At which point the lights went out.....

Faqe 34

..... and we were left alone. With our clever head torches, we were able to stay up a bit longer to write up our diaries after a very long day. We had walked and ridden for ten and half hours over difficult terrain, crossed a 2000 m pass and got soaked several times. We should have been unhappy but we went to our bunks giggling at the absurd atmosphere.....

Faqe 34



vogëlsinë, fodullëkun dhe mosmikpritjen e tij.

Libri i Tenison-it u shtohet zërave që promovojnë sot Shqipërinë turistike, një vend i njohur më së pari përmes shënimeve të udhëtarëve të shekujve të shkuar, por njëkohësisht i panjohur e i pashkelur për shkak të izolimit 50-vjeçar.

Një letër falënderimi dhe ndjesë për autorin e këtij libri

Autori i këtij libri e kishte krijuar përfytyrimin e tij për Shqipërinë para se të vinte në këtë vend. Këtë gjë e dëshmojnë citimet që u bënë në libër të mëse 20 autorëve të tjerë që kanë kaluar nëpër Shqipëri dhe që kanë shkruar rreth Shqipërisë. Shënimet e udhëtarëve si Edith Durham, Lord Bajron, Martin Leak e kanë intriguar së tepërmi autorin dhe këtë e shpreh në mënyrë mjaft të sinqertë në faqet e librit.

Nuk e di se ku është, dhe se çfarë po bën aktualisht ‘ministri shqiptar i Kulturës, i vitit 2007’ (ai që Tenison përshkruan në libër), por gjithsesi këshilla ime është që këtë libër ta lexojë së paku këshilltari për kulturën i kryeministrit të Shqipërisë dhe t'i sugjerojë kryeministrit t'i shkruajë Robin Hanbury-Tenison një letër falënderimi për botimin e këtij libri, si dhe t'i kërkojë atij ndjesë për sjelljen e padenjë të ministrit të Kulturës, të vitit 2007.

Opinioni **i** Ditës

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

... e fuqive më të mëdha e që përfaqësojnë dy ekonomitë më të mëdha në botë, që përfshin në brendësi të saj interesa thelbësore, që afektojnë jo vetëm ecurinë e marrëdhënies mes tyre, por edhe zhvillimet botërore në tërësi. Kina është aktualisht fuqia e dytë më e madhe ekonomike në botë. Kjo ambicie është shumë e rëndësishme brenda strategjisë e programit të saj të statusit e rolit të saj si superfuqi botërore, që presupozon rivalitetin e ndarjen e rolit e të fuqisë me SHBA. Në dallim nga Rusia, Kina është shfaqur më e përbajtur, më e kujdesshme, më strategjike, në synimin që t'i arrijë plotësisht objektivat që ka përcaktuar, në materializimin e një roli esencial superfuqie botërore në sistemin e marrëdhënies ndërkomëtare.

Me një strategji të udhëhequr nga filozofia, tradita, historia e vet dhe pragmatizmi, me formësimin e një modeli të zhvillimit ekonomik, politik e social, me karakteristika specifike kineze, që përfaqëson një përzjerje të koncepteve komuniste, por edhe të pragmatizmit e ekonomisë së tregut, Kina ka mundur të mundësojë një zhvillim ekonomik të gërrueshëm dhe me rritje të lartë ekonomike, që i ka mundur pa konflikte e qëndrime të ashpër, një rol të dukshëm qartë në zhvillimet botërore. Ajo tashmë ka një rol konkret në Azi, të dakordësuar edhe me SHBA, që nga presidencia Obama. Po kështu, Kina pa u ndjerë shumë ka punuar me vendosmëri për të shtratur një rol të saj në Paqësor, ku ka përfshirë një fuqizim të forcës ushtarake të saj, madje edhe përmes ishujve të saj artificialë të fortifikuar ushtarakisht, që ka sjellë kundërshtimet e vendosur të fqinjëve të saj si Vietnam, Japonia, Taiwan, etj., por që tash edhe të SHBA. Kina duket se synon jo vetëm të përfortojë fuqinë e prezencës ushtarake në këtë rajon tepër të rëndësishëm, jo vetëm strategjik, ekonomik e tregtar, por edhe të mbajë nën kontroll rrugët të rëndësishme tregtare. Në funksion të strategjisë së superfuqisë botërore, jo vetëm të rivalitetit me SHBA e ndarjes së fuqisë me të, por edhe për t'u bërë superfuqia e parë botërore, Kina po materializon strategjinë saj edhe në hapësirën europiane me programin e rrugës së mëndafshit, apo edhe të investimeve në infrastrukturë, por edhe duke shfrytëzuar aktualisht edhe grindjen brenda perëndimit. Kina është treguar pragmatiste në këtë ecuri, teksa ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me interes me Rusinë, të cilës i ka interesuar gjithashtu, kjo shfaqje dyshë me Kinën, për të zhvilluar rivalitetin e ndarjen e fuqisë me SHBA. Megjithatë, Kina është shumë e qartë se çfarë kërkon e ku synon të arrijë, por që tash duket se po reagon vërtet me përbajtje, por tashmë edhe duke demonstruar forcën, në atë që tashmë njihet lufta e vërtetë tregtare me SHBA. Aktualisht, pjesë integrale e përbajtjes së marrëdhënies SHBA-Kinë është lufta tregtare e nisur pas vendimit amerikan për vendosjen e tarifave, që nuk janë vetëm kundër Kinës, por edhe ndaj aleatëve europianë. SHBA e ka motivuar lëvizjen e saj me synimin e vendosjes së balancave të ekuilibruara në tregtinë me tyre.

Tani së fundi u mësuja se pas një

SHBA-Kinë, jo vetëm luftë tregtare



takimi SHBA-BE në Uashington, logjika e racionalitetit dhe e efektivitetit ekonomik, interesat e rëndësishme dhe vlerat e përbashkëta që ndan aleanca euroatlantike, mundësuan shmangien e një lufte tregtare për të punuar së bashku e hapur një periudhë të re miqësie të ngushtë dhe marrëdhënie të forta tregtare, nga të cilat do të fitojnë të dyja palët. Marrëveshja e arritur mundëson të punohet, siç u theksua në konferencën e përbashkët për shtyp Trump-Junker, drejt tarifave zero, barrierave dhe subvencioneve. Edhe pse në Europë jo të gjithë mund të jenë njësoj të lumtur, ky është një zhvillim pozitiv. Ndoshë, një filozofi e tillë mund të sjellë edhe një zbutje të luftës tregtare mes SHBA dhe Kinës, edhe pse kontradiktat mes tyre ka natyrë e përbajtjeje më komplekse.

Përveç diskutimeve rreth dukurive të globalizimit dhe proteksionizmit, në funksion të një dialogimi rreth pozicioneve konkrete dhe të parandalimit të një lufte të vërtetë tregtare, u zhvillua edhe një takim në muajin qershor, mes sekretarit amerikan të tregtisë, V.Ross dhe zëvendëskryeministrit kinez Liu He, që diskutuan ecurinë e partneritetit, por edhe problemet e lindura mes dy vendeve. Kina është shumë e interesuar realisht të shmangë një luftë tregtare me SHBA, edhe pse e mendon se pasojat do të ndjehen mes dy vendeve dhe përtej tyre, në tregtinë botërore. Takimi mes tyre duket se e synonte mënjanimin e një konflikti tregtar edhe pse Kina tashmë nuk mund të qëndrojë pa reagu, apo të tolerojë një prepotencë amerikane ndaj saj.

Qëndrimi i Kinës përfshiu disa elementë: as konflikt, as prepotencë, por as dhe lëshime, që do ta dëmtonte Kinën ekonomikisht e politikisht. Kina është shfaqur mbështetëse e qartë e globalizimit edhe duke e parë atë në interes konkret për zhvillimet ekonomike të Kinës, por edhe për të fuqizuar rolin e saj si superfuqi botërore në zhvillimet ndërkombëtare. Ross dhe He u fokusuan jo rastësisht te problemi i eksporteve, që prek fitimet reciproke, por edhe ai që lidhet me pronësinë intelektuale, ku SHBA ka akuzat konkrete ndaj Kinës. Duket se bisedimet kanë qenë shumë të vështira, apo se nuk ka qenë efektivi ky takim, ku u duk se nuk u arrit asnjë dakordësim apo kompromis. Ky zhvillim dësh-

mon kështu për një luftë të vërtetë tregtare, me pasojat për të dyja vendet, por që nisur nga pesha e roli i këtyre dy fuqive ekonomike më të mëdha në botë, do të sjellë pasojat direkt në ekuilibrat ekonomikë botërorë. Shpejt u mor vesh se lufta tregtare kishte nisur pa këhim. Kina shpejt deklaroi se nuk do të hynte në fuqi asnjë marrëveshje tregtare apo biznesi mes dy vendeve, nëse SHBA do të vendoste sanksione e tarifa të tjera, që nënkupton kështu se marrëveshja tregtare në fuqi nuk do të jetë më e vlefshme në të dyja palëve. Megjithatë, duke marrë parasysh interesin e vet ekonomik e financiar, por edhe rrezikun kompleks që prodhon prishja e ekuilibrave të vendosur. Kina u shfaq e gatshme si për të zgjidhur mosmarrëveshjet tregtare, ashtu edhe për të ngushtuar disbalancën tregtare me SHBA. Fakti që nuk u përcoll ndonjë deklarate e përbashkët dëshmoi se konflikti e lufta tregtare ishte dhe është në zhvillim. Në fakt, Kina u përpoq të ishte sa më konstruktive në këtë debat e luftë, duke shfaqur një pajtim për një konsensus tregtar, që do të rriste dukshëm blerjen e mallrave amerikane në tregun kinez. SHBA, që mban parasysh sufficitin e madh tregtar të Kinës me SHBA insiston në ndryshime jo të pjesshme, por rëndësore në marrëdhëniet tregtare mes tyre. Pas kësaj, lufta tregtare me vendosje sanksionesh reciproke po merr përbajtje konkrete.

Nisur nga pesha e këtyre ekonomive në ekonominë e tregtinë botërore dhe nga përmasat që ka marrë globalizimi, duket që nuk do të ketë thjesht një luftë tregtare mes SHBA dhe Kinës, por që do të jetë një luftë tregtare globale, që do të cenojë të gjithë ekuilibrat që janë vendosur. Interesa të rëndësishme ekonomike bëjnë trysni bashkëpunimi. Dhe në fakt mësohet se BE dhe Kina e mendojnë në këtë situatë një harmonizim kontributesh, me synimin e modernizimit të rregullave të tregtisë botërore, për t'u përshtratur politikisht teknologjike dhe subvencioneve qeveritare, me synimin që të mundësohet mbrojtja e mjedisit të tregtisë botërore. Duke marrë parasysh edhe një luftë tregtare reale të SHBA me aleatët e vet euroatlantikë, Kina e përshkallëzon përgjegjësinë e SHBA, teksa e akuzon se po i hap zjarr botës.

Në këto kushte, Kina e sheh me interes të lëvizë drejt një bashkëpunimi, fillimisht ekonomik e tregtar, me vendet e BE, për të përballuar një luftë tregtare me SHBA, por edhe për të minimizuar sa më shumë pasojat e pashmangshme nga kjo luftë. Në kushtet e një lufte të vërtetë tregtare, por edhe të një grindjeje brenda perëndimit, hapësira europiane, siç ka përmendur nënkështetari amerikan i shtetit për Europën, Mitchell, po shihet nga Rusia dhe Kina si një teatër i vërtetë i konkurrencës serioze strategjike.

Kjo lëvizje kineze nuk ka vetëm dimensionin tregtar dhe ekonomik, por është në funksion edhe të avancimit të pozicionit të saj të superfuqisë botërore, në rivalitetin për ndarjen e fuqisë dhe rolit me SHBA-ve në zhvillimet botërore, për konsolidimin e një roli të ri botëror të Kinës. Sot flitet edhe për një luftë monetare, përveç asaj tregtare mes SHBA dhe Kinës. Kjo lidhet edhe me rënien e ndryshime të monedhës kineze. Njohetohet se monedha kineze, që ka ardhur në rënie, u dobësua së fundi me 1% ndaj dollarit amerikan, duke arritur nivelin më të ulët brenda një viti. Ka shqetësime edhe për një ngadalësim të zhvillimit ekonomik të Kinës, që rrezikon ekuilibrat botërorë për shkak të peshës së ekonomisë kineze në ekonominë e globalizuar. Disa e shpjegojnë këtë rënie edhe si një mundësi për Kinën, për eksportet kineze, në kushtet e luftës tregtare e të tarifave të imponuara nga SHBA, me mendimin se produktet kineze bëhen më të lira për blerësit që paguajnë në dollarë. Disa mendojnë se kjo rënie mund të ndikojë pozitivisht sa u përket rritmeve më të larta të rritjes ekonomike kineze, që këto dy vjetët e fundit kanë qenë të ulëta. SHBA e ka kritikuar Kinën në qëndrimin e saj, që mban monedhën e saj në nivel të ulët dhe që e përdor atë në luftën tregtare me SHBA. Megjithatë, specialistët mendojnë se, nëse monedha kineze do të bjerë më shumë, kjo do të ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik të Kinës.

Kjo luftë tregtare me SHBA ka pluset dhe minuset e veta, sa i përket avancimit të strategjisë së Kinës për superfuqi botërore. Duke shfrytëzuar edhe grindjen komplekse të SHBA me BE, por edhe problematikën e brendshme të BE, ngecien e avancimit të projektit europian, Kina në proces ka

materializuar strategjinë e saj të rolit të superfuqisë në hapësirën europiane. Ajo ka zhvilluar me sukses armën ekonomike, investimet në infrastrukturë e gjetkë, që vërtet kanë funksionuar. Ajo po e shfrytëzon me sukses zënie e boshllëqeve që krijohen në hapësirën europiane, madje edhe duke mbajtur në konsideratë edhe lëvizjet e Rusisë. Kina jo vetëm e përdor grindjen brenda perëndimit në përballimin e luftës tregtare me SHBA, por synon ta shfrytëzojë në forcimin e pozitave të saj në rivalitetin me SHBA, për ndarje të rolit e fuqisë në zhvillimet botërore.

Në këtë realitet të krijuar, duket se Kina e mendon një bashkëpunim apo grupim të saj me BE, apo me disa vende europiane. Aktualisht po synon një dimension ekonomik e tregtar, në emër të përballimit të luftës tregtare me SHBA, ku në funksion të tij ka qenë menduar edhe një samit i përbashkët. Duket që Kina e ndjek me vëmendje grindjen brenda perëndimit dhe nuk e përjashton të përfitojë maksimalisht jo vetëm në rivalitetin me SHBA, por edhe duke shpresuar në ndryshime më esenciale në të ardhmen. Mënyra se si Kina po lëviz aktualisht tregon qartë se shfaq interes konkret për rritjen e bashkëpunimit me aktorë të tjerë, përfshi edhe aleatët europianë të SHBA, për një pozicion roli udhëheqës në qeverisjen globale. Manovrimet e saj aktuale në marrëdhënien me SHBA, por edhe me Rusinë e vendet e BE janë shprehje e pragmatizmit kinez për të marrë maksimumin e mundshëm, brenda zhvillimeve të sotme. Duket që pjesë e ambicieve gjeopolitike të Kinës është edhe kontinenti afrikan, që ka nevojë tepër të mëdha për investime ekonomike. Pikërisht, jo thjesht për të testuar këto nevojë, por për të shtratur bashkëpunime konkrete, po zhvillon vizitën e tij në këtë hapësirë të madhe presidenciale kineze, Xi Jin Ping. Edhe pse programi kinez i realizimit të ambicisë së statusit të superfuqisë botërore është pasuruar në proces, sendërtimi i një roli të Kinës në këtë kontinent ka qenë pjesë e këndësishme. Ofensiva aktuale kineze në Afrikë sjell në vëmendje një ofensivë të vjetër të Kinës komuniste, me vizitën e kryeministrit Cu En Lai në këtë kontinent, me synimin për tregje, që mundësonin zhvillimin ekonomik të Kinës, por edhe zgjerimin e rolit të saj në botë.

Siç shihet, përveç objektivit të marrjes së Tainanit, apo bashkim-it të tij me Kinën, të përcaktuar në programin e "katër modernizimeve", ka sot disa lëvizje ekonomike, tregtare, ushtarake, të dukshme e të padukshme nga Kina, në funksion të arrijtes së rolit e të superfuqisë botërore. Madje, ndonjë nxiton të pohojë se Kina synon të zëvendësojë SHBA në udhëheqjen botërore. Ka sot një luftë të hapur tregtare, por edhe një luftë të ftohtë SHBA-Kinë. Zëvendësdrjetori i CIA-s, Michael Collins mendon se "është luftë e ftohtë, por jo si ajo klasike që njohim". Sipas tij, Kina shfrytëzon çdo mundësi të ligësishme e të paligësishme, publike dhe private, ekonomike e ushtarake, për të dëmtuar pozicionin e rivalit të saj... por pa përdorur si mjet konfliktin. Kina, sipas tij, punon çdo mjet që vendet të tjera të mbështesin qëndrimet e saj dhe jo të SHBA. Ky zyrtar amerikan mendon se Kina është kërcënim i dhe sfida më e madhe globale me të cilën SHBA përballlet. Madje, Collins mendon se Kina ka krijuar një konkurrencë me ne dhe atë që ne përfaqësojmë, shumë më tepër se ç'mund dhe çfarë kanë mundësi të bëjnë rusët. Ky argument mund të ndihmojë të shpjegojë deri diku edhe lëvizjen e hapjes së një dialogu e marrëdhënieje të re mes SHBA dhe Rusisë, të inauguruar në takimin e Helsinkit.

Më 27 korrik 2018

Opinion i Ditës

Mandati i tij - mandat i gjithëkohshëm

Nga Rexhep Qosja

(vijon nga faqja 1)

... i gjithëkohshëm në historinë e popullit shqiptar: i gjithëkohshëm me emrin e tij, me veprën e tij, me lavdinë e tij.

Në jetën dhe në historinë e popullit shqiptar, ai ishte i veçantë me çdo gjë e me të gjitha.

Ai e jetonte idealin e tij, ai e jetonte fjalën e tij, ai e jetonte gjithë veprën e tij.

Ideali i tij, fjala e tij ishte, është dhe do të jetë përgjithmonë njëkohësisht ideal i kombit shqiptar, fjalë për kombin shqiptar.

Herët, në rini ai u bë mësuesi historik, politik, kulturor, kombëtar e moral i rinisë shqiptare në Kosovë.

Ai u bë mësuesi i qëndrimit të drejtë, të papërkulshëm, të dinjitetshëm, që nuk e përkulnin lehtëmendjet, premtimet, kërcënimet, burgjet.

Ai u bë parathëniesi i lirisë dhe i pavarësisë së Kosovës.

Ai u bë parathëniesi i bashkim-it kombëtar shqiptar.

Idealin e madh të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, ai e jetoi me 28 vjet burgje dhe me shumë përndjekje e krajata para dhe pas burgjeve.

Dhe këto 28 vjet burgje dhe këto përndjekje e krajata u bënë dëshmi sipërorë që të gjithëve - bashkëkombësve dhe të huajve - dëshmonin se Adem Demaçi po ia dhuronin rininë, pjekurinë, dhuntinë krijuese kësaj lirie dhe pavarësisë të Kosovës.

Me këtë sakrificë madhështore historike ai e dëshmoi burrërinë, vendosmërinë, parimësinë politike e morale edhe kur doli prej burgjeve.

Sot kur Baca Adem u nda prej nesh vetëm me trupin e tij e do rendi të vetëpyetemi: ç'ka bëjnë ne për të?

Sot kur u nda vetëm me trup prej nesh e do rendi të vetëpyetemi se çka bëjnë për të, ata që e sundojnë politikisht e shtetërisht Kosovën sot?

Përgjigjet janë dëshpëruese!

Ata që edhe në ditët e luftës çlirimtare e vallëzonin vallen e paqes turpërore nën dhunën dhe terrorin e regjimit serb i dhuruan Bacës Adem mohime, denoncime, përgjashtime, fyerje!

Ata të tjerët që pas luftës e bënë dhe po e bëjnë demokracinë e Kosovës - demokraci rurale e private e privuan Bacën Adem prej çdo mundësie që të bëhej çka para të gjithëve i takonte të bëhej: që të bëhej i pari i Madh i Kosovës.

Nuk i lejuan të bëhej kryetar i Kosovës, nuk i lejuan të bëhej kryeministër i Kosovës, nuk i lejuan të bëhej as ministër i Kosovës! Prej ish-të burgosurve politikë u pro-



pozua që të bëhej deputet i Kosovës, por nuk e lejuan kandidimin e tij as për deputet të Kuvendit të Kosovës, ata që edhe për kandidime vendosnin!

Popuj të tjerë, me tradita politike, shtetërore e morale, i zgjedhin senatorë apo deputetë të përjetshëm figurat politike me meritë të veçanta në historinë politike, kulturore e qytetërore të tyre.

Politikanët dhe shtetarët e Republikës Jugafrikane e bënë Nelson Mandelën figurë politike e morale botërore, sepse ashtu e meritonte Mandela dhe sepse ashtu e donin interesat politike e shtetërore të asaj republike.

Por pushtetarët e sotëm të Kosovës nuk i lejuan Adem Demaçit të bëhej as deputet katërvjeçar i Kuvendit të Kosovës!

Pse? Pse e cenuan kështu Adem Demaçin dhe pse e cenuan kështu Republikën e Kosovës.

Ata që nuk ia lejuan Adem Demaçit as tri minuta fjalë në Parlamentin e Kosovës, ata që e privuan prej të drejtës së tij sipërore që të bëhej çka i takonte të bëhej në Kosovë, u frikësuan prej tij: prej etikës së tij politike e shtetërore, prej burrërisë së tij, prej nderit të tij, prej vendosmërisë së tij, prej parimësisë së tij, prej humanizmit të tij dhe u frikësuan sepse ai, Baca Adem, nuk do t'i lejonte të bëjnë çka bëjnë e çka po bëjnë: ai nuk do

t'i lejonte të zhvatën Kosovën, ai nuk do t'i lejonte të plaçkisnin pasuritë e përbashkëta të Kosovës, ai nuk do t'i lejonte të bëhen milionerë duke përdorur e shpërdorur siç po i shpërdorin postet politike e shtetërore të Kosovës shtetërisht të privatizuar prej tyre.

Dhe, ai nuk do t'i lejonte t'i sjellin Kosovës aq tragjikomedi politike, ekonomike, diplomatike, kombëtare e ndërkombëtare që po ia sjellin asaj sot!

Por, o çfarë ironie!

Ata që nuk e lejuan të bëhet as kryetar i Kosovës, as kryetar i Parlamentit të Kosovës, as kryeministër i Kosovës, as ministër i Kosovës, madje as deputet i Kosovës, ata dje mbajtën akademi për të në sallën gati përgjysmë të zbrazët të Parlamentit të Kosovës dhe ata mbajtën fjalime në atë akademi për të.

Ata shpallen tri ditë zie për të. Sot ata mbajtën edhe një akademi për të, që e quajtën ceremoni dhe e mbajtën në sheshin para Teatrit Kombëtar të Kosovës, ku u rreshtuan njëri pas tjetrit në radhë të parë për ta përdorur lavdinë e Bacës Adem për interesat e tyre pushtetore.

Prehu i qetë në dheun e Kosovës, Bacë i dashur!

I privilegjove për të të nderuar kështu të ndarë nga jeta ata që këtë privilegj në asnjë mënyrë dhe

me asgjë nuk e merituan!

Vepra jote mendore e morale, veprimtaria jote politike kombëtare, lavdia jote historike, burrëria jote, ecja jote gjithmonë e dinjitetshme do të edukojnë gjithmonë rininë tonë dhe do ta lëvizin përparueshëm historinë shqiptare.

Ti ishe më shumë se kryetar i Kosovës, ti ishe më shumë se kryetar i Parlamentit të Kosovës, ti ishe më shumë se kryeministër i Kosovës, ti ishe më shumë se ministër i Kosovës, ti ishe më shumë se deputet i Kosovës.

E si të mos ishte?! Ti na dhurove si trashëgim mospajtimin me pushtimin, me çdo lloj pushtimi, me çdo lloj pushtimi e nënshtrimi në të cilin ishte dikur Kosova, por ti na dhurove si trashëgim edhe mospajtimin me të gjitha të këqijta që cenojnë interesat e përgjithshme shoqërore: mospajtimin me korruptionin, mospajtimin me nepotizmin, mospajtimin me zhvatjen e pasurive të përbashkëta të Kosovës, mospajtimin me gënjeshtret, mashtrimet dhe arrivizmet që e kanë mbuluar sot Kosovën.

Ti ishe dhe mbetesh ndjenja, ndërjegjia dhe mendja historike në castet më të vështira të popullit shqiptar.

Mandati yt është mandat i përgjithshëm në historinë e gjithë popullit shqiptar.

HOROSKOPI

DASHI

Mirësjellja juaj do të vlerësohet. Shumë njerëz do të thonë gjëra shumë pozitive për ju, ndërsa pozicioni i parave do të përmirësohet më vonë gjatë ditës.

DEMI

Natyrë ju ka dhuruar inteligjencë të theksuar, por duhet ta përdorni atë si duhet. Personaliteti juaj i këndshëm do t'ju ndihmojë të bëni miq të rinj dhe të përmirësoni kontaktet. Do të ndiheni shumë energjikë.

BINJAKET

Sot mos e shtyni veten në vështirësi. Gjendja shëndetësore nuk është në formën më të mirë dhe pajtësit ju nevojitet pak pushim. Ushtroni kujdes, menguri dhe durim, tekta merreni me njerëzit në punë.

GAFORJA

Sjellja e ftohtë e një miku mund të të ofendojë. Përpiku të ruani qetësinë. Eksploroni mundësi të reja investimi, por angazhoni veten vetëm pasi të keni studiuar qëndrueshmërinë e këtyre projekteve. Kërkoni ndihmë e familjes tuaj kur ndiheni të vetmuar.

LUANI

Do ta kaloni kohën duke u marrë me sport për të ruajtur qëndrueshmërinë fizike. Përkushtimi dhe puna e vështirë do të vihen re dhe do t'ju sjellin disa shpërblime financiare. Mos neglizhoni gjendjen shëndetësore të prindërve.

VIRGJERESHA

Ndjenja e urrejtjes mund të jetë e kushtueshme. Kjo jo vetëm që minon fuqinë tuaj të tolerancës, por edhe krijon një përçarje të përhershme në marrëdhënie. Përmirësimi i financave është diçka e sigurt. Tregoni kujdes, sepse çdo gjykim i nxituar mund t'ju vërë nën presion.

PESHORJA

Përdorni terapinë e buzëqeshjes për të kuruar sëmundjen tuaj të zgjatur, pasi është antidoti më i mirë për të gjitha problemet. Mos vepro si skllav në marrëdhënie dashurie. Mos zbuloni informacione personale dhe konfidenciale.

AKREPI

Merrni pjesë në aktivitete që janë emocionuese dhe ju relaksojnë. Kontrolloni tendencën për ta jetuar jetën në maksimum si të ishte dita e fundit, sepse kjo ju bën të shpenzoni shumë para. Mos ndërmerri veprime të nxitura, për të cilat do të pëndoheni më vonë.

SHIGJETARI

Kaloni më shumë kohë me fëmijët, sepse përqamni i tyre i ngrohtë do t'ju largojë stresin. Është koha për të rivlerësuar pikat e forta dhe planet tuaja të ardhshme. Përpiku të kaloni monotoninë që sjell martesja duke u marrë me aktivitete frymëzuese.

BRICJAPI

Hiqni dorë nga kokëfortësia juaj për hir të lumturisë. Në dashuri duhet të tregoheni mirëkuptues dhe tolerant. Kjo gjë do të vlerësohet nga partneri juaj. Sa u përket financave, bëni kujdes me disa shpenzime, veçanërisht për gjëra që nuk ju duhen.


UJORI

Niveli juaj i energjisë do të jetë i lartë dhe duhet ta përdorni për të përfunduar detyrat që keni lënë pas dore për një kohë të gjatë. Aftësia juaj për të mësuar gjëra të reja është e mrekulueshme. Në çështjet e taksave dhe sigurimeve do të duhet kenë më shumë vëmendje.

PESHQIT

Familja pret shumë prej jush, gjë që mund t'ju irritojë. Do të dilni me ide të shkëlqyera të reja, që do të sjellin përfitime financiare. Partneri do të ndihmojë në ndryshimin e jetës suaj. Në punë mund të përjetoni një ndryshim për mirë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë edhe ai i mëngjesit.
3. Një piktor si Ligabue.
7. Një thirrje me emra
11. Në radhë të parë.
13. Era e kafesë.
16. Eshhtë nusja me vello.
17. Lear që këndon Tomorrow.
20. Një pjesë e nomenklaturës.
21. Gjysmë rebusi.
22. Ruhet nga polici.
23. Ai kapital është ekstrem.
25. Haan që qe treneri i yni.
26. Eshhtë operatori i Tv.
28. Janë shakaxhinj.
29. Satelit i Jupiterit.
31. Janë pallto ushtarake.
32. Cruise aktor.
34. Kryeqyteti i Libanit.
37. Fundi i një filmi.
38. Ka pasuri minerale.

VERTIKAL

1. Eshhtë tretës me zorrë.
2. Ishte muza e astronomisë.
4. Tre asa.
5. Inicialet e Reitman regjisor.
6. Janë tinguj.
8. Përfshijnë edhe karotat.
9. Eshhtë era pas Krishtit.
10. Simon i Duran Duran.
12. Malet me Akonkagua.
14. Një M në FMN.
15. Një vend si Katar.
18. Me të nxjerrin një metër.
19. Fundi i një fundi.
23. Lumë në SHBA.
24. Një pjesë e marrëzisë.
26. Eshhtë mistrec, qerrata.
27. Janë centralet si Chernobyl
28. Child i Byron.
30. Mbreti i elfëve.
31. Eshhtë bas me katër tela.
33. Gjashtëdhjetë në orë
35. Mbeten në fund.
36. Falen pa fe.
38. E dymbëdhjetë ajo e Shakespeare.
39. Argento aktore.
40. Opera e Verdit.
43. Gjysmë borxhi.
44. Ente Ndërtimi Greke.
47. Fillojnë dobët.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një që pretendon të zgjidhet.
9. Bursa pa kufij.
12. Një tokë që fitohet
13. Janë shpendë që krakarisin.
14. Kalohet në gjumë.
17. Qëndrojnë mbi piedestal.
20. Të fundit në studim
22. Janë aftësitë me telepati
23. Kilmer aktor
25. Janë për plehra.
26. Ai ekzekutiv tani është bashki.
28. Kaluar në krye.
30. Janë pa shenjtorë në desktop.
31. Inicialet e Daudet.
33. Një Baba përallor.
35. Mund të kthehen në mllaf.

VERTIKAL


2. Fatal pa ekstreme.
3. Një peshë e pastër.
4. Pak dramatike.
5. Mbyllin një manastir.
6. Jepen me motivacion.
7. Kështu përfundon një uragan.
8. Përplojnë akte juridike të tillë.
9. Eshhtë bekim... prifti.
10. Kompozoi në Bolero të famshme.
11. Një S në USA.
13. Eshhtë tregti me objekte të shenja.
14. Një që beson kollaj.
15. Janë kodra rëre.
17. Eshhtë mnetalprerëse si tornu.
18. I bëjnë tekanjozët.
19. Ndërmarrje Montimi Tiranë.
21. Janë njëvendëshe në Formula 1.
24. Një publik si bar.
27. Mund të jenë diesel të tilla.
28. Eahhtë brinjë në skuadër.
29. Janë vegla.
32. U hahet të martuarve.
34. Fundi i njëen fatzui
35. Një teolog në xhami.
36. Ai i shtatë është kinemaja
38. Një pjesë njohurive.
40. Verifikuar pjesërisht.
43. Kufizojnë tatimet.
45. Fund janari.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

	6	8		1	3			4
7	9				4	5		
3							8	
					2			
	5		7	9				
6		9	1				7	
		3	2					
					8	3		
								1
	4	9						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar


1	7	2	9	5	6	8	4	3
9	5	4	3	8	7	6	1	2
6	8	3	2	1	4	9	5	7
2	9	1	5	6	3	4	7	8
5	6	7	4	2	8	3	9	1
4	3	8	7	9	1	5	2	6
7	2	5	6	3	9	1	8	4
3	1	9	8	4	2	7	6	5
8	4	6	1	7	5	2	3	9

Argëtim filozofik

- Kurrë mos ndjej keqardhje për atë që kenë menduar për gruan tënde. Ajo ka menduar shumë më keq për ju.
- Vetëm një në 1000 burra bëhet lider. Pjesa tjetër 999 ndjekin gratë.
- Një idiot mund të bëjë më shumë pyetje në një minutë se sa dhjetë burra të mençur mund të përgjigjen në një orë.
- Një njeri i mençur mëson shumë nga një budalla, dhe një budalla nuk mëson asgjë nga një i mençur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

ERASMI FAKETA
LORIS KUMARI
UNIK SANPORESE
AAMESIMOREG
RBEREMETIMET
DELIKATEVILA
SARAFETRACER
PIRATI MOLINE
MIGENARENA
ESEETERTERA
NATASAKRANA
NARKRITEMA

FJALËKRYQI (1)



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

PAZAR KABINET
IRON MBEITIMZ
TMEKETETRI
TARTARTONTION
TMTITANETANA
KASAMARITANE
ELIMANEDES
SOLANAKTECE
TUBORGAUREOS
ODSARENDITA
KANNSARAHPE
ENDEKATEETI

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Të pamartuarit dinë më shumë për gratë se sa të martuarit.
- Nëse nuk dinin, do të ishin dhe ata të martuar.
- Prindërit mund të japin këshilla të mira dhe të tregojnë rrugën e drejtë, por në finale formimi i karakterit të një personi qëndron në duart e veta
- Banker: Ai që ju jep ombrellën e tij kur koha është me diell, dhe ua merr atë mbropa, kur fillojnë të bjerë shi.
- Një i mençur në mesin e të paditurve, është si një vajzë e bukur në mes të të verbërve.

